

REDUKTIMI I NORMAVE TATIMORE DHE NDIKIMI I TYRE NË RRITJEN E TË ARDHURAVE DHE RRITJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS

Shkendije Demalijaj Ukaj

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkenca
Ekonomike, profili Financë, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Skender Uku

Numri i fjalëve: 59,149

Tiranë, Tetor 2016

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim doktoral është punë origjinale autoriale, e shkruar nga unë në mënyrë të pavarur dhe nuk përmban asnjë lloj plagjiature. Gjithashtu, deklaroj se ky punim në tërësinë e tij nuk është prezentuar, nuk është botuar dhe nuk është përdorur asnjëherë më parë për kryerjen e obligimeve shkollore në ndonjë institucion tjetër. Por, deklaroj se pjesë të veqanta nga ky punim janë botuar në revista shkencore dhe janë prezentuar në konferenca shkencore, si pjesë e kryerjes së obligimeve të studimeve doktorale.

ABSTRAKT

Në këtë punim nëpërmjetë një studimi të thelluar trajtohen reformat në normat dhe strukturën tatimore në Kosovë dhe ndikimi i tyre në performancën e të ardhurave tatimore, në ekonominë joformale dhe në rritjen ekonomike. Reformat në sistemin tatimor të krijuar pas luftës së vitit 1999 në Kosovë kanë qenë të vazhdueshme. Reduktimi i normave tatimore tek tatimet direkte, ku janë përfshirë: normat e tatimit në të ardhura personale dhe ato në të ardhurat e korporatave në njërën anë si dhe rritja e normave tatimore tek tatimet indirekte në anën tjetër, kanë qenë pjesë thelbësore e disa reformave tatimore. Reduktimi i normave tatimore u bë me qëllim që Kosova të mbetet konkurruese në fushën e tatimeve direkte në mënyrë që të përfitojë nga investitorët e huaj, poashtu, edhe mundësitë për investitorët e brendshëm të rriten. Për këtë arsye, një analizë krahasuese me vendet e rajonit dhe BE-së e përcjellë këtë studim, ku shihet një dallim i madh në strukturën e të ardhurave që përbën sistemi jonë tatimor, ndërsa normat tatimore dalin të jenë më të ulëtat në rajon dhe BE. Dhe, përkundër normave të ulëta tatimore për qëllime të efekteve pozitive në prurje të investimeve, gjë që nuk ndodhi në Kosovë, reduktimi i normave tatimore në këtë nivel ka çënuar objektivin fiskal që mbartin tatimet.

Për të vënë në pah efektet e këtyre reformave në krijimin e të ardhurave tatimore dhe në rritjen ekonomike të Kosovës, realizohet një vlerësim empirik i cili ka bërë të mundur nxjerrjen e disa rezultateve të rëndësishme të studimit. Ndërsa, për të identifikuar shkaktarët e një performace të ulët të të ardhurave tatimore është zhvilluar një pyetësor me bizneset në Kosovë. Kampioni i studimit përfshinë 776 biznese. Të dhënat janë grumbulluar përmes plotësimit të pyetësorëve nga pronarët dhe menaxherët e bizneseve. Rezultatet nga pyetësori kanë nxjerrë në pahë një mori barrierash që i detyrojnë bizneset në Kosovë për t'u përfshirë në evazion fiskal dhe ekonomi joformale, të cilat ndikojnë negativisht në performancën e të ardhurave tatimore. Punimi merr rëndësi teorike edhe praktike pasi që vlerësimet dhe rekomandimet që dalin nga ky studim ndihmojnë në identifikimin e barrierave me ndikim negativ në krijimin e të ardhurave tatimore, shërbejnë për hartimin e politikave të favorëshme tatimore, për parashikimin e rritjes të të ardhurave tatimore në buxhet dhe krijimin e një sistemi tatimor optimal në përmbushje të objektivave të përgjithëshme të tij për të kontribuar në rritjen e mirëqënies ekonomike në vend.

ABSTRACT

In this paper by through an depth study treated tax structure and tax rates reforms in Kosovo and their impact on performance of tax income comes, in the informal economy and on economic growth. Reforms in the tax system established after the 1999 war in Kosovo have been ongoing. Reducing tax rates on direct taxes, which included: tax rates on personal income and the corporate income on the one hand and increase tax rates on indirect taxes on the other hand, it has been an essential part of several tax reforms . Reducing tax rates was made in order for Kosovo to remain competitive in the field of direct taxes in order to benefit from foreign investors, also that the possibilities for increased domestic investors. Therefore, a comparative analysis with the regional countries and the EU followed this study, which shows a big difference in the structure of income that makes our system the tax, while the tax rates appear to be the lowest in the region and the EU . And, despite the lower tax rates for the purposes of the positive effects of generation investments benefits, which did not happen in Kosovo, reducing tax rates at this level has affected the fiscal target that carry tax.

To highlight the effects of the reforms in tax revenue creation and economic growth in Kosovo, carried out an empirical estimates which made it possible to extract some important results of the study. While, to identify the causes of poor performance of tax revenues has developed a questionnaires to businesses in Kosovo. The sample includes 776 businesses. Data were collected through questionnaires completed by owners and managers of businesses. Results from the survey have issued depicted a multitude of barriers that force businesses in Kosovo to engage in tax evasion and informal economy, which negatively affect the performance of tax revenues. The paper is important theoretical and practical since the assessments and recommendations arising from this study help to identify barriers negative impact on the creation of tax revenue, for the preparation of policies favorable tax forecasting the growth of tax revenues in the budget and creating an optimal tax system in fulfillment of its general objectives to contribute to the growth of the country's economic welfare.

DEDIKIMI

Vëllaut tim, dëshmorit të lirisë së Kosovës!

Jakub Demalijaj

Dhe, fëmijëve të mi të mrekullueshëm!

Bardhit dhe Uerdes

FALËNDERIME

Një falënderim i veçantë në këtë punim shkon për udhëheqësin tim, Prof. Asoc. Dr. Skender Uku, i cili më ka ndihëmuar shumë. E falënderoj jo vetëm për sygjerimet e vlefëshme por mbi të gjitha për inkurajimin për të kryer me sukses këtë studim.

Falënderoj shumë prindërit e mi të dashur për ndihmën e tyre të pakursyer, për mbështetjen e pafund dhe motivimin që më kanë dhënë për të arritur deri këtu. Gjithashtu, i shprehë mirënjohje të thellë bashkëshortit tim për përkrahjen dhe mirkuptimin gjatë gjithë kohës së kryerjes së këtij studimi. Ndërsa, u kërkoj ndjesë fëmijëve të mi për kohën që u kam marr dhe angazhimin e lënë anash ndaj tyre. Ata ishin frymëzimi im dhe forca ime për të përfunduar me sukses këtë nismë ambicioze.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

LISTA E TABELAVE.....	10
LISTA E GRAFIKËVE.....	11
LISTA E SHKURTIMEVE.....	12

KAPITULLI I: HYRJE.....13

1.1 Parathënie.....	13
1.2 Shtrimi i problemit.....	16
1.3 Qëllimi dhe objektivat e studimit.....	16
1.4 Pyetjet kërkimore dhe hipotezat.....	17
1.5 Përshkrim i shkurtër i metodologjisë dhe metodave të studimit.....	18
1.6 Impakti shkencor dhe social i studimit.....	20
1.7 Shpjegim i shkurtër i strukturës së punimit.....	21
1.8 Përmbledhje e kapitullit.....	23

KAPITULLI II: SHQYRTIM LITERATURE.....24

2.1 Shqyrtim literature mbi konceptet, parimet, karakteristikat, dhe klasifikimin e tatimeve.....	24
2.1.1 Koncepte të përgjithshme të tatimeve dhe sistemit tatimor.....	24
2.1.2 Zhvillimi i tatimeve gjatë historisë.....	26
2.1.3 Parimet e sistemit tatimor.....	28
2.1.4 Karakteristikat e sistemit tatimor.....	31
2.1.5 Llojet e tatimeve.....	34
2.1.6 Sistemi optimal tatimor.....	37
2.1.7 Elementët kryesor të sistemit tatimor.....	41
2.1.8 Klasifikimi i sistemeve tatimore.....	42
2.2 Shqyrtim literature mbi ndikimin e taksimit në rritjen ekonomike.....	44
2.2.1 Aspekte teorike – ndikimi i taksimit në rritjen ekonomike.....	44

2.2.2 Modeli neoklasik dhe teoritë ekzogjene e endogjene të rritjes.....	50
2.2.3 Politika fiskale dhe zhvillimi ekonomik.....	56
2.2.4. Investimet dhe zhvillimi ekonomik.....	57
2.3 Shfrytëzimi i modelit ekonomik në funksion të rezultateve të hulumtimit.....	58
2.3.1 Rezultate të kërkimeve empirike mbi ndikimin e taksimit në rritjen ekonomike.....	60
2.4 Politika fiskale dhe efektet e saj në evazionit fiskal.....	71
2.4.1 Faktorët që ndikojnë evazionin fiskal dhe ekonominë joformale.....	74
2.4.2 Morali tatimor dhe evazoni fiskal.....	83
2.4.3 Matja e evazionit fiskal.....	84
2.4.4 Evazoni fiskal në Kosovë dhe faktorët që shkaktojnë atë.....	89
2.5 Përmbledhje e kapitullit.....	93

KAPITULLI III: ANALIZË E SISTEMIT TATIMOR NË KOSOVË, DHE KRAHASUESHMËRIA ME VENDET E RAJONIT DHE BE-së..95

3.1 Vështrim i përgjithshëm mbi historikun e sistemit tatimor të pasluftës në Kosovë.....	95
3.1.1 Kuadri ligjor.....	99
3.1.2 Kuadri Institucional.....	105
3.1.3 Vlerësime ndërkombëtare.....	109
3.2 Analizë e reformave në strukturë dhe norma tatimore në Kosovë, Rajon dhe BE.....	110
3.2.1 Reformat në strukturën tatimore në Kosovë	119
3.2.2 Struktura tatimore në disa vende të EJL-së dhe Rajonit.....	124
3.2.3 Struktura tatimore në vendet e BE-së.....	126
3.3 Reformat e normave tatimore.....	127
3.3.1 Reformat në normat tatimore në Kosovë.....	127
3.3.2 Normat tatimore në vendet e Rajonit.....	131
3.3.3 Normat tatimore në vendet e BE-së.....	132
3.4 Përmbledhje e kapitullit.....	135

KAPITULLI IV: METODOLOGJIA E KËRKIMIT.....	137
4.1 Metodologjia dhe metodat bazë të studimit.....	137
4.1.1 Burimet dytësore në funksion të gjetjes së rezultateve të studimit.....	137
4.1.2 Burimet parësore në funksion të gjetjes së rezultateve të studimit.....	144
4.2 Përmbledhje e kapitullit.....	147
 KAPITULLI V: REZULTATET DHE DISKUTIMET.....	 148
5.1 Analiza empirike dhe interpretimi i rezultateve.....	148
5.1.1 Analiza e testimit të modelit.....	148
5.2 Interpretimi i rezultateve dhe diskutimi i tyre.....	153
5.3 Analiza përshkruese e gjetjeve nga pyetësi.....	157
5.4. Analizë krahasuese e gjetjeve të studimit me gjetjet e studimeve tjera.....	176
 KAPITULLI VI: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME.....	 178
6.1 Konkluzione	178
6.2 Rekomandime.....	182
 BIBLOGRAFIA.....	 184
 SHTOJCA.....	 194

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Përmbledhje e rezultateve nga kërkimet empirike mbi ndikimin e tatimeve në rritjen ekonomike.....	68
Tabela 2. Barra mesatare e taksave në Kosovë , Rajon dhe BE ndaj PBB-së, në %.....	90
Tabela 3. Ecuria e të ardhurave të veqanta tatimore (2000-2013) ndaj totalit të të ardhurave të mbledhura nga ATK dhe Dogana, në %.....	113
Tabela 4. Struktura e të ardhurave tatimore ndaj totalit të ardhurave të ATK-së, në %....	121
Tabela 5. Struktura sipas llojeve të të ardhurave ndaj PBB-së, në Kosovë, në %.....	124
Tabela 6. Struktura tatimore në vendet e EJL dhe Rajonit ndaj PBB-së, në %.....	125
Tabela 7. Struktura tatimore në vendet e BE-së, ndaj PBB-së, në %.....	126
Tabela 8. Normat tatimore të TVSH –së, në Kosovë, në %.....	128
Tabela 9. Normat tatimore të TAP –së, në Kosovë, në %.....	128
Tabela 10. Normat tatimore të TAK –së, në Kosovë, në %.....	129
Tabela 11. Reformat në strukturë dhe norma tatimore në Kosovë (2000-2012).....	130
Tabela 12. Barra e taksave në Kosovë dhe në Rajon (2012-2013), në %	131
Tabela 13. Normat tatimore të TAP –së, në BE-27, në %.....	132
Tabela 14. Normat tatimore të TAK –së, në BE-27, në %.....	133
Tabela 15. Normat tatimore të TVSH –së, në BE-27, në %.....	134
Tabela 16. Përshkrimi i variablave ekonometrike.....	139
Tabela 5.1 Përmbledhje e rezultateve nga testet e stacionaritetit të variablave.....	149
Tabela 5.2 Analiza e I e OLS-së.....	153
Tabela 5.3 Analiza e II e OLS-së.....	154
Tabela 5.4 Analiza e III e OLS-së.....	156

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1. Ecuria e të ardhurave të brendëshme tatimore 2000-2014, në mil.	112
Grafiku 2. Kategoritë e ndryshme e të ardhurave tatimore ndaj të hyrave totale tatimore në Kosovë, në %.....	115
Grafiku 3. Ecuria e kategorive të veqanta e të ardhurave nga ATK, në mil.	116
Grafiku 4. Ecuria e të ardhurave totale të mbledhura nga ATK, ndaj PBB-së, në %	117
Grafiku 5. Kategoritë e ndryshme e të ardhurave, ndaj PBB-së, në %.....	118
Grafikët 6-18. Grafikët e variablave të përfshira në analizën ekonometrike	140-142
Grafiku 5.1 Llojet e ndryshme të aktiviteteve të përfshira në tregti me shumicë e pakicë, në %.....	159
Grafiku 5.2 Bizneset e përfshira vetëm në tregti me pakicë dhe shërbime profesionale, në %.....	160
Grafiku 5.3 Arsyet e mosdeklarimit dhe nëndeklarimit të pagës.....	161
Grafiku 5.4 Shkalla e evazionit fiskal dhe informalitetit të pagave në Kosovë.....	162
Grafiku 5.5 Klasifikimi i bizneseve sipas grupit të të ardhurave vjetore.....	164
Grafiku 5.6 Nr. i bizneseve në raport me shumën e të ardhurave të deklaruar prej tyre...	165
Grafiku 5.7 Shkaktarët e evazionit fiskal	167
Grafiku 5.8 Reflektimi i paknaqësisë së bizneseve nga puna e zyrtarëve tatimor.....	170
Grafiku 5.9 Arsyet e mosraportimit të ryshfetit nga ana e bizneseve.....	171

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

ATK – Administrata Tatimore e Kosovës

ASK – Agjensioni i Statistikave të Kosovës

BB - Banka Botrore

BE – Bashkësia Europiane

BQK – Banka Qëndrore e Kosovës

BMI – Bineset e mëdha individuale

DM – Njësia monetare (marka) Gjermane

FMN - Fondi Monetar Ndërkombëtar

KP – Kontributet Pensionale

MF – Ministria e Financave

OECD - Organizata për zhvillim dhe Bashkpunim Ekonomik

PBB – Produkti i Brendshëm Bruto

TAK – Tatimi në të ardhura të Korporatave

TAP – Tatimi në të ardhura Personale

TSH – Tatimi mbi shitjen

TVSH - Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

UNMIK – Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

USAID – Organizata e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar

Kapitulli I: Hyrje

1.1 Parathënie

Tema që është objekt i këtij hulumtimi shkencor ka të bëjë me një problematikë mjaftë specifike, një prej më të rëndësishmëve që ndodhën në Kosovën e pasluftës së vitit 1998-1999, që është krijimi i sistemit dhe politikës tatimore në Kosovë. Me rënjen e ekonomisë formale dhe me rritjen e shtypjes serbe në vitet e 90-ta, tregu joformal dhe bujqësia ishin hapsira e vetme ekonomike për shumicën e shqiptarëve në Kosovë. Ato, bashkë me remitancat e të afërmeve në emigrim ishin rrugët e vetme të mbijetesës. Falë sistemit paralel që zhvillohej në atë kohë, aftësia sipërmarrëse e shqiptarëve ishte mjaftë e zhvilluar para konfliktit të viteve 1998-1999 mirëpo, pasojat shkatërruese nga lufta dhe boshllëqet strukturore të ekonomisë nuk mund të plotësoheshin nga tregtia dhe ekonomia e filluar me 1999. Remitancat e emigrantëve dhe ndihmat e donatorëve plotësuan mungesën e kapacitetit të brendshëm të ekonomisë Kosovare.

Krijimi i sistemit dhe politikës tatimore në Kosovë nga ana e Misionit Ndërkombëtar i Kombëve të Bashkuara të instaluar pas luftës në Kosovë, UNMIK është rast i shembullit unik, i krijuar në praktikë pa ndikimin e brendshëm dhe pa dialog politik, politikë që ka filluar me sisteme tatimore dhe rregullore të UNMIK-ut të kopjuara nga vendet në tranzicion dhe vendet tjera të BE-së, që nuk ishin në përputhshmëri me gjendjen dhe nevojat reale të Kosovës, që pothuajse në çdo sektor u desh të fillohej nga zeroja dhe u deshën me shumë se pesë vite për fillimin e ndërtimit të një politike tatimore deri diku stabile dhe në përputhje me gjendjen dhe nevojat e ekonomisë.

Më 3 shtator 1999 u themelua Dogana e Kosovës nën drejtimin e UNMIK-ut. Të hyrat doganore dominojnë strukturën e të hyrave buxhetore në vitin 2011 ato arrin 63.4% të hyrave të përgjithshme nga taksat dhe të cilat nuk janë objekt studimi në këtë punim. Më 17.01.2000 u themelua Administrata Tatimore e Kosovës nën administrimin e UNMIK-ut. Drejtori i parë ishte ndërkombëtar. Ndërsa, me 18.02.2003 autoriteti u bart nga UNMIK –u tek vendorët (Ministria për ekonomi dhe Financa). Institucioni filloi të funksionoi si organizatë e pavarur e përkrahur në vazhdimësi nga organizata ndërkombëtare si: USAID, BE dhe FMN. Ligjeslacioni tatimor është pranuar nga FMN dhe BE si transparent dhe në harmoni me standardet ndërkombëtare. Me gjithë zhvillimin dhe asistencën e dhënë, ATK ka ende shumë punë për të bërë që të jetë një organizatë moderne dhe efiçiente (Administrata Tatimore e Kosovës, 2011: 8-12).

Që nga themelimi i saj, ATK në vazhdimësi është përballur me reforma si në strukturë, në bazën e tatueshme ashtu edhe në normat tatimore. Në vitin 2000, fillimisht u aplikua Tatimi i Paragjykuar dhe Tatimi në Hotele dhe Restorane. Në vitin 2001 filloi së zbatuari Tatimi në Vlerën e Shtuar. Në vitin 2002 filloi zbatimi i Tatimit në Fitim dhe Tatimit të Mbajtur në Burim në Paga të të punsuarve. Në vitin 2003 filluan se zbatuari Kontributet Pensionale. Ndërsa, në vitin 2005 politika tatimore filloi me reformat e para të mëdha me ç'rast baza tatimore në Kosovë u vëndosë dhe përbëhet nga tri lloje kryesore të tatimeve: Tatimi në Vlerën e Shtuar, Tatimi në të Ardhurat Përsone dhe Tatimi në të Ardhurat e Korporatave. Në vitin 2009, reformat tatimore u ndërmorën në drejtim të uljës së normave tatimore, duke ulur normat tatimore në të ardhurat personale dhe ato të korporatave, kjo ndodhi edhe përkundër rekomandimeve të FMN-së sepse ato ishin vetëm për interesa personale dhe grupe të qeveritarëve. Sipas qeveritarëve synimi i reformave ishte lehtësimi i masave për

investitor të huaj që të investojnë në Kosovë, që deri sot nuk ndodhi si pasojë e byrokracisë dhe korrupsionit të lartë. Reforma tatimore që filloi me 2010 dhe nuk përfundoi sipas planit ishte paisja me arka fiskale. Nga korriku 2010 filloi mënyra e raportimit elektronik për tatimpagues që mendoj se është një hap i përshpejtuar duke pasur parasysh shkallën e arsimimit, moshën e shumicës së pjesëmarrësve në biznes dhe mundësinë e të bërit biznes si dhe ballafaqimin me teknologjinë që nuk është e thjeshtë për t'u aplikuar.

Meqë, barra tatimore llogaritet një ndër me të ulëtat në rajon, prapë se prapë evazoni fiskal, informaliteti ekonomik dhe korrupsioni janë shumë prezent në ekonominë kosovare dhe llogaritën si shkaktarët kryesor që ndikojnë në zvogëlimin e të ardhurave tatimore dhe rritjes ekonomike në përgjithësi. Në zvogëlimin e të ardhurave buxhetore kanë ndikuar edhe kontributet pensionale të cilat administrohen dhe mblidhen nga Administrata Tatimore ndërsa, nuk bëjnë pjesë në të ardhurat e buxhetit të Kosovës.

Në kuadër të këtij punimi realizohet gjithashtu, një vlerësim empirik mbi ndikimin e reformave tatimore dhe efekti i tyre në rritjen ekonomike si dhe trajtimi i evazionit fiskal, ekonomisë joformale dhe korrupsionit, përmes mbledhjes të të dhënave primare në terren dhe paraqitjes së rezultateve, në mënyrë që të vërtetohet ndikimi i tyre në mbledhjen e të ardhurave tatimore. Punimi merr rëndësi jo vetëm teorike por edhe praktike duke qenë se vlerësimet dhe rekomandimet që dalin nga ky studim mund të shërbejnë për parashikimin e të ardhurave në buxhet, për hartimin e politikave të duhura tatimore dhe ndërtimin e një sistemi optimal tatimor në përmbushje të objektivave të pëgjithëshme të tij, dhe në funksion të rritjes ekonomike.

1.2 Shtrimi i problemit

Tema: Reduktimi në normat tatimore dhe ndikimi i tyre në rritjen e të ardhurave nga tatimet, dhe në rritjen ekonomike të Kosovës që do të jetë objekt i hulumtimit në këtë punim shkencor ka të bëjë me arritjen e objektivave zhvillimore përmes reformave të duhura në drejtim të mbledhjes të të hyrave tatimore me qëllim të përmirësimit të mirëqenjes ekonomike në vend. Andaj, interesimi im për këtë temë është për të studiuar më në thellësi ndikimin e reformave të ndërmarra në sistemin tatimor sa i përket reduktimit të normave tatimore me qëllim të rritjes së të hyrave nga tatimet, të cilat mjete paguhen nga bizneset dhe të punsuarit në sektorin publik dhe atë privat në Kosovë e poashtu edhe nga personat e vetpunësuar në sektorin privat.

Për të elaboruar çështjet e cekura me lartë, ky studim do të përfshijë analizën e reformave në sistemin tatimor, funksioni kryesor i të cilit është gjenerimi i të ardhurave për buxhetin e shtetit, njohja e problemeve në lidhje me reformat e normave dhe strukturës tatimore që janë marr në këtë drejtim si dhe masat tjera që duhet ndërmarrë për administrimin e faktorëve tjerë që janë prezent dhe në masë të madhe ushtrojnë ndikimin e tyre që ky funksion të mos përmbushet, siç janë evazoni tatimor, informaliteti dhe korrupsioni në fushën e tatimeve.

1.3 Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi kryesor i këtij punimi është që nëpërmjetë një studimi të thelluar të analizojë rolin e reformave në normat tatimore të ndërmarra në periudhën 2000-2015, për të identifikuar ndikimin e tyre në performancën e të ardhurave tatimore dhe lidhjen e tyre me rritjen ekonomike në Kosovë. Mirëpo, objektivi kryesor studimi në këtë punim është analiza e ndikimit nga reduktimi i normave tatimore të tatimeve *direkte* ku përfshihen tatimi në të

ardhura personale dhe tatimi në korporata të cilat administrohen nga Autoriteti Qendror Tatimor i Kosovës. Mirëpo, me qëllim të plotësimit të modelit ekonomik të përdorur në këtë studim për analizë përfshihen edhe tatimet dhe taksat e administruara nga Autoriteti Doganor dhe të ardhurat tjera.

Reformat tatimore në të ardhurat tatimore direkte në Kosovë janë ndërmarrë në drejtim të reduktimit të normave tatimore me qëllim të rritjes së bazës së tatueshme, rritjes së investimeve, uljes së informalitetit ekonomik dhe rritjes ekonomike, pasi që sistemi tatimor në Kosovë është i dominuar nga tatimet indirekte që japë të kuptojë se është karakteristikë e vendeve në zhvillim dhe është largë të qënurit në harmoni me legjislacionet tatimore të vendeve të zhvilluara të BE-së, në mesin e të cilave Kosova synon të jetë.

Disa nga nën objektivat e këtij punimi janë: Së pari, ky studim synon që të analizojë strukturën dhe normat tatimore të aplikueshme në Kosovë, me qëllim të realizimit të një analize krahasuese me vendet e rajonit dhe ato të BE-së. Së dyti, synohet që përmes përdorimit të metodave shkencore të hulumtimit të realizojë një analizë empirike mbi efektet e reformave të normave tatimore në performancën e të ardhurave tatimore dhe ndikimin e tyre në rritjen ekonomike në Kosovë ku përpos variablave fiskale të në këtë analizë synohet të analizohet dhe ndikimi i variablave jofiskal në rritjen ekonomike. Së treti, studimi ka synim të identifikojë faktorët që ndikojnë evazionin fiskal dhe ekonominë joformale si dhe efektet e tyre në performancën e të ardhurave tatimore.

1.4 Pyetjet kërkimore dhe hipotezat

Pyetjet bazë kërkimore të këtij studimi janë:

1. A ndikojnë normat e ulëta tatimore të TAP dhe TAK në rritjen e performancës të këtyre kategorive të ardhurash dhe në rritjen ekonomike në Kosovë?

2. Si ndikojnë kategoritë e ndryshme të të ardhurave tatimore dhe jotatimore në rritjen ekonomike në Kosovë?
3. Si ndikojnë stimujt e politikës fiskale dhe variablat e tjerë jo fiskal në rritjen ekonomike të Kosovës?
4. A ndikon reduktimi i normave tatimore në uljen e evazionit fiskal dhe ekonominë joformale në Kosovë?

Hipotezat bazë:

H1 Reduktimi i normave tatimore të TAP dhe TAK nuk ka efekt në rritjen e të ardhurave tatimore në Kosovë

H2 Normat e ulëta tatimore nuk kontribuojnë në rritjen ekonomike në Kosovë.

H3 Reduktimi i normave tatimore nuk ndikon në uljen e evazionit fiskal dhe ekonomisë joformale nëse nuk merren masa në luftim të korrupsionit dhe përmirsim të administrimit të tatimeve përfshirë transparencën, llogaridhënjën dhe profesionalizmin e zyrtarëve tatimor.

1.5 Përshkrim i shkurtër i metodologjisë dhe metodave të studimit

Për hartimin e këtij punimi është përdorur një literaturë e gjerë e cila konsiston në materiale dhe punime të shumë autorëve, kryesisht të huaj në fushën e tatimeve si dhe përdorimi i një numri të madh burimesh informacioni nga faqet zyrtare të institucioneve të rëndësishme, si me karakter kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar.

Për të bërë zgjedhjen e metodës më të përshtatshme kërkimore në këtë studim u morën në konsideratë objektivat e këtij studimi, mundësitë për të siguruar të dhëna, kufizimet kohore dhe zhvillimet e politikave tatimore në Kosovë. Kështuqë, mosekzistenca e punimeve shkencore të kësaj fushe në Kosovë dhe prania e ulët e debateve në këtë drejtim me ka

nxitur në përdorimin e metodës mikse kërkimore si metodën më të përshtatshme për realizimin e objektivave dhe qëllimeve të këtij punimi. Prandaj, në realizimin e këtij studimi me karakter hulumtues, analitik dhe vlerësues ka kontribuar analiza krahasimore me vende tjera, analiza përshkruese dhe analiza regressive me qëllim të testimit të hipotezave dhe nxjerrjen e rezultateve dhe konkluzioneve përfundimtare të studimit.

Për të identifikuar ndikimin e reformave tatimore në krijimin e të ardhurave tatimore dhe rritjen ekonomike të Kosovës janë përdorur të dhëna dytësore, konkretisht janë përdorur variablat makro dhe mikro ekonomike. Informacionet për këto të dhëna nga burime të brendshme janë marr nga Ministria e Financave të Kosovës, Banka Qëndrore e Kosovës, Agjensioni i Statistikave të Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa nga burime të huaja si Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, Eurostat dhe OECD. Këto burime gjithashtu, janë përdorur si informacion për analiza krahasuese të Kosovës me vende tjera, duke përcaktuar pozitën që ka vendi ynë në raport me vendet e tjera. Në kuadër të kësaj analize janë përdorur tabela dhe figura për të ilustruar më mirë përfundimet e kësaj analize. Harku kohor i këtyre të dhënave korrespondon me periudhën 2000-2015 e në disa raste 2002-2015 për shkak të mungesës së të dhënave.

Modeli është zgjeruar duke përfshirë analizën ekonometrike të efektit të reformave në normat tatimore ndaj të ardhurave totale tatimore dhe rritjes ekonomike për kokë banori. Ndërsa, për të identifikuar faktorët që ndikojnë në performancën e të ardhurave tatimore janë përdorur të dhëna primare, mbledhja e të cilave është realizuar përmes pyetsorëve drejtuar bizneseve në Kosovë. Këto të dhëna janë mbledhur në tremujorin e fundit të vitit 2014.

Mirëpo, përveq kontributeve që sjellë ky punim, është i shoqëruar me një sërë kufizimesh të cilat janë paraqitur gjatë kërkimit të literaturës për faktin se literatura nga tematika mbi tatimet mungon në Kosovë. Gjithashtu, kufizimet ekzistojnë edhe në publikimin e të dhënave statistikore në buletinet e faqeve zyrtare si nga institucionet vendore ashtu edhe nga ato ndërkombëtare. Të dhënat e përfshira në studim janë të kufizuara në periudhën 2002- 2015 me krijimin e sistemit të ri tatimor që nga fillimi, për shkak të luftës së viteve 1998-1999 në Kosovë. Mirëpo, me gjithë kufizimet e paraqitura, rezultatet që pritet të dalin nga ky studim, pritet t'u shërbejnë hartuesve të politikave tatimore në Kosovë si dhe do të shërbejnë si udhërrëfyes për studime në të ardhmën në këtë fushë.

1.6 Impakti shkencor dhe social i studimit

Sikurse është cekur edhe me parë, ky punim shkencor përpos tjerash ka si qëllim t'u vijë në ndihmë hartuesve të politikave tatimore në kushtet kur ekonomia kosovare dhe rritja e kontributit për gjenerimin e të ardhurave në buxhet është e një rëndësie të veçantë për vetë faktin që këto të ardhura ndikojnë në mirëqenjen ekonomike të qytetarëve, e cila është tejjet e ulët në Kosovë. Studimi do të shërbejë si pikënisje për studime me të thelluara në fushën e tatimeve, inkurajon studiusit e fushës për të pasuruar me tutje literaturën tatimore, të analizojë dhe sygjeroi domosdoshmërinë e reformave të veqanta.

Gjithashtu, studimi merr qasje praktike duke qenë se identifikimi i faktorëve që ndikojnë negativisht në mbledhjen e të hyrave, përmes punës në terren si dhe vlerësimet empirike të përdorura në këtë punim do të shërbejnë në njërën anë për parashikimin e të ardhurave tatimore në buxhet dhe mund të merren në konsideratë gjatë hartimit të politikave tatimore dhe ndryshimeve në kuadër të politikave fiskale, ndërsa në anën tjetër do të shërbejnë si udhërrëfyes për identifikimin e barrierave që destimulojnë bizneset për të kryer obligimet

tatimore si dhe nxisin diskutimin për gjetjen e rrugë zgjidhjeve të mundshme dhe minimizimin e këtyre gabimeve dhe barrierave në të ardhmën.

1.7 Shpjegim i shkurtër i strukturës së punimit

Në kapitullin e parë jepet një prezantim ku pasqyrohet problematika, qëllimi, objektivat, pyetjet dhe hipotezat kërkimore që parashtron tema që është objekt i këtij studimi, pastaj shkurtimisht paraqiten metodat dhe metodologjia e hulumtimit si dhe impakti shkencor dhe social i hulumtimit.

Kapitulli i dytë përmbledhë dhe shqyrton atë çfarë thotë literatura mbi temën e zgjedhur. Në këtë kapitull jepet një pamje e përgjithëshme e një sistemi tatimor, konceptet, karakteristikat, klasifikimi, elementet kryesore që duhet të përmbajë një sistem tatimesh si dhe llojet e sistemeve tatimore. Në kapitullin e dytë gjithashtu, trajtohen teoritë dhe modelet ekonomike si dhe gjetjet empirike të shumë autorëve që kanë trajtuar problematikën e njëjtë sikurse në këtë punim. Kapitulli përfshinë shtjellimin e modelit ekonomik në funksion të ndikimit të taksimit në gjenerimin e të ardhurave nga tatimet dhe rritjen ekonomike që ka për objektiv ky punim . Dhe në fund të këtij kapitulli shtjellohet edhe literatura që ka të bëjë me evazionin fiskal, faktorët që e shkaktojnë si dhe shtjellimin e modeleve ekonomike për matjen e tij.

Kapitulli i tretë pasqyron krijimin e sistemit tatimor të pasluftës 1998/1999 në Kosovë, rregulloret e UNMIK-ut të cilat vendosen rregullat e tatimeve menjëherë pas luftës së fundit. Sa i përket kornizës ligjore, kapitulli diskuton ligjet që rregullojnë llojet e tatimeve përfshirë tatimet direkte dhe indirekte që zbatohen në Kosovë, ku jap një pasqyrë të shkurtër mbi zhvillimet kryesore në fushat specifike të tatimeve kryesore si: Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), Tatimin mbi të Ardhurat Personale (TAP), Tatimin në Korporata

(TAK) dhe Kontributet Pensionale (KP). Gjithashtu, në këtë kapitull pasqyrohet krijimi i të ardhurave tatimore përgjatë viteve 2000-2015 si dhe pasqyrohen reformat tatimore që ndodhen në sistemin tatimor në vazhdimësi në lidhje me normat dhe me strukturën tatimore që do të ishin të përshtatshme për kirijimin dhe rritjen të ardhurave tatimore. Poashtu, analiza krahasuese e reformave në normat dhe strukturën tatimore të Kosovës me ato të vendeve të rajonit dhe vendeve anëtare të Bashkimit European janë në fokus të këtij kapitulli.

Kapitulli i katërtë shtjellon në mënyrë të detajuar metodat dhe metodologjinë e këtij studimi. Në këtë pjesë paraqiten elementet konkret të realizimit të këtij studimi, të tillë si variablat makroekonomike të siguruar nga të dhënat sekondare në faqet zyrtare të institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe variablat mikroekonomike të siguruar nga të dhënat parësore përmes pyetsorit.

Kapitulli i pestë pasqyron analizën e interpretimit të rezultateve të hulumtimit. Në pjesën e parë të këtij kapitulli paraqitet nxjerrja e rezultateve të të dhënave dytësore përmes analizave të regresionit dhe testimit të tyre që përfshinë ndikimin e normave tatimore në performancën e të ardhurave tatimore, dhe për rrjedhojë edhe mbi rritjen ekonomike. Ndërsa pjesa e dytë e kapitullit pasqyron analizën përshkruese të të dhënave primare të grumbulluara nga pyetsorët. Dhe, që të dy këto lloj analizash bëjnë të mundur testimin e hipotezave në këtë hulumtim. Fare në fund të temës, në kapitullin e gjashtë paraqitën konkluzionet, diskutimet dhe rekomandimet kryesore, kontributet që sjellë ky punim, kufizimet e tij si edhe synimet e ardhshme për zgjerimin e analizës në këtë fushë.

1.8 Përmbledhje e kapitullit

Në këtë kapitull u diskutua në lidhje me shtrimin e problemit mbi temën e zgjedhur, qëllimet dhe objektivat kryesore të këtij hulumtimi, shtrimin e pyetjeve dhe hipotezave kërkimore, metodat dhe metodologjinë e zgjedhur për të kryer këtë studim si dhe arsyet pse ky hulumtim ka rëndësi për ekonominë e vendit tonë.

Kapitulli II: Shqyrtim literature

2.1 Shqyrtim literature mbi konceptet, parimet, karakteristikat dhe klasifikimin e tatimeve

2.1.1 Koncepte të përgjithshme të tatimeve dhe sistemit tatimor

- *Tatimet përkufizohen si pagesa të detyrueshme në para të personave fizik dhe juridik, që mbliidhen nga ana e shtetit pa kundërshpërblim dhe që shërbejnë për mbulimin e shpenzimeve publike dhe për shpërndarjen e të ardhurave kombëtare (Bundo, Sh., 2007:280)*

Duke u bazuar në karakteristikat e lartcekura, tatimet luajnë një rol të rëndësishëm në nxitjen e rritjes ekonomike, ato gjenerojnë të ardhura të nevojshme për të financuar politikat e zhvillimit ekonomik të qeverive dhe krijojnë një kornizë për zhvillimin e aktiviteteve të sektorit privat. Një mënyrë e qeverive për të ndihmuar rritjen e tyre ekonomike të ngadaltë është duke përmirësuar sistemet e tyre tatimore. Forcimi i kornizave fiskale kërkon ndërtimin e bazave të forta dhe me të besueshme të të ardhurave. Një bazë e fortë e të ardhurave do të sigurojë një burim me të qëndrueshëm të të ardhurave për të financuar investime shumë të nevojshme publike. (FMN, 2012:1-4).

Zhvillimi politik, ekonomik dhe social i çdo vendi varet nga shuma e të ardhurave të gjeneruara për sigurimin e infrastrukturës në atë vend. Ndërsa, për të gjeneruar këto të ardhura është i nevojshëm një sistem tatimor i strukturuar mirë. Struktura tatimore e projektuar mirë mund të inkurajoi rritjen duke promovuar barazi, Ogbonna et.al., (2012). Gjithashtu, Abuzike (2009), siq është cituar nga Ogbonna et.al., (2012), ka shpjeguar se sistemi tatimor është një mundësi për qeverinë për të mbledhur të ardhura shtesë për kryerjen e detyrave të saj. Një sistem tatimor ofron mundësi që me anë të mjeteve efektive

mobilizon burimet e brendëshme të një kombi dhe krijon një mjedis të favorshëm për nxitjen ekonomike.

Sipas Croce, E. (2002), nëse qeveria e një vendi është e aftë të shlyej detyrimet e saj në vazhdimësi, atëherë ai vend do të ketë qëndrueshmëri fiskale d.m.th. pa u nënshtuar korrektimeve jorealiste mbi të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore.

Në këtë drejtim sistemi tatimor ka dy qëllime të rëndësishme: *Qëllimi ekonomik*, ku nëpërmjet taksimit, qeveria synon të tërheqë burimet e nevojshme për të kryer shpenzimet publike, dhe *qëllimi social*, i cili realizohet nëpërmjet rishpërndarjes së të ardhurave me qëllim që të përfitojnë edhe ata individë me të ardhura të pamjaftueshme. Prandaj, siq është shpjeguar nga Rosen (2003), “ Në përgjithësi arti i qeverisjes konsiston në mbledhjen e sa më shumë të hollave nga një klasë e popullsisë, për transferimin e tyre për të mirën e një grupi tjetër ”, (Rosen, H., 2003: 164).

Sipas Lymer dhe Oates (2009) ekzistojnë edhe funksione tjera të tatimeve si reduktimi i pabarazisë nëpërmjet politikave të rishpërndarjes së mirëqenies dhe rishpërndarjes së të ardhurave, në mënyrë që të zbutet pabarazia në mes të të pasurve dhe të varfërve. Për këtë arsye sistemet tatimore janë ndërtuar për të realizuar edhe qëllime sociale për të dekurajuar aktivitet të caktuara të padëshiruara dhe për të mbrojtur mjedisin.

Megjithatë, duke përdorur një model të thjeshtë të përshtatur nga George A. Akerlof (1978), J.A. Amegashie, (2009:55-57), tregon se përveq nevojës për të ruajtur stimuj në krijimin e të ardhurave, nëse qeveria vendosë një taks me të madhe (maximale) për personat me të ardhura më të larta krahasuar me ata më të ardhura me të ulëta, atëherë kjo do të shkaktojë efekte dekurajuese për personat me të ardhura me të larta dhe i shtyen ata të krijojnë me pak punë dhe të fitojnë të ardhura me të ulëta, në mënyrë që të ardhurat e

tyre mos të shpërndahen për personat me të ardhura me të ulëta duke e kufizuar në këtë mënyrë aftësinë e qeverisë për të rishpërndarë të ardhurat.

Nisur nga përkufizimet e lartcekura, qëllimet dhe efektet themelore të tatimeve qëndrojnë në rritjen e të ardhurave për të financuar qeverinë. Paratë e sigurura prej tatimeve gjatë gjithë historisë janë përdorur nga shtetet përkatëse për të kryer shumë funksione. Disa nga këto përfshijnë shpenzimet për infrastrukturë (rrugë, transport publik, siguri publike, arsim, shëndetësi), për shpenzimet ushtarake, kërkime shkencore, kulturë dhe arte, shërbimet publike dhe mirëqënien si dhe funksionimin e vetë qeverisë. Në rastet kur këto shpenzime tejkalojnë të ardhurat, qeveritë akumulojnë borxhe dhe në raste të këtilla një pjesë e tatimeve përdorën për të paguar këto borxhe, (Simkovic, M., 2015: 1982-2041).

2.1.2 Zhvillimi i tatimeve gjatë historisë

Tatimet janë të lashta gati sa edhe vetë njerëzimi. Ato përbëjnë një element të rëndësishëm të ekzistencës njerëzore në shoqëri dhe një tipar i pashmangshëm i disa qytetërimeve qysh nga lashtësia. Qysh në disa qytetërime të lashta përfshirë, babilonasit greket dhe romaket, janë vënë taksat për qytetarët e tyre për të paguar shpenzimet ushtarake dhe shërbimet e tjera publike. Që nga Babilonia e lashtë hasen gjurmët e pagesës së taksave. Familjet e lashta paguanin taksat në natyrë për bagëtinë e tyre. Pothuajse, çdo gjë tatohej bagëtia, tregtia, peshkimi madje edhe funeralet. Por detyrimi me i rëndë për një familje ishte obligimi i punës. Kjo në gjuhën babilonase u quajtë “barrë”. Për familjet që nuk kishin mundësi të paguenin në natyrë, ato përballëshin me shumë muaj shërbim pune qoftë në korrijen e fushave të qeverisë, hapje të kanaleve apo me keq për të kryer shërbimin ushtarak, në luftra jashtë vendit. Ndërsa, që në fillim të dinastisë së parë të Mbretërisë së

vjetër në Egjiptin e vjetër 2800-3000 vite para erës sonë, Faraoni u shfaq para popullit të tij për të mbledhur taksat. Egjiptianët e lashtë përballëshin me taksa të rënda, të cilat ishin së paku vjetore, dhe përfshinin bagëtinë, të korrat dhe lloje të ndryshme të punës së njeriut. Por, taksat vendosëshin edhe ad hoc në çdo kohë që Faraoni e shihte të arsyeshme në raste të ndonjë fushatë ushtarake ose punë në varret mbretërore. Praninë e taksave e hasim edhe në Perandorinë e lashtë romake. Perandori romak Diokleciani 248-305 para erës sonë kishte projektuar ndryshimin e strukturës së taksave. Ai kishte rivendosë taksat e tokës për pronarët italian të tokave dhe gjithashtu kishte imponuar tarifa të veqanta në të holla për tregtarët dhe shoqëritë e korporatave, (Sharlach,T., Silverman D., White D., 2002).

Të dhëna të shumta të mbledhjes së taksave të qeverive në Europë ende janë në dispozicion që nga shekulli i 17-të. Tatimet si përqindje e prodhimit përfundimtar të mallrave kishin arritur nga 15-20 %, gjatë shekullit në vende të tilla si Franca, Holanda dhe Skandinavia. Në fund të shekullit 18 dhe në fillim të shekullit 19, gjatë viteve të luftës, normat e taksave u rritën në mënyrë dramatike në Europë për shkak se lufta ishte bërë e shtrenjët, qeveritë me të centralizuara dhe me të afëta në mbledhjen e taksave. Kjo rritje ishte me e madhe në Angli se sa në Francë, në vitet e para të Revolucionit Francezë. Në Francë taksat ishin me të ulëta, por barra e tyre ishte kryesisht mbi pronarët, individët dhe tregtarët e brendshëm, duke krijuar kështu shumë pakënaqësi, (Hoffman, Phillipe & Kathryn Norberg, 1994, fq. 300).

Sistemet moderne tatimore nisën të krijohen në Europën përendimore dhe SHBA në periudhën pas revolucionit Francez dhe atij Amerikan. Një nga sistemet me të ndërlikuar tatimore sot në botë është ai Gjermanisë, ai ka 118 Ligje, 185 forma dhe udhëzime, 96 000

rregulla. Ndërsa, sistemi tatimor i SHBA-së ka rreth 1177 forma dhe udhëzime, (IRS, 2013).

2.1.3 Parimet e sistemit tatimor

Sistemi tatimor i çdo vendi duhet të bazohet në disa parime të shëndosha me anë të së cilave arrihen qëllime të ndryshme të politikës tatimore. Për përcaktimin e politikave tatimore, shteti mbështetet në disa parime tatimore. Me formulimin e parimeve tatimore janë marrë shumë teoricient, mirëpo, në këtë temë do të prezantohen parimet themelore të tatimeve të cilat u formuluan në gjysmen e dytë të shekullit XVIII, nga Adam Smith; parimet tatimore të Adolph Wagner të formuluara në fund të shekullit XIX dhe parimet tatimore të Joseph Stiglitz të formuluara në fund të shekullit XX.

Adam Smith në librin tij të famshëm “Hulumtimet mbi natyrën dhe shkaqet e pasurimit të kombeve” (1776), i ka formuluar katër parime tatimore që karakterizojnë një sistem kombëtar të mirë dhe efektiv të taksave. Parimet e paraqitura nga Adam Smith që duhet të ndiqen në një sistem tatimor janë:

Parimi i parë- Aftësia kontribuese dhe Drejtësia

- *Tatimpaguesit duhet të kontribuojnë në të ardhurat e shtetit në përpjestim me kapacitetet përkatëse, që do të thotë në përpjestim me të ardhurat të cilat i gëzojnë nën mbrojtjen e shtetit.*

Kjo mund të interpretohet si e dhënë në buxhetin e shtetit në të njëjtën përqindje për të njëjtin objekt dhe bazë tatimore, pra çdo person duhet të paguaj në vartësi të aftësisë paguese apo, siç njihet ndryshe si parimi i drejtësisë. Kështuqë, tatimpaguesit që kanë të ardhura me të mëdha duhet të paguajnë përqindje me të madhe të asaj të ardhure në buxhetin e shtetit.

Parimi i dytë – Siguria

- *Çdo tatimpagues duhet të jetë i qartë se: kur si dhe sa tatime duhet të paguaj. Pra, koha e pagimit, mënyra dhe sasia për t'u paguar duhet të jenë të qarta dhe jo arbitrare për kontribuesin.*

Sikurse është paraqitur nga Smith, ky rregull është i një rëndësie të madhe dhe ka treguar këtë si një nga tiparet me të rëndësishme të një sistemi tatimor. Zbatimi i këtij parimi kërkon një sistem tatimor me norma të thjeshta që aplikohet në çdo transaksion ku secili njeh normën tatimore dhe sigurinë e zbatimit të timit, dhe ajo që është më e rëndësishmja, nuk duhet të këtë përjashtime arbitrare nga ky rregull.

Parimi i tretë - Përshtatshmëria

- *Çdo tatim duhet të mblihet në kohën dhe në mënyren që është më e përshtatshme për tatimpaguesin.*

Adam Smith tregon se kjo është shumë e rëndësishme edhe për tatimpaguesin, që të paguaj tatimet në kohë por, edhe për targambledhësin që t'i mbledhë tatimet në kohë. Pra, zbatimi i këtij parimi nënkupton që tatimi duhet vendosur në momentin kur tatimpaguesi pritët të marrë të ardhurat ose të zotëroj pasurinë.

Parimi i katërt - Eficienca

- *Çdo tatim duhet të kthehet të shoqëria në vlerë të ngjashme me vlerën e tatimit të mbledhur nga shoqëria.*

Situata e përkryer do të ishte që në të njëjtën vlerë që është mbledhur të kthehet në shoqëri, megjithatë kjo nuk do të thotë edhe shpenzimet e administratës, sepse ajo është e pamundur. Pra, zbatimi i këtij parimi nënkupton që kostot direkte dhe indirekte të pagimit dhe mbledhjes së tatimeve duhet të jenë sa më të vogla.

Parimet e përmendura me lartë janë parime standarde tatimore, pavarësisht se ato u prezentuan në vitin 1776, ato janë ende të një rëndësie shumë të madhe, pasi ato paraqesin bazat e çdo sistemi tatimor efektiv. Sistemet tatimore kanë ndryshuar gjatë shekujve. Në kohët e lashta ato janë bazuar kryesisht në taksat e paguara në natyrë, atëherë ato evoluojnë në pagesa në të holla. Sistemet e taksimit gjithashtu u bënë me komplekse, duke përfshirë shumëllojshmërinë e tatimeve dhe futjen e normave tatimore. Për shkak të rritjes së numrit të lidhjeve ndërkombëtare çështja e taksimit të dyfishtë u ngrit. Në ditët e sotme, kur procesi i globalizimit është i pashmangshëm, çështja e transferit të çmimit dhe evazioni fiskal janë tema të rëndësishme. E gjithë kjo i bënë sistemet tatimore të ndryshme nga ato që ishin, megjithatë parimet e taksave të paraqitura nga Adam Smith duhet ende të zbatohen. Ato janë univerzale dhe çfarëdo sistemi tatimor është ai duhet t'i përfaqësojë ato parime. Pavarësisht nga rrethanat të ndryshme ekonomike deklarata se sa më i thjeshtë që është sistemi i taksave, aq më i mirë është, ende qëndron e vërtetë.

Një sistemim dhe plotësim të mirë të parimeve të përgjithëshme të tatimeve e ka dhënë gjithashtu A. Wagner në shkrimin e tij “ Parimet bazë tatimore”, në vitin 1890, dhe i ka klasifikuar ato në 4 grupe:

- Parimet financiaro - politike që janë mjaftueshmëria dhe elasticiteti i tatimit.
- Parimet ekonomiko - politike që janë zgjedhja e burimit dhe llojit të tatimit.
- Parimet socio - politike që përfshijnë përgjegjësinë dhe barabarsinë e tatimit.
- Parimi Administrativ (teknik) përfshinë caktimin e tatimit, pagimi i volitshëm i tatimit dhe mbledhja e tatimit (arkëtimi me kosto të mundëshme sa më të ulët).

2.1.4 Karakteristikat e sistemit tatimor

Në përgjithësi pranohet se një sistem tatimor optimal duhet të mbështetet në disa karakteristika themelore. Këto karakteristika gjegjësisht standarde tatimore të dëshiruara për çdo sistem tatimor i ka formuluar Joseph E. Stiglitz, fituesi i çmimit nobel në ekonomi, (siç është cituar nga Stabile ,2011), këto karakteristika janë: Efektiviteti ekonomik; Thjeshtësia administrative; Fleksibiliteti; Përgjegjësia publike dhe Drejtësia.

Efektiviteti ekonomik:

- *Sistemi tatimor duhet të ndërhyjë minimalisht në efektivitetin e alokimit të burimeve.*

Kemi thënë se qëllimi i politikës fiskale është mbledhja e tatimeve për të financuar shpenzimet publike mirëpo, ndërhyrja e shtetit në ekonomi përmes zbatimit të ligjeve dhe rregullave të sistemit tatimor ndikon vazhdimisht në sjelljet e aktorëve në ekonomi duke shkaktuar kështu efekte të ndryshme të tatimit mbi efektivitetin ekonomik.

Thjeshtësia administrative:

- *Sistemi tatimor duhet të jetë i thjeshtë dhe relativisht pak i kushtueshëm nga pikpamja administrative.*

Administrimi i sistemit tatimor kërkon edhe kosto të krijuara prej tij, ku dallohen dy lloje:

Kostot direkte janë kostot e funksionimit të organeve tatimore dhe

Kostot indirekte rëndojnë tek tatimpaguesit dhe përfshijnë një shumëllojshmëri kostosh si: koha për të plotësuar formularët e deklarimit tatimor, koston e mbajtjes së regjistrave kontabël, koston e shpërblimeve të konsulenteve tatimor.

Kostot administrative të një sistemi tatimor varen nga një sërë faktorësh si: nga kompleksiteti i normave tatimore; nga shpeshtësia e dorzimit të deklaratave tatimore, koha e plotësimit të deklaratave dhe normat efektive të detyrimeve tatimore.

Fleksibiliteti

- *Sistemi tatimor duhet të jetë i aftë t'i përgjigjet lehtë kushteve të ndryshme ekonomike.*

Ndryshimi i kushteve të ekonomisë e bënë të domosdoshme edhe ndryshimin e normave tatimore, në disa struktura tatimore ndryshimi është lehtë i realizueshëm, disa kërkojnë hapësirë të gjërë të debatit politik e disa ndryshime vijnë automatikisht. Në rastet kur synohet ndryshim i normave përmes reformave tatimore, realizimi i saj përbën burim për ndezjen e një debati politik. Një aspekt i rëndësishëm i fleksibilitetit të sistemit tatimor si instrument i stabilitetit ekonomik është edhe koha dhe shpejtësia e implementimit të normës së re ligjore dhe ndikimet apo vonesat e mundshme në grumbullimin e të ardhurave tatimore.

Përgjegjësia publike

- *Individët duhet të dijnë se çfarë ata janë duke paguar dhe pse në mënyrë që të konstatojnë se sa saktësisht sistemi reflekton llogaridhënje, dhe të vlersojnë se sa reflekton sistemi preferencat e tyre.*

Pra, sistemi tatimor duhet të jetë transparent me qëllim që qytetarët të njohin barrën e tatimit që ata do të paguajnë. Qeverisja nuk duhet të fitoj avantazh ndaj qytetareve të painformuar. Shpesh qeverisjet qëllimisht interpretojnë ndryshe kostot e vërteta të shërbimeve dhe ndryshe i përceptojnë ata që pësojnë nga këto kosto.

Drejtësia

- *Sistemi tatimor domosdoshmërishtë duhet të jetë i drejtë, i paanëshëm në raport me trajtimin e qytetarëve të ndryshëm.*

Një sistem tatimor i drejtë dhe optimal duhet të frymëzohet nga parime paanësie, të kuptuara qoftë në rrafshin horizontal si trajtim i barabartësh, qoftë edhe si paanësi vertikale, që kërkon trajtim për subjekte në situata të ndryshme. Ka dy koncepte të rëndësishme të drejtësisë: *Drejtesia horizontale dhe Drejtesia vertikale*

Drejtesia horizontale nënkupton se tatimpaguesit në gjendje të ngjashme financiare duhet të paguajnë sasi të njëjta (të trajtohen njëjtë) në tatime. Ndërsa, drejtësia vertikale nënkupton se tatimpaguesit të cilët janë në gjendje me të mirë me të ardhura duhet të paguajnë taksa me të larta se sa ata më të ardhura më të ulëta, për sa kohë që rritja e nivelit të taksave konsiderohet të jetë e arsyeshme. Edhe pse parimi i barazisë horizontale përbëhet nga ideja se individët që fitojnë sasi të njëjta të të ardhurave duhet të tatohen në mënyrë të barabartë, megjithatë, siç është përshkruar nga Holcombe, persona me të ardhura të njëjta mund të mos kenë aftësinë e njëjtë për të paguar për faktin se mund të këtë persona që jetojnë të vetëm dhe shpenzimet e tyre janë më të vogla ndërsa, ka persona që janë të martuar dhe me fëmijë e që kostoja e tyre e jetesës është më e lartë. Kjo pra, kjo ngre një pyetje se si qeveria duhet të trajtojë këto qështje për qëllime tatimore. Pra, në situata të tilla është e mundur për të aplikuar parime të ndryshme për të arritur një zgjidhje logjike por këto janë qështje ligjore dhe mund të jetë e vështirë për të arritur zgjidhje për çdo situatë. Pra, mbetet në dorën e qeverive të vendeve përkatëse për të përcaktuar se çfarë strukture tatimore ka për të zbatuar, (Holcombe, 2006).

Barazia vertikale parashehë që qeveria duhet të zbatojë taksa më të larta për ata që kanë aftësi më të lartë për të paguar se sa për ata që kanë aftësi më të ulët për të paguar. Megjithatë, për të zbatuar parimin e barazisë vertikale duhet ballafaquar me probleme, për

shkak së hartuesit e politikave përveq që duhet të përcaktojmë çfarë do të thotë për të pasur aftësi me të lartë për të paguar dhe, se cilët janë ata që duhet të paguajnë normë më të lartë si dhe të përcaktohet se sa me tepër duhet të paguajë një person me aftësi më të lartë se një tjetër me aftësi më të vogël pagese. Megjithëse, koncepti i barazisë vertikale është i nevojshëm për të krijuar dhe zbatuar një kod të drejtë tatimor, për shkak të kompleksitetit dhe normës (më të lartë tatimore për ata me të ardhura më të larta), ata që kanë të ardhura më të larta janë në gjendje për të shmangur tatimin, pra, ndikon negativisht në sjelljen e individëve duke i stimuluar ata që të tërhiqen nga tregu, duke shkaktuar normë më të ulët prodhimi, (Feldstein, 2008).

2.1.5 Llojet e tatimeve

Barazia vertikale përfshinë klasifikimin e tatimeve si: proporcionale, regresive dhe progresive. (Oklahoma Policy Institute).

Varësisht nga ndryshimet që pëson norma mesatare e tatimit me rastin e shtimit të të ardhurave, tatimet ndahen në: *proporcionale* - në rast se norma rezulton konstante; *progresive* - kur norma tatimore rritet dhe, *regresive* - kur norma tatimore zvogëlohet).

Tatimet proporcionale

- *Përkufizimi i tatimit proporcional paraqet situatën kur raporti i tatimit të paguar me të ardhurat është konstant, pa marrë parasysh nivelin e të ardhurave (Rosen,H.R, 2003:311).*

Prandaj, tatimet janë proporcionale kur norma mesatare tatimore e shprehur në % ndaj vlerës së bazës tatimore, nuk ndryshon me ndryshimin e kësaj të fundit.

Tatimi proporcional (taksa e sheshtë) është atëherë kur me ligj përcaktohet një normë e caktuar tatimi pa marr parasysh bazën e tatueshme. Kështuqë me rritjen e të ardhurave, në

përpjestim të drejtë rritet edhe barra tatimore dhe e kundërta. Zbatimi i normës tatimore proporcionale ka anët e veta pozitive dhe negative. Anët pozitive janë: Thjeshtim i sistemit tatimor dhe kostso më e ulët e procesit të mbledhjes, llogaritjes dhe pagesës së tatimeve si për qeverinë ashtu edhe për bizneset; rritje e të ardhurave në buxhet, pasi thjeshtimi i sistemit tatimor zvogëlon informalitetin dhe rritë numrin e tatimpaguesve; dekurajohet evazoni fiskal dhe stimulohet krijimi i të ardhurave /fitimit; favorizohet neutraliteti fiskal pasi që parashikimet dhe veprimet e agjenteve ekonomik lirohen nga frika dhe dyshimet për efekte të papritura dhe të pallogarituara nga efekti i taksave. Ndërsa, nuk ka prova bindëse se ky lloj tatimi stimulon në mënyrë direkte rritjen e produktivitetit të bizneseve dhe shton punësimin; dhe nëse nuk ka një prag minimal për fillimin e aplikimit të këtyre normave, ekziston rreziku që, të ardhurat e ulëta të taksohen më shumë se sa të ardhurat e larta.

Tek tatimi proporcional norma marxhinale është e barabartë me normën tatimore mesatare.

Tatimet progresive

- Tatimi është progresiv në rastet kur tarifa mesatare e tatimit rritet me rritjen e të ardhurave (*Rosen,H.R, 2003:311*).

Pra, Tatimet janë progresive apo me norma jo fikse, kur shprehin rritjen e normës tatimore krahas me rritjen e bazës tatimore. Normat tatimore progresive, zbatohen në një përqindje më të lartë për përfituesit e të ardhurave të larta, në krahasim me individët apo subjektet që zotërojnë të ardhura më të ulëta. Argumentet kryesore për vëndosjen e këtij lloji tatimi janë: Duke tatuar më shumë të pasurit, krijohet me shumë mundësi për konsum të varfërve; Duke tatimuar të ardhurat e larta luftohet akumulimi i kapitalit dhe përdorimi i tij për fitime akoma më të mëdha; Duke grumbulluar më shumë të ardhura në buxhet, shteti ka më

shumë mundësi të ofroi në mënyrë të barabartë e në një shkallë të gjërë shërbime publike të rëndësishme si arsimi, shëndetësia, infrastruktura, transporti, mbështetja sociale etj.

Në rastin e tatimit progresiv, norma marginale është më e lartë se norma mesatare.

Tatimet regressive

- *Tatimet janë regressive kur tarifa mesatare e tatimit ulët kur rritet madhësia e bazës tatimore (Rosen,H.R, 2003:311).*

Kjo do të thotë se norma marxhinale e tatimit është më e vogël se norma mesatare e tatimit për të gjitha kategoritë e të ardhurave. Në këtë rastë individët me produktiv favorizohen duke i tatimuar të ardhurat shtesë të tyre me tarifa më të ulëta. Nisur nga këto karakteristika këto taksa kanë tendencë për të zvogëluar barrën tatimore të njerëzve me aftësi më të lartë për të paguar duke e zhvendosur këtë barrë tek personat me aftësi më të ulët për të paguar. Do të thotë këto taksa rëndojnë më tepër tek të varfërit se sa tek të pasurit. Prandaj, tek këto lloj normave tatimore nuk ekziston një mardhënje e anasjelltë në mes të normës tatimore dhe aftësisë së tatimpaguesit për të paguar, e matur në kapital, konsum apo fitim, (James Simon,1998: 299).

Tatimi i paragjykuar (paushall)

Tatimi i paragjykuar është një tatim me normë fikëse, shuma që duhet të paguhet mbetet konstante pamvarësisht nga të ardhurat apo pasuria që mbahet në pronësi nga individët apo edhe bizneset. Pra, është një lloji i tatimit që nuk krijon barrë të tepërtë. Sipas Sadka & Tanzi siç është cituar nga Pashev, K.,(2006), taksat e paragjykuara janë ndër taksat me të vjetra, format me të herëshme të tyre datojnë që nga shekulli i 18, kur burimi kryesor i të ardhurave ishin të hyrat nga bujqësia, bazuar në vlerën e tokës në Principatën e Milanos. Me shfaqjen e shtetit social në shekullin XX konsiderata ndaj tatimit të kapitalit u

përqendrua në taksimin progresiv, deri në dekadën e fundit të shekullit XX kur treguesit bazë të tatimit të paragjykuar u sollën përsëri në përdorim aktiv. Qëllimi i këtyre tendencave të reja në aplikimin e tatimit të paragjykuar ishte zgjerimi i shpejtë i ekonomisë joformale. Tatimi i paragjykuar synon përmirsimin e efikasitetit të mbledhjes së tatimit përmes tri grupeve efektive të synimeve: a) reduktimin e shpenzimeve të tatimpaguesve; b) uljen e kostove administrative të pajtueshmërisë me taksat dhe c) kalimin nga rruga informale në ekonomi formale përmes vetëvlërsimit të të ardhurave të tyre nga tatimpaguesit. Argumenti qëndron në atë se tatimpaguesit kanë nxitje për të prodhuar në nivel me të lartë për shkak se shkalla marginale e tatimit mbi këto të ardhura shtesë është zero. Për më tepër një tatim i paragjykuar thuhet se zvogëlon mundësitë për korrupsion sepse minimizon ndërveprimin e drejtpërdrejtë midis tatimpaguesve dhe inspektorëve tatimor. Mirëpo, përkundër avantazheve të përdorimit të tij, ekzistojnë edhe disavantazhe, prania e një pragu të lartë për zbatimin e tij është pengesë për bizneset e vogla në të kundërtën përdorimi i këtij lloji tatimi bënë thirrje për përdorimin e normave të shumëta tatimore që pastaj krijon paknaqësi tek kompanitë e mëdha që veprojnë nën regjimin e normave standarde të tatimit duke i shtyer ato për evazion fiskal.

2.1.6 Sistemi optimal tatimor

Krijimi i një sistemi tatimor nuk është thjesht krijimi i disa parimeve, rregulloreve dhe institucioneve përkatëse që shërbejnë për të mbledhur taksat, mirëpo sistemi tatimor ka nevojë gjithmonë për rregullime për të arritur një sistem tatimor optimal. Qeveritë përdorin lloje të ndryshme të taksave dhe ndryshojnë normat tatimore për të përfituar një sistem tatimor optimal i cili llogaritet i tillë atëherë kur barra fiskale është e shpërndarë në mënyrë të drejtë tek të gjithë tatimpaguesit dhe investitorët, në mënyrë që të mos shkaktojnë

shtrembërime në sjelljet dhe vendimet e tyre për të investuar dhe paguar detyrimet e tyre tatimore. Një sistem tatimor është vështirë për t'u dizajnuar dhe vlerësuar duke pasqyruar ndikimin e një sërë faktorësh makroekonomik, gjeografik apo historik të një vendi, të cilët ndikojnë në llojin, strukturën, normën dhe natyrën e taksave.

Për të pasur një sistem tatimor optimal ekzistojnë disa parime të cilat duhet të jenë pjesë e sistemit, të cilat janë: Efektiviteti ekonomik, thjeshtësia administrative, fleksibiliteti, përgjegjësia politike dhe drejtësia, e të cilat i kemi trajtuar pak më lartë.

Dizajnimi i një sistemi tatimor optimal është qështje komplekse dhe që ka tërhequr vëmendjen e teoricientëve dhe hartuesve të politikave tatimore për një periudhë të gjatë.

Frank P. Ramsey (1927) ishte i pari që zhvilloi një teori për taksat optimale në lidhje me shitjen e mallrave, problem i cili ishte i lidhur ngusht me çmimet optimale monopolistike kur fitimet ishin të detyruara të jenë pozitive. Kontributi i Ramsey-t ishte shumë i rëndësishëm në teorinë e tatimeve optimale nga pikëpamja ekonomike që për qëllim kishte rregullimin e normave tatimore të konsumit në bazë të disa kufizimeve specifike. Si një përpjekje për të zvogëluar barrën e tepërt të taksave mbi konsumin, Frank Ramsey në vitin 1927 sygjeroi që projektuesi duhet të rrisë të ardhurat përmes taksës mbi konsumin. Ai tregoi që një tatim i tillë duhet të aplikohet në raport të anasjelltë me elasticitetin e kërkesës së konsumatorit në lidhje me produktin, d.m.th. produktet që kanë kërkesë inelastike duhet të tatohen më shumë. Kjo teori pati një impakt të madh në teorinë e taksimit, por nga ana tjetër nuk është shumë bindëse. Taksa optimale është një taksë e thjeshtë lump sum dhe mëqenëse rëndon njësoj tek të varfërit dhe të pasurit përbën një barrë më të madhe në të ardhmën, krijon paknaqësi tek masa e gjer, është vështirë për t'a aplikuar. *Peter Diamond dhe James Mirrlees (1971)* duke përdorur teorinë Ramsey si bazë

për studimet e tyre, propozojnë një model ndryshe nga ai Ramsey duke u lejuar projektuesve të taksave të marrin në konsideratë sistemet me lloje të shumëta taksash dhe modeli i tyre ka triumfuar në teorinë tatimore. Diamond dhe Mirrles në vitin 1971 argumentuan se: të ardhurat ndryshojnë varësisht nga aftësia e individit (tatimpaguesit) për të fituar. Për shkak se të ardhurat e tyre përcaktohen nga aftësitë dhe përpjekjet e tyre për të fituar, nëse qeveria vendos një taks më të lartë për ata me aftësi më të madhe për të fituar atëherë këta individ dekurajohen për të fituar me shumë dhe kështu përballen me kompromisin e qeverisë midis barazisë dhe efikasitetit. Prandaj, planifikuesit e taksave sipas Diamond dhe Mirrles duhet të zbatojnë një sistem tatimor që ofron stimujt e duhur për individët dhe për të zbuluar aftësitë e tyre të vërteta për të fituar të ardhura. Ata duke diskutuar mbi ekzistencën e një norme marxhinale tatimore për individet me të ardhura më të larta erdhën në përfundim se shkalla marxhinale për të ardhurat më të larta duhet të jetë 0. Kështuqë, në modelin e Diamond/Mirrles optimizimi mund të arrihet atëherë kur normat marxhinale janë 0 (zero), pra kur aplikohet sistemi proporcional i tatimeve.

Më pastaj kanë qenë të shumta sygjërimet mbi teoritë e një sistemi fiskal optimal të përshkruara nga Mankiew, et.al., (2009), i cili kritikoi modelin Ramsey se projektuesit mund të rrisin të ardhurat nga taksat përmes taksave vetëm në mallra por argumentoi se teoria e Diamond/ Mirrless është shumë komplekse sepse është vështirë për të gjetur individët që prodhojnë në nivelet e tyre maksimale, nga të cilat janë nxjerrë tetë mësim të përgjithshme që sygjeron kjo teori, si: Normat marxhinale optimale të tatimeve varen nga aftësia e shpërndarjes; normat marxhinale të tatimeve mund të ulën tek të ardhurat e nivelit të lartë; një taksë e sheshtë me një transfertë universale lump sum mund të jetë afër optimalës; shtrirja optimale e rishpërndarjes rritet me pabarazinë e pagave; tatimet duhet t'i

referohen si karakteristikave personale ashtu edhe të ardhurave; vetëm produktet e finale duhet të tatimohen dhe atë në menyre uniforme; të ardhurat kapitale nuk duhet të tatohen; në ekonominë dinamike dhe skolasitike politikat optimale të tatimeve kërkojnë një sofistikim të lartë. Mirëpo, në praktikë, jo të gjitha nga mësimet e lartëcekura merrën në konsideratë gjatë hartimit të politikave fiskale në vende të ndryshme.

Joel Slemrod, (1990) propozoi se një aplikim praktik i teorisë optimale të sistemeve tatimore është implementimi i tatimit në vlerën e shtuar, pra një taks mbi blerjen e një të mire apo shërbimi për të korrigjuar evazionin fiskal. Ndërsa, Emmanuel Saez, (2001) për teorinë optimale të tatimeve propozon llogaritjen e normave optimale tatimore mbi të ardhurat përmes formulës së elasticitetit në mënyrë që për njerëz me të ardhura më të larta përcaktohet norma marxhinale e tatimit për të ardhurat e punës dhe ajo normë duhet të jetë në mes të 50 dhe 80 % në mënyrë që të jetë në nivel optimal.

Literatura mbi teorinë e taksimit optimal në përgjithësi e trajton vendimarrësin e politikave fiskale si utilitarian, pra, që konsiston në maksimizimin e mirëqenies sociale të individëve në shoqëri. Për të përcaktuar se sa i vlefshëm është një sistem tatimor duhet të analizohet e gjithë struktura e tij sipas normave ligjeshlative dhe në përmbajtjen e tyre konkrete, e cila varet nga gjendja ekonomike e vendit, sjellja e kontribuesve dhe administrata financiare. Duke pasur parasysh të gjithë faktorët e shtjelluar me lartë mund të thuhet se nuk ekziston një sistem optimal tatimor për të gjitha vendet dhe në çdo kohë, pasi që sistemi tatimor duhet t'i përshtatet kushteve ekonomike dhe mjedisit në të cilin vepron duke synuar arritjen e objektivave kryesore të tij.

2.1.7 Elementet kryesor të sistemit tatimor

Elementet kryesor të një sistemi tatimor janë:

Subjekti i tatimit – është personi apo shoqëria që ka për detyrim të mbledhë, të mbajë në burim dhe të transferoi në buxhetin e shtetit detyrimet tatimore (tatimpaguesi).

Objekti tatimor – ka të bëjë me gjendjen faktike, me verifikimin e së cilit lind detyrimi tatimor mbi një subjekt të caktuar që quhet tatimpagues.

Baza e tatueshme – është vlera (shuma) e të ardhurave mbi të cilën vendosët një tatim. Ajo mund të ndryshoj duke marr parasysh zbritjen mbi këtë bazë të shpenzimeve të ndryshme në formë të përjashtimeve dhe lehtësimeve të llojeve të ndryshme, të cilat e dallojnë bazën e tatueshme nga ajo që rrjedhë nga objekti tatimor.

Norma tatimore - Tatimet zakonishtë vendosën të shprehura në përqindje, e quajtur norma tatimore me të cilën një individë apo biznes tatimohet. Ka disa metoda për llogaritjen e tatimeve përmes normave tatimore të aplikuara mbi një bazë tatimore siç janë: normat statusore, normat mesatare, normat marxhinale dhe normat efektive.

Norma statusore është norma e imponuar me ligj. Tek disa lloje tatimi mbi të ardhurat mund të këtë norma të shumfishta ligjore për nivele të ndryshme të ardhurash por, ka lloj tatimi që mund të këtë vetëm një normë të sheshtë statusore.

Norma mesatare tatimore është raporti në mes të shumës totale tatimeve të pagura dhe bazës totale tatimore (të ardhurave të tatueshme). Tek disa lloje tatimi si për shembull, tatimet proporcionale ku norma tatimore është fikse, atëherë norma mesatare e tatimit është e barabartë me normën fikse. Ndërsa, norma mesatare tatimore vjenë në shprehje tek tatimet progresive ku norma mesatare rritet me rritjen e pjesës të të ardhurave që tatohen me normën më të lartë tatimore progresive.

Norma marxhinale tatimore i referohet normës më të lartë tatimore që aplikohet të tatimet progresive, do të thotë për çdo të ardhurë shtesë të nivelit më të lartë të të ardhurave që taten me normën më të lartë progresive, norma marxhinale rritet. Ndërsa, tek taksa e sheshtë ku të gjitha të ardhurat taten me të njëjtën %, pavarësisht shumës së të ardhurave, norma marxhinale është 0.

Norma efektive tatimore ka kuptime të ndryshme në konteste të ndryshme. Ajo përdoret për të bërë përlogaritjen e tatimit të paguar të kompanisë si % e të ardhurave të tatueshme vjetore për qëllime financiare të kontabilitetit, (IAS, 12 paragraphs 86). Gjithashtu, ajo përfshinë vlerësimet ekonometrike, duke u bazuar në të dhënat aktuale apo edhe në supozime apo simulime.

2.1.8 Klasifikimi i sistemeve tatimore

Perspektiva evropiane siç përshkruhet nga Hutsebaut, M.(2013) mbështetet në tri shtylla të sistemeve tatimore: Sipas llojit të tatimit; bazës së tatueshme dhe nivelit administrativ.

Sipas llojit të tatimit, tatimet ndahen në: Tatimet direkte, tatimet indirekte dhe kontributet sociale. Tatimet direkte përfshinë tatimin mbi të ardhurat personale, tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin e korporatave. Tatimet indirekte përfshinë TVSH-në, taksat dhe akcizën për produktet e importuara.

Sipas bazës tatimore, ku bëjnë pjesë taksat e konsumit, punës dhe kapitalit.

Në taksat e konsumit bëjnë pjesë TVSH-ja , akciza dhe taksat doganore. Në taksat mbi punën hynë tatimi në paga dhe kontribute sociale (pensionale). Në tatimin mbi kapitalin hynë tatimi mbi fitimin e korporatave, tatimi mbi të ardhurat personale, tatimi mbi lojrat e fatit , tatimi mbi biznesin e vogël dhe, në fund tatimet ndahen:

Sipas nivelit të qeverisë në: qendrore dhe lokale (M. Hutsebaut, 2013).

Tatimet quhen direkte sepse godasin menjëherë (direkt) aftësinë kontribuese të tatimpaguesit. Barra tatimore në këtë rast nuk mund të zhvendoset, atë e bartë personi që ka detyrim për t'a paguar tatimin. Tatimet indirekte godasin në mënyrë të tërthortë aftësinë kontribuese, siç është tatimi mbi konsumin e mallrave apo transferimi i pronësisë ku detyrimin për të paguar (dërguar tatimin tek autoritetet tatimore) e ka shitesi i mallrave, ndërsa barrën e tij e bartë konsumatori i cili paguan këtë tatim bashkë me çmimin e mallit, (Mukherje 2005). Në një përkufizim ekonomik mbi taksat direkte dhe indirekte Atkinson, thotë: taksat direkte mund të përshtaten me karakteristikat individuale të tatimpaguesit, ndërsa tatimet indirekte vendosen mbi transaksionet pavarësisht nga rrethanat e blerësit apo shitësit, (Atkinson, A.B., 1977: 590-592.)

Në krahasim me tatimet direkte, tatimet indirekte kanë disa avantazhe siç janë: Rrisin të ardhurat e buxhetit që shoqërohet me rritje të konsumit; shteti kufizon përdorimin e disa mallrave të dëmshme duke ndikuar në rritjen e çmimit të tyre; tatimet indirekte janë pjesë e pagesës për blerjen e mallrave apo shërbimeve. Ndërsa, për konsumatorin, tatimet indirekte janë të favorshme pasi: janë shumë të parëndësishme në çdo blerje si dhe nuk shpenzohet kohë për deklarimin e tyre.

Një tipar i rëndësishëm i sistemit tatimor në shumë vende është dominimi i taksave mbi konsumin ose në përgjithësi taksat indirekte. Për të dokumentuar këtë shembull Gordon dhe Li (2009), siç është cituar nga Agenor et . al., (2012), thonë se taksat e konsumit përbejnë me shumë se gjysmën e të ardhurave totale qeveritare në vendet e varfra, tatimet personale 30%, ndërsa taksat nga të ardhurat e korporatave 13%.

2.2 Shqyrtim literature mbi taksimin dhe rritjen ekonomike

Rritja ekonomike është treguesi më i rëndësishëm në përcaktimin e mirëqënies së një vendi dhe objektivi kyq për qeveritë, ekonomistët dhe organizatat ekonomike të çdo vendi në botë. Rritja ekonomike është treguesi kryesor i përformancës së menaxhimit të burimeve ekonomike të një vendi për një periudhë të caktuar. Nëse përformanca e saj tregon rritje, do të thotë se do të kemi nivel të lartë të të ardhurave për frymë, e me këtë do të kemi me shumë të mira materiale dhe shërbime me të mira për gjithë shoqërinë. Kjo do të reflektohej në arsimim më të mirë, shërbime shëndetsore me cilësore, infrastrukturë me të lartë dhe në përgjithësi me shumë siguri në formimin e mirëqënies sociale në të ardhmën. Rritja ekonomike ishte dhe prapë do të mbetet sfidë për ekonomistët për faktin se ajo është një problem i ndërlikuar sepse në të ndikojnë një numër i madh faktorësh. Në mënyrë direkte, norma e rritjes ekonomike mund të ndikohet përmes zgjedhjes së politikave fiskale dhe efektit që kanë tatimet në vendimarrjen ekonomike si dhe përmes shpenzimeve publike produktive. Teori dhe modele të shumëta përshkruajnë një numër të burimeve të veqanta përmes të cilave rritja ekonomike mund të ndodhë. Financat publike e ndikojnë rritjen ekonomike përmes tri burimeve kryesore: sistemit tatimor, kuadrit institucional dhe nivelit e përbërjes së shpenzimeve publike.

2.2.1 Aspekte teorike mbi taksimin dhe rritjen ekonomike- Shkollat e mendimit ekonomik

Vlerësimi i faktorëve themelorë të rritjes ekonomike është i rëndësishëm për të kuptuar se çfarë roli kanë luajtur në të kaluarën dhe si mund të jetë prespektiva e zhvillimit të tyre në të ardhmen. Në fillim të shekullit 18 dhe deri në fillim të shek 19, ndryshimet e mëdha ekonomike ndikuan në lindjen e disa shkollave ekonomike të cilat kontribuan në nxjerrjen e teorive të shumta mbi rritjen ekonomike nga autor të shumtë kryesisht filozof të asaj kohe.

Fiziokracia - është shkolla e parë e mendimit ekonomik e lindur në rreth vitit 1750 në Francë, e ndërtuar mbi kritikën e Merkantilizmit dhe Colbertizmit. Themelues i kësaj shkolle është Francois Quesnay, teoria e të cilit, për rritjen ekonomike kuptohet si një reagim i politikave merkantiliste të Jean Baptiste Colbert, Minister i financave (1661-1683) gjatë mbretërimit të Lois-it XIV në Francë. Kjo politikë kishte shkaktuar burokraci, taksa të larta për fshatarët që punonin tokën e pronarëve të tokave, politika të cilat ishin në favor të financave mbretërore dhe klasave të larta shoqërore. Rritja në ekonominë rurale varej nga kërkesa për furnizim me bukë, politikat ekonomike dhe fiskale të qeverisë dhe spekulimet nga pronarët e tokave dhe tregtarët (Blaug, 1962: 24.32).

Këto politika shtypëse ndaj fshatarësisë kishin gjeneruar centralizim dhe gjendje të paqëndrueshme socio-ekonomike. Si reagim kundër kësaj gjendje Quesnay propozoi që burimi i vetëm i prodhimit të përgjithshëm vendor është bujqësia dhe si e tillë të ardhurat nga kjo fushë nuk duhet të tatohen, Në vend të tyre duhen tatimuar të ardhurat nga qeraja e pronarëve të tokave (aristokratët), që ishin të përjashtuara nga tatimi dhe atë me një normë të vetme të drejtpërdrejtë tatimi, në mënyrë që të lehtësohej sistemi tatimor (Taylor, Overton, 1960: 22-23). Lirimin nga tatimi e të ardhurave nga bujqësia, Quesnay e arsyetonte në atë se do të ishte e dobishme për shoqërinë, meqenëse me lirimin nga tatimi çmimet e produkteve bien. Ai gjithashtu deklaroi se politikat për tregeti të lirë duhet të miratohen, për shkak se duke lejuar eksportin, kërkesa për ushqime do të rritet, në këtë mënyrë çmimet dhe fitimet fillojnë të rriten, duke u rritur fitimi, fermerët do të jenë në gjendje për të investuar me shumë në rritjen e kapitalit prodhues. Si rezultat i kësaj pronarët e tokave mund t'i rrisin qeratë e tyre për fermerët dhe t'i rrisin të ardhurat e tyre, pastaj

edhe shteti mbledh më shumë taksa nga kjo rritje e të ardhurave nga qeratat dhe i gjithë ky procese do të gjenerojë rritje ekonomike për vendin (Eltis, Walter, 2000:39-59).

Shkolla klasike - Fundi i shekullit 18 dhe fillimi i shekullit 19 u karakterizuan me rritje të jashtëzakonshme të normave të rritjes ekonomike, kështuqë disa filozofë të kësaj kohe u bënë ekonomistët e parë që zhvilluan ato që ne sot i njohim si teoritë klasike të rritjes ekonomike. Autorët kryesor që zhvilluan këto teori janë klasikët liberal si: Adam Smith, Robert Malthus dhe David Ricardo, të cilët nxjerrën në pah se cilat ishin variablat shpjegues që ata konsideronin të rëndësishme në mënyrë që të ndërmerren ndryshimet e duhura për të arritur rritjen ekonomike. Teorive të zhvilluara nga këta autor iu parapriu ajo e Fransua Quesnay sipas të cilit bujqësia është sektori i vetëm i aftë për të gjeneruar tepricë dhe për të arritur këtë ai propozoi që fermerët duhet liruar nga taksat në mënyrë që të riinvestojnë fitimet e tyre. Prandaj, teoria klasike e rritjes është e bazuar në ekzistencën e aktiviteteve ekonomike që gjenerojnë tepricë. Duke mos përjashtuar ndikimin e bujqësisë në rritje Adam Smith prezantoi teorinë se sektori i prodhimit dhe tregtisë janë poashtu të aftë për të gjeneruar fitime. Sipas tij rritja është pasojë e konsumit në sektorët prodhues ndërsa, shpjegoi rëndësinë e çmimeve fleksibile, pra në bazë të ofertës dhe kërkesës, bazuar në forcat e tregut. Smith mendonte që investimi i kapitalit duhet të shkojë në ndonjë vend të aftë për të gjeneruar fitime, pa marrë parasysh origjinën e sektorit të suficiteve. Robert Maltus në teorinë e tij të popullsisë tregoi rëndësinë e kthimit të pakësuar në bujqësi, për të cilën Quesnay e ka konsideruar si kthim të vazhdueshëm dhe mendoi se riinvestimi i tepricës duhet përdorë në rritjen e prodhimit bujqësor. David Rikardo u pajtua me teorinë e Smith-it për tregun, teorinë e Maltus-it për kthimin e pakësuar dhe rritjen ekonomike e shpjegoi me reduktim të taksave, shpenzime të ulëta joproduktive publike, importim të

ushqimit ndërsa propozoi që investimet të bëhën në sektorin e prodhimit jobujqësor sepse investimi në prodhimin bujqësor për shkak të kthimit të pakësuar ulë fitimet dhe shkallën e akumulimit të kapitalit (Lanza, 2012: 51-52).

Në përgjithësi, ideja kryesore e ekonomisteve klasik ishte që rregullimi i ekonomisë të bëhëj përmes një mekanizmi vetrregullues të tregjeve, pra ata mendonin që efienca e tregut të arrihet nga vet mekanizmi i çmimeve në treg si “ një dorë e padukshme” e cila do të sjellte zhvillim ekonomik. Sipas shkollës klasike politika fiskale e duhur është ajo që krijon nxitje për sektorin privat, stimulon prodhimin përmes vendosjes së taksave të ulëta, dhe kufizim të shpenzimeve publike. Në përgjithësi, ekonomistët klasik si A.Smith, (1776), D.Rikardo (1817), Th. Maltus e me vonë F.Ramsey (1928), F.Knight (1944) etj. sollën elementet kryesore të rritjes ekonomike të cilat me vonë kontribuan në zhvillimin e teorive moderne të rritjes ekonomike.

Ndikimi i barrës fiskale në rritjen ekonomike të një vendi është objekt i studimeve të shumta, të autorëve të ndryshëm. Baza teorike e këtyre studimeve qëndron në dy rrymat e mendimit ekonomik, të njohura si teoritë Kejnsiane dhe neoklasike.

Shkolla kejnsiane - Sipas teorisë Kejnsiane të kërkesës agregate, reduktimi i shpenzimeve qeveritare ose rritja e barrës së taksave, reduktojnë kërkesën agregate dhe indirekt edhe të ardhurat, duke transmetuar një ndikim negativ në prodhim. Ideja kryesore e ekonomistëve kejsian, puna e të cilëve është e bazuar në idetë e ekonomistit më të njohur të shekullit XX britanikut, John Maynard Keynes ishte se ekonomia ndikohet nga ndërhyrja e shtetit përmes politilave fiskale. Sipas Kejsit kur ekonomia është në rënie, qeveria duhet të ndërhyjë që të rrisë shpenzimet publike. Ndërsa, për të nxitur ekonominë përmes rritjes së kursimeve, qeveria duhet të ulë tatimet. Ata kanë treguar se në periudha inflacioni shteti

duhet të ulë shpenzimet dhe të rrisë taksat. Në modelin e plotë të teorisë keinsiane që paraqitet në analizën standarde të kurbës IS-LM, multiplikatori i efekteve negative kundër balancohet pjesërisht nga efektet e crowding për efekt të niveleve më të ulëta të interesave dhe zhvlerësimeve monetare.

Shkolla neoklasike – Kjo shkollë llogaritet si baza e zhvillimit të teorive moderne mbi ekonominë dhe zhvillimin e saj. Teoritë dhe modelet e kësaj shkolle janë të ndërtuara mbi bazën e argumenteve shkencore. Edhe pse, studimi i rritjes ekonomike ishte interesim edhe i ekonomistëve klasik, pothuajse të gjitha kërkimet e zhvilluara në vitet e fundit të shekullit 19 dhe deri në gjysmën e dytë të shekullit 20 ishin zhvilluar në nivel mikroekonomik. Duke filluar nga vitet e 40-ta lindën gjenerata ekonomistësh të cilët u munduan të shpjegojnë elementet përcaktues të rritjes ekonomike. Do të thotë, gjenerata e parë e modeleve të zhvillimit ekonomik u formuluan menjëherë pas luftës së dytë botërore. Kërkimet e para të ekonomistëve të krijuara mbi bazën e teorisë neoklasike ndërtuan modelin ekzogjen të rritjes ekonomike ndërsa, kërkimet e mevonëshme ndërtuan modelin endogjen të rritjes ekonomike. Modelet e hershme janë fokusuar në rritjen masive të kapitalit për të arritur ritme të shpejta të rritjes së PPB-së.

Një zhvillim i mendimeve ekonomike të bazuar në tregun e lirë dhe të quajtur neoklasikët tradicional, kanë origjinën në teorinë e rritjes Harrod (1939, 1948) dhe Domar(1947). Ndërsa, më vonë u zhvillua modeli neoklasik i rritjes i quajtur modeli Solow-Swan (1950), (i rritjes ekzogjene) si zgjerim i formulimit të teorisë së Harrod-Domar i cili thekson rëndësinë e tre faktorëve në rritjen e prodhimit: rritja e sasisë dhe cilësisë së punës përmes rritjes së popullësisë dhe edukimit; rritja e kapitalit përmes kursimeve dhe investimeve dhe përmirsimet në teknologji (Solow, 1956).

Për dallim nga modeli Solow, teoria e re e rritjes ose teoria e rritjes endogjene nisi me kërkimet e Paul Romer (1986) dhe Robert Lukas (1988) të cilët modelin endogjen e ndërtuan në bazë të përcaktimeve të teorisë neoklasike të rritjes. Ky model u shfaq edhe si një reagim për të shpjeguar performancën e dobët të vendeve më pak të zhvilluara të cilat kanë zbatuar politikat siç janë parashikuar nga teoria neoklasike e rritjes. Përdallim nga modeli Solow që konsideron ndryshimin teknologjik si një faktor ekzogjen, modeli endogjen dhe evolucioni i mendimeve ekonomike nuk e shohin ndryshimin teknologjik si ekzogjen (Banka Botrore, 2000).

Teoricientët e rritjes endogjene si Romer (1986), Lukas(1988) e më vonë Aghion dhe Howitt (1992) kanë lidhur ndryshimin teknologjik me zhvillimin e njohurive. Teoria thekson se norma e rritjes ekonomike është rezultat i dijes në përdorimin e kapitalit në vendin e punës. Kjo teori argumenton se një normë më e lartë e rritjes siç pritet në modelin Solow është humbur nga investimet shumë të ulëta në kapitalin njerëzor, infrastrukturë dhe investimit në hulumtim e zhvillim. Teoria e re e rritjes promovon rolin e politikave publike të qeverisë në formimin e kapitalit njerëzor dhe nxitjen e investimeve të huaja private për shkakun se tregjet nuk mund të krijojnë njohuri të mjaftueshme për shkak se firmat nuk kanë shumë mundësi të investojnë në njohuri të reja për individët nga fitimet e tyre edhe për shkakun se individët pasi të kenë marr njohuri nga një firmë mund të shkojnë për të punuar në firma tjera.

2.2.2 Modeli neoklasik dhe teoritë ekzogjene dhe endogjene të rritjes

Siç edhe u shtjellua gjer me tani, teoritë dhe krijimi i modeleve të rritjes kanë shoqëruar hap pas hapi njëra tjetrën duke u mbështetur edhe me fakte nga puna empirike e shumë autorëve në vazhdimësi. Puna e shumë autorëve ka nxjerrë konkluzione se rritja në afat të gjatë është fryt i një rezultati pozitive që vjen nga oferta e stimuluar nga faktorët e prodhimit mëqenëse pjesëmarrja e kërkesës në ekujlibrin afatgjatë është parë më tepër si instrument që përdoret për të stimuluar rritjen në afat të shkurtër. Për këtë arsye orientimi i modeleve mbetet i bazuar në faktorët mikroekonomik të teorisë neoklasike në përgjithësi, duke përdorë kombinimet optimale të faktorëve në procesin e prodhimit, edhe pse ka këndvështrime të ndara sa i përket kontributit të faktorëve në këtë proces mjaft kompleks. Në këtë kontekst, modelet ekonomike kanë evoluar, duke nxjerrë në pah gjithnjë e më tepër karakteristika të faktorëve mbi akumulimin e kapitalit me qëllim të maksimizimit të mirëqenies shoqërore. Edhe pse, faktorë kryesor të prodhimit mbeten puna dhe kapitali, ndikimi i faktorëve të tjerë si arsimimi, teknologjia, vendimet politike etj. kanë rëndësi të veçantë në modelet ekonomike. Si rrjedhim, modelet e rritjes mund të ndahen në dy grupe kryesore: modelet ekzogjene dhe endogjene të rritjes.

Modeli ekzogjen i rritjes

Teoria ekzogjene e rritjes siç u shtjellua edhe më parë u zhvillua, fillimisht në vitet 1950-1960 nga Solow dhe Swan, në kontekstin e një modeli neoklasik dhe është e fokusuar mbi akumulimin e kapitalit si burim i rritjes. Sipas teorisë, nëse niveli i kursimit tejkalon shumën e normës së amortizimit dhe normën e rritjes së popullsisë, atëherë raporti kapital-punë do të rritet me kalimin e kohës dhe kështu do të gjeneroj rritje të prodhimit për frymë. Mirëpo, teoria supozon se pa ndryshime ekzogjene procesi i rritjes do të ishte i kufizuar.

Rritja mund të ndodh në qoftë se produktiviteti i një gjendje të dhënë të kapitalit rritet për shkak të progresit teknik i cili lind si rezultat i një procesi ekzogjen. Gjetja kryesore e modelit është se nëqoftëse rritja ndodh vetëm nepërmes akumulimit të kapitalit, procesi i rritjes duhet të ketë një kufi nëse nuk ka progres teknik, (Myles, 2009:7-10).

Modeli ekzogjen i rritjes Solow është e bazuar në një funksion prodhimi që përfshinë kapitalin dhe punën e matur për ore si inpute në prodhim. Produktiviteti i të dy këtyre inputeve do të bie, pra do të ketë normë rënëse marxhinale të produktivitetit, poqëse nuk do të ketë ndryshime (ekzogjene) në akumulim të kapitalit. Për të parë këtë, modeli konsideron një ekonomi me një normë konstante të rritjes së popullsisë në të cilën çdo person punon me një orar të caktuar të orëve të punës dhe kapitali amortizohet pjesërisht duke u përdorur. Kursimet janë burim i vetëm i investimit në kapital. Çdo prodhim i prodhuar Y është i ndarë në mes të konsumit C dhe investimeve I në zëvendësim të stokut të kapitalit K .

Ashtu siç është shpjeguar në formë të përmbledhur nga Myles (2007) mund të konkludohet se karakteristikat dhe rëndësia e modelit të rritjes ekzogjene qëndron në atë se: Modeli Solow e përshkruan rritjen përmes akumulimit të kapitalit; modeli parashikon konvergjencë të qëndrueshme afatgjatë; prodhimi për frymë në afat të gjatë determinohet nga norma e kursimit; rritja në prodhim arrihet vetëm përmes progresit teknologjik; Zhvillimi nga teknologjia nuk është shpjeguar nga modeli dhe çka është më e rëndësishme të dimë se: modeli Solow me një normë konstante kursimi i jep pak rol politikës tatimore që të ndikoj në normën e rritjes do të thotë se taksimi i kapitalit nuk ka efekt në rritje. Në këtë kontest Chamley (1986) dhe Jud (1985) kanë gjetur që në afat të gjatë taksimi optimal në të ardhurat nga kapitali duhet të jetë 0.

Modeli endogjen i rritjes

Modeli endogjen i rritjes u zhvillua fillimisht nga Romer në vitin 1986. Romer (1986) rinisë literaturën e rritjes ekonomike duke paraqitur një model të kthimit në rritje në bazë të së cilit ka pasur një normë positive të qëndrueshme të rritjes si rezultat i akumulimit endogjen të njohurive. Romer përfundimisht supozon se efektet e përdorimit të njohurive përcaktojnë produktivitetin. Modeli endogjen merr parasysh rritjen ekonomike afatgjatë dhe përdorë mekanizma endogjen për të shpjeguar burimin e saj kryesor, të nxitur nga akumulimi i kapitalit njerzor. Në këtë kontekst zhvillimi i teorisë së rritjes endogjene ka dhënë shumë njohuri të reja në burimet e rritjes ekonomike. Thelbi i kësaj teorie është se rritja është pasojë e vendimeve racionale ekonomike. Firmat investojnë burimet e tyre në hulumtim dhe zhvillim për të siguruar risi fitimprurëse. Konsumatorët investojnë në arsim për zhvillimin e kapitalit njerzor dhe rritjen e standardit të jetës. Qeveritë ndikojnë rritjen duke ofruar shpenzime publike për të inkurajuar investimet private dhe rritjen e shkallës së arsimimit. Përmes bashkimit të këtyre vendimeve individuale ndikohet shkalla e rritjes duke përfshirë këtu edhe ndryshimet që mund të ndikohen nga politikat tatimore të qeverive. Për të shpjeguar rritjen ekonomike të qëndrueshme dhe burimet e saj parë kjo nga perspektiva e rritjes endogjene, literatura ofron katër metoda të ndryshme të shpjeguara nga Myles (2007) të cilat do të trajtohen në vijim dhe siç tregohet ato kanë dhënë të njëjtin përfundim. Pastaj, duke u nisur nga këndvështrimi i këtyre modeleve vëmendja është përqendruar në rolin e politikës së taksave në rritjen ekonomike.

Modeli AK

Ky model merr parasysh vetëm kapitalin si faktor kryesor në procesin e prodhimit, dhe për këtë arsye edhe njihet si modeli A-K. Duke supozuar të ardhura marzhinale konstante të kapitalit, funksioni i prodhimit është në këtë formë:

$$Y_t = AK_t, \dots\dots\dots (1)$$

Supozimi i të ardhurave konstante nga kapitali nënkupton që rritja e produktit është e njëjtë me rritjen e stokut të kapitalit. Për të qenë e qartë se ky model gjeneron rritje të qëndrueshme supozojmë një normë konstante kursimi. Me një normë kursimi s , niveli i investimeve në një periudhë t , do të jetë:

$$I_t = sAK_t, \dots\dots\dots 2)$$

Mëqenëse, nuk është i pranishëm faktori punë, kushti për akumulimin e kapitalit është:

$$K_{t+1} = sAK_t + (1 - \delta)K_t = (1 + sA - \delta)K_t, \dots\dots\dots (3)$$

Duke parë që $sA > \delta$, pra investimet do t'a tejkalojnë normën e amortizimit, niveli i kapitalit do të rritet në mënyrë lineare me $sA - \delta$. Produkti do të rritet në të njëjtën masë, po kështu edhe konsumi. Pra, ky model siguron rritje të qëndrueshme. Ky model është zgjeruar duke përfshirë variabla të ndryshëm të cilët kanë efekt mbi rritjen ekonomike të cilat janë shpjeguar nga autor të shumtë: Weale (1992), Feldstein (1995a) Heckman et al. (1998), Blankenau dhe Simpson (2004), Myles (2007), Barro (1990), King dhe Rebelo (1990), Barro dhe Sala-i-Martin (1992, 1997, 2002), Devarajan et al. (1996), Baier dhe Glomm (2001), Zagler-Durnecker, (2003) Gomez, (2007), Aghion dhe Howitt (1988, 1992), Jones and Williams (1998).

Kapitali njerëzor

Qasja e dytë për të siguruar rritje të qëndrueshme qëndron në atë se krahas rritjes së kapitalit duhet të rriten edhe inputet tjera. Ky model kërkon marrjen në konsideratë edhe të kapitalit njerëzor. Pra, kërkohen investime si në kapitalin fizik edhe në atë njerëzor. Kapitali njerëzor në funksion të prodhimit kontribon në dy mënyra, në cilësi të produktit dhe në kohë. Për të arritur këtë duhet rritur investimet në arsim dhe trajnim të kapitalit njerëzor. Forma standarde e funksionit të prodhimit në këtë model është:

$$Y_t = F(K_t, H_t), \dots \dots \dots (4)$$

Ku H_t është niveli i kapitalit njerëzor. Nëse funksioni i prodhimit ka kthim konstant në nivel të kapitalit fizik dhe njerëzor së bashku, pastaj investimet në ta mund të rrisin prodhimin pa limit edhe nëse sasia e kohës është fikse.

$$K_u A \equiv F(H/K) \dots \dots \dots (5)$$

Akumulimi i kapitalit njerëzor mund të shihet si rezultat i një procesi arsimor. Këtu vëhet në dukje se si sistemi i taksave ndikon në vendimin e bizneseve për të ndërmarr investime në arsim gjithashtu ndikon edhe në oferten e punës.

Shpenzimet e qeverisë

Rritja endogjene mund të ndodh kur kapitalit dhe punës i shtohen variabla shtesë në funksion të prodhimit. Për të kuptuar lidhjen në mes të politikave qeveritare dhe rritjes atëherë variabli shtesë që janë shpenzimet publike duhet financuar mirë nga tatimet. Modeli i përshkruar më poshtë jep detaje të kësaj lidhje përmes së cilës shpenzimet publike mund të ndikojnë rritjen.

$$Y_t = A L_t^{1-a} K_t^a G_t^{1-a}, \dots \dots \dots (6)$$

Ku A është një konstante që llogaritet pozitive ndërsa G_t është variabli shtesë pra, sasia e kontributit publik. Struktura e këtij funksioni prodhimi tregon se ka kthime konstante të nivelit të punës dhe kapitalit në një biznes për një nivel të caktuar të kontributit publik.

Inovacioni

Meqenëse, futja e produkteve të reja në treg nga një biznes kërkon edhe teknologji të re në procesin e prodhimit apo edhe duke i zëvendësuar ato ekzistuese me teknologji të re, është parë më rëndësi edhe studimi i këtyre dukurive për të parë lidhjen se si ndikojnë ato rritjen e produktivitetit. Një hulumtim i tillë është zhvilluar nga Aghion dhe Howitt (1998). Modeli i zhvilluar për këtë qëllim duke supozuar se prodhimi varet nga përdorimi i punës dhe një varg të inputeve tjera ku progresi teknologjik mund të futet në funksion të prodhimit. Një model bazë për të parë futjen e risive në funksion të prodhimit në kohën t merr formën si në vazhdim:

$$Y_{it} = A_{it} X_{it}^{\alpha} \dots \dots \dots (7)$$

Ku X_{it} është sasia e të mirës së ashtuquajtur të ndërmjetme e prodhuar me futjen e risive në procesin e prodhimit dhe A_{it} është niveli i asaj risie (teknologjisë).

Të katër modelet e paraqitura më lartë krijojnë një strukturë të përshtatshme për të studiuar efektet e politikës fiskale mbi rritjen ekonomike në periudhën afatgjatë. Ato tregojnë se rritja e shkallës së arsimimit, përmirëson produktivitetin e kapitalit human; rritja e investimeve në kërkim – zhvillim, përmirëson teknologjinë dhe rritë prodhimin; Shpenzimet qeveritare në infrastrukturë, ndihmojnë ecurinë e bizneseve private. Të gjitha këto burime të rritjes mund të ndikohen nga politikat ekonomike që hartojnë dhe implementojnë qeveritë e vendeve të ndryshme. Kështu që, shpenzimet qeveritare mund të inkurajojnë, ose dekurajojnë investimet. Gjithashtu, politika tatimore është një tjetër

mënyrë me të cilat qeveria ndikon në rritjen ekonomike. Thelbi i kësaj teorie të re është se rritja ekonomike është pasojë e vendimeve ekonomike racionale. Firmat rritin shpenzimet e tyre në kërkim – zhvillim për të siguruar inovacione në teknologji të cilat synohen të jenë fitimprurëse. Individët investojnë në arsim për të zhvilluar aftësitë e tyre si kapital human dhe për të rritur të ardhurat e tyre gjatë jetës. Qeveria ndikon në rritjen ekonomike duke siguruar shërbime publike, duke inkurajuar investimet e huaja direkte. Duke parë rolin që luajnë variabla të shumta ekonomike, norma e rritjes bëhet një variabël i varur dhe i ndikuar nga politikat fiskale të qeverisë, (Myles 2009).

Meqenëse, siç u tregua me lartë se me modelet ekzogjene nuk ka mundësi të ndikohet rritja ekonomike nga politika e taksave, sepse supozohet se rritja ekonomike afatgjate varet nga norma e rritjes së popullsisë dhe nga norma e progresit teknologjik, i cili është një variabël ekzogjen në këtë model. Në këtë kontekst, nga pikpamja teorike modelet endogjene konsiderohen me më shumë përparësi.

2.2.3 Politika fiskale dhe zhvillimi ekonomik

Modelet neoklasike theksojnë mekanizma të tjerë të transmisionit, nëpërmjet të cilëve reduktimet në deficitin e buxhetit të qeverisë ndikojnë ekonominë, efektet pozitive të të cilave mund të tejkalojnë efektet negative të multiplikatorit Kejnsian në kërkesen agregate. Një deficit me i ulët buxhetor do të reduktonte ndjeshëm normat e interesave, për shkak të rënies së riskut të përceptuar që qeveria mund të zhvlerësonte borxhin publik nëpërmjet një niveli më të lartë inflacioni, duke dërguar kështu në efekte pozitive të të ardhurave mbi kërkesen agregate. Reduktimi i deficitit do të ndikonte, gjithashtu në uljen e çmimit të riskut të normave të interesave. Kjo përsëri do të rriste vlerën e tregut të pasurisë së sektorit privat dhe për rrjedhojë do të rriste edhe kërkesën agregate. Nga ana tjetër, reduktimi i

deficitit të qeverisë do t'i shërbente sektorit privat dhe konsumatorëve si një sinjal për reduktim në të ardhmën, të barrës së taksave dhe rritjen e të ardhurave të tyre, e cila mund të inkurojoj përsëri rritjen e shpenzimeve dhe të aktivitetit të tyre ekonomik, (Bernheim D., 1989).

Në dy dekadat e fundit, studime të shumta, nga autorë të shumtë janë bërë për të shpjeguar ndikimin e taksimit në rritjen ekonomike. Myles, G. (2009: 5), në një artikull të tij mbi rolin e taksimit në rritjen ekonomike ka theksuar se norma e rritjes mund të ndikohet nga zgjedhjet politike përmes efektit që kanë tatimet mbi vendimet ekonomike dhe ka theksuar efektet pozitive dhe negative të tatimit mbi rritjen. Efektet pozitive të tatimit qëndrojnë në atë se një rritje e tatimit siguron mjetet për financimin e shpenzimeve të ndryshme publike, të tilla si shpenzimet në infrastrukturë, arsim, shëndetësi të cilat mund ta rrisin produktivitetin në përgjithësi dhe në mënyrë indirekte mund të ndikojnë në normën e rritjes ekonomike. Efektet negative të tatimit, Myles, poashtu i ka shpjeguar me rritjen e normës së tatimit, me ç'rast një rritje në tatim redukton investimet në kapital si dhe ato në hulumtim dhe zhvillim. Investime më të ulëta do të thotë më pak akumulim dhe inovacion e kështu edhe normë më të ulët të rritjes. Si pasojë e kësaj shtetet nuk duhet të jenë të njëjta në përgjigje të politikës së taksave, psh. shtetet me infrastrukturë mirë të zhvilluar nuk mund të veprojnë njëjtë sikurse vendet me infrastrukturë të dobët. Përderisa, disa vende kanë nevojë për akumulim në kapitalin njerzor, disa tjera kanë nevojë për investime në kërkim dhe zhvillim.

2.2.4 Investimet dhe zhvillimi ekonomik

Dy prej modeleve që shpjegojnë këtë lidhje janë: Modeli Rostow i cili thekson se shkalla e rritjes së investimeve konsiderohet të jetë i nevojshëm për të nxitur shkallën e rritjes për

frymë. Për të arritur këtë vendet e pazhvilluara pritjet të kalojnë nëpër 5 faza për të arritur shkallën e një vendi të zhvilluar. Një model të ngjashëm kanë dhënë edhe Harrod- Domar të cilët theksuan se forca levizëse për çdo ekonomi janë investimet, (Ghatak, 2003).

Blanchard dhe Perotti, (2002:1329-1368), në një studim të tyre mbi efektet e stimujve fiskal përmes shpenzimeve qeveritare dhe të ardhurave tatimore në SHBA, në periudhën e pasluftës, kanë arritur në përfundim se një rritje e njëkohshme në shpenzimet qeveritare dhe në taksa ka një efekt të fortë negative në investime.

2.3 Shfrytëzimi i modelit ekonomik në funksion të rezultateve të hulumtimit

Problemet e rritjes ekonomike, të cilat janë komplekse dhe shumdimensionale, kanë rezultuar në zhvillimin e një numri teorish, shpjegimesh, argumentesh dhe pohimesh të cilat përshkruajnë mjetet dhe strategjitë për t'i bërë të arritëshme objektivat e zhvillimit (Banka Botrore, 2000). Prandaj, teoritë dhe modelet mbi rritjen ekonomike janë të shumta. Por, vetëm një pjesë e tyre është përfshirë në kuadrin teorik të këtij punimi. Megjithatë, në funksion të pyetjeve dhe hipotezave kërkimore të këtij studimi vetëm një pjesë e kuadrit teorik do të shfrytëzohet në mënyrë me të detajuar me qëllim të realizimit të studimit empirik, mbledhjes të të dhënave, përpunimit dhe interpretimit të rezultateve në këtë punim. Siç është e njohur nga modeli neoklasik i rritjes, se vendimi për të kursyer apo për të investuar në kapital ndikohet nga politikat fiskale të cilat ndikojnë në këto vendime e më këtë edhe në rritjen e nivelit të prodhimit dhe normës së rritjes ekonomike.

Për të parë këtë dhe në funksion të studimit tonë do të shërbej modeli endogjen i rritjes i zhvilluar paraprakisht nga Barro (1990), Barro dhe Sala i Martin (1992, 1995), Mendoza, Milesi- Ferreti dhe Asea (1997) dhe më vonë nga Bleaney, Gemmell dhe Kneller (2001).

Shpjegimi i këtij modeli fillon duke marr si funksion të prodhimit një numër n prodhuesish të cilët prodhojnë produktet e tyre (y) siç paraqitet në formën në vazhdim:

$$Y = Ak^{1-\alpha} g^{\alpha} \dots \dots \dots (8)$$

Ku k paraqet kapitalin privat ndërsa g është një e mirë e dhënë publike. Duke e marr që qeveritë balancojnë buxhetet e tyre duke rritur një taksë proporcionale në prodhim në normë τ dhe taksën e sheshtë në L atëherë buxheti i kufizuar i qeverisë është:

$$ng + C = L + \tau ny \dots \dots \dots (9)$$

Ku C janë shpenzimet joproductive të qeverisë. Duke qenë se taksa e sheshtë (jo deformuese) nuk ndikon në nxitjen e sektorit privat, ndërsa taksat në prodhim e ndikojnë atë, atëherë funksioni i dobisë sipas Barro dhe Sala I Martin (1992) tregon se norma e rritjes afatgjatë në këtë model mund të shprehet si:

$$\phi = \lambda(1-\tau)(1-\alpha)A^{1/\alpha} (g/y)^{\alpha/(1-\alpha)} - \mu \dots \dots \dots (10)$$

ku λ dhe μ janë konstante që pasqyrojnë parametrat në funksion të dobive (shërbimeve). Ekuacioni (10) tregon se norma e rritjes rritet më rëndë e normës së taksave deformuese (direkte) dhe rritjen e shpenzimeve produktive por nuk ndikohet nga taksat indirekte (L) dhe nga shpenzimet joproductive (C).

Modeli i mësipërm është modeli që ne këkojmë për t'a testuar pra, ndikimin e politikës fiskale në rritje mirëpo, në praktikë buxheti i qeverisë nuk është i balancuar në çdo periudhë kështu që nisur nga ky kufizim ekuacioni në vazhdim merr formën:

$$ng + C + b = L + \tau ny, \dots \dots \dots (11).$$

Ku b përfaqëson suficitin apo deficitin buxhetor.

Ndërsa, për të implikuar këtë në testimin empirik supozohet që rritja ϕ në kohën t është në funksion të variablave jofiskale, (Y_{it}) dhe atyre fiskale, (X_{jt}) të paraqitura në ekuacionin tonë (10):

$$\phi = \alpha + \sum_{i=1}^k \beta_i Y_{it} + \sum_{j=1}^m \gamma_j X_{jt} + \mu_t \dots \dots \dots (12).$$

2.3.1 Rezultate të kërkimeve empirike mbi ndikimin e taksimit në rritjen ekonomike

Në shekullin e njëzet, pjesëmarrja e taksave si % e GDP-së, në vendet e zhvilluara u rritë në mënyrë të qëndrueshme. Një rritje e tillë ngre një pyetje të rëndësishme në lidhje me efektin që kanë tatimet në rritjen ekonomike. Në këtë mënyrë, ndërtimi i modeleve ekonomike ka çuar në shumë njohuri të rëndësishme për proceset e rritjes ekonomike, përfshirë ndikimin e taksimit në rritjen ekonomike.

Kontributi i madh i teorive të shumta të rritjes ekonomike dhe faktorëve që ndikojnë rritjen në dekadat e fundit ka ngjallur shumë debate dhe interesim të madh të ekonomistëve për të identifikuar dhe shpjeguar lidhjet në mes të politikës fiskale dhe rritjes ekonomike. Konkluzionet që dalin nga teoria pothuajse janë të pranuar nga të gjithë, mirëpo, rezultatet empirike që dalin japin përfundime të ndryshme. Kjo variancë e gjerë e përfundimeve fillon që, nga të dhënat në dispozicion, variabla të cilat mungojnë në disa vende kryesishtë në zhvillim, mënyra e mbledhjes së tyre e deri tek përdorimi i teknikave ekonometrike. Në vijim do të paraqiten një numër i studimeve empirike mbi efektin e tatimeve në rritjen ekonomike.

Në studimin e tij, Ploser (1992) , ka gjetur një lidhje të fortë empirike në mes të tatimit dhe rritjes ekonomike. Ai kishte kalkuluar korrelacionin në mes të normës së rritjes së PBB-së për frymë dhe normës mesatare të tatimit mbi të ardhurat nga fitimet në 24 vende të OECD-se, dhe kishte gjetur se të ardhurat nga fitimi kishin korrelacion negativ prej -0.52 në normen e rritjes së PBB-së për frymë. Bazuar në modelin e rritjes endogjene një taksë e tillë dekurajonë investimet si në kapitalin fizik ashtu edhe njerëzor dhe në këtë mënyrë do të ulë normën e rritjes ekonomike. Poashtu, në këtë studim Ploser kishte gjetur një lidhje negative në mes të shpenzimeve të qeverisë dhe rritjes si dhe poashtu, korrelacion negativ në mes të nivelit fillestar të të ardhurave dhe rritjes për frymë.

Në një hulumtim të tij Barro (1990), duke supozuar se shërbimet qeveritare financohen nga tatimi mbi të ardhurat që tatohen me normën e sheshtë, ka rezultuar në atë që rritja e normës së tatimit mbi të ardhurat të cilat janë të nevojshme për rritje të kapitalit ndikon në ulje të normës së rritjes në afatë të gjatë. Këtë gjetje Barro e ka mbështetur në faktin se qeveria jep shërbime direkte të lidhura me konsumin e familjeve dhe furnizon me mallra kapitale publike gjykatat, spitalet, policinë si dhe nga infrastruktura shërbimet e së cilës shërbejnë si një input për prodhimet private. Të dy llojet e shërbimeve qeveritare ndikojnë rritjen afatgjatë në mënyra të ndryshme. Shërbimet e konsumit të qeverisë nuk kanë ndikim produktiv në ekonomi, por ato financohen nga tatimi në të ardhurat që nëse ky tatim rritet, ulët kthimi në akumulim të kapitalit, dhe si pasojë rritja e shërbimeve të konsumit të qeverisë ulë normën e rritjes së ekonomisë. Ndërsa, një rritje në kapital publik kthehet në akumulim të kapitalit privat dhe në këtë mënyrë ngritë normën e rritjes ekonomike.

Barro dhe Redlick (2011), në gjetjet empirike të tyre mbi ndikimin e normave tatimore në PBB-në për frymë në SHBA, ku të dhënat seri të marra në analizë i takojnë periudhës 1950-2006, erdhën në përfundim që shkurtimi i normave mesatare tatimore marginale për 1 (një) pikë përqindje bënë rritjen e PBB-së për frymë rreth 0.5 % në vitin e ardhshëm.

Në një analizë mbi efektin e ndryshimeve cilësore dhe sasiore të strukturës së taksave në normën e rritjes së investimeve dhe rritjes ekonomike si dhe efektin e normave tatimore në investime dhe rritjen ekonomike të zhvilluar nga Mendoza, Milesi- Ferretti dhe Asea (1997, fq.123) në të cilën janë përfshirë 18 vende të OECD-së. Gjetjet e tyre tregojnë se rritja në normën e taksave të punës dhe kapitalit ndikon negativisht investimet por, ndikimi i tyre në rritjen ekonomike është i parëndësishëm. Ndërsa, rritja e normës së tatimit në konsum rritë investimet por jo edhe rritjen ekonomike. Simulimet numerike në rezultatet të tyre treguan se shkurtimet e taksave për 10 % rrisin normën e investimeve rreth 0.5 deri në 1.5 pikë përqindje (%), por ndikimi i shkurtimit të këtyre taksave në rritjen ekonomike është shumë i vogël nga 0.1 deri në 0.2 %.

Në një studim të tyre Holcombe dhe Lacombe, (2004:392-312), mbi ndikimin e ndryshimeve në normat tatimore marxhinale të të ardhurave shtetërore në rritjen e të ardhurave për frymë duke krahasuar rritjen e të ardhurave në mes shteteve të ndryshme gjatë një periudhës 1960-1990. Rezultatet tregojnë se shtetet që kanë rritur normat tatimore më shumë se fqinjet e tyre gjatë periudhës 30 vjeqare kishin rritje më të ngadalëshme të të ardhurave dhe kishin një reduktim në rritjen e të ardhurave për frymë mesatarisht 3.4 %.

Padovano dhe Galli (2001), në një studim të tyre mbi ndikimin e normave efektive marginale të të ardhurave tatimore në rritjen ekonomike në 23 vende të OECD-së, për

periudhën 1950-1990, rezultatet e tyre tregojnë që normat efektive marxhinale të taksave janë të lidhura negativisht me normën e rritjes ekonomike. Rezultatet e tyre janë në përputhje me teorinë endogjene të rritjes. Një rezultat të kundërt kishin dhënë gjetjet nga Leibfritz, Thornton and Bibbee (1997). Analiza e regresionit nga shuma e normës së rritjes për vendet e OECD-së në periudhën 1980-1995 tregon se ndërmarrja e masave në rritjen e normës së taksave redukton normën e rritjes ekonomike. Ata vijnë në përfundim se një rritje e normës së taksave për 10% redukton normën e rritjes për 0.5%, dhe se tatimet direkte reduktojnë rritjen me tepër sesa taksat indirekte.

Ndërsa, Dowrick (1993) dhe De la Fuente (1997) kanë treguar se si struktura e politikës fiskale ndikon rritjen ekonomike, veqanarisht ata hulumtuan se sa është e lidhur norma e rritjes ekonomike me përbërjen dhe nivelin e shpenzimeve. Rezultatet e dala nga Fuente tregojnë që nëse shpenzimet publike (si pjesë e shpenzimeve totale të PBB-së) rriten atëherë, norma e rritjes ekonomike reduktohet dhe shpjegon se një rritje prej shpenzimeve qeveritare prej 5% e PBB-së redukton normën e rritjes për 0.66%. Përderisa Dowrick studioj të ardhurat tatimore të disa vendeve të OECD-së dhe tregoi që tatimi në të ardhura personale ka ndikim negativ në rritje ekonomike ndërsa, tatimi në të ardhura të korporatave nuk ka ndonjë efekt në rritjen ekonomike. Engen dhe Skinner (1996) në një studim të tyre mbi ndikimin e tatimeve (normave marxhinale dhe mesatare tatimore) në rritjen ekonomike në SHBA, për periudhën 1959-1995, rezultatet e tyre empirike tregojnë që rezultatet e një reformë të madhe, shkurtim në normat marginale të taksave për 5% dhe një shkurtim në normat mesatare të taksave prej 2.5% do të rrisë normën e rritjes ekonomike në periudhë afatgjate në mes të 0.2 dhe 0.3 %.

Gwartney, Halcombe dhe Lawson në studimin e tyre gjetën që sa me e madhe madhësia e shtetit dhe sa me i lartë niveli i normës mesatare të taksave rezultojnë në një performancë të ulët ekonomike. Si një rregull i përgjithshëm , të ardhurat rriten me të njëjtin ritëm me atë të rritjes ekonomike.

Koester dhe Kormendi (1989) kanë gjetur që normat marzhinale rritëse të taksave sjellin efekte negative mbi aktivitetet ekonomike mirëpo, nuk kanë gjetur ndonjë lidhje të rëndësishme statistikore në mes të tatimeve dhe rritjes ekonomike. Ata kanë theksuar se progresiviteti redukton rritjen. Një model të ngjashëm kanë përdorë edhe, Mullen dhe Williams (1996) për SHBA dhe konkluduan se normat e ulëta marzhinale të taksave kanë një ndikim të konsiderueshëm pozitiv mbi rritjen ekonomike.

Në studimet empirike të zhvilluara në vende të pasura për periudhën 1970- 1995 nga Folster dhe Henrekson, (2001:1501-1519), mbi ndikimin e shpenzimeve qeveritare dhe të taksimit në rritjen ekonomike tregohet që ekziston një marrëdhënie e fuqishme negative ndërmjet shpenzimeve qeveritare dhe rritjes ekonomike në këto vende. Siç tregojnë ata një rritje e raportit të shpenzimeve publike për 10% është e lidhur me një rënie prej 0.7 deri 0.8 % në normën e rritjes ekonomike. Një lidhje negative është gjetur edhe në mes tatimeve dhe rritjes ekonomike.

Gordon dhe Lee (2005) në studimet e tyre në 70 vende të ndryshme duke përdorë të dhëna panel për periudhën 1980-1997 kanë gjetur se norma e lartë e tatimit në të ardhurat e korporatave është e lidhur fuqishëm me rritje të ulët ekonomike ndërsa, llojet e tjera të tatimeve kanë efekt të parëndësishëm në rritjen ekonomike. Në analizën e tyre ndërsektoriale të regresionit ata gjejnë se një ulje e normës ligjore të TAK-së për 10 %

rritë normën vjetore të PBB-së per frymë prej 0.7 deri 1.1 %. Një efekt të tillë të normës së lartë të TAP në rritjen ekonomike e kanë gjetur edhe Katz, Mahler dhe Franz, (1983).

Në një artikull mbi ndikimin e progresivitetit tatimor në rritjen ekonomike të kryer nga Chernick, (1997:249-267) në SHBA për periudhën 1977- 1993, autori ka gjetur se shkalla e progresivitetit nuk ka efekt mbi normën e rritjes së të ardhurave për frymë por, progresiviteti ka një efekt të rëndësishëm në rritjen e të ardhurave të qeverisë

Duke përdorur të dhëna që përfshijnë 17 vende të OECD-së, për periudhën 1970- 2004, Gemmell et.al (2011: 33-58), kanë gjetur se tatimet mbi të ardhurat dhe fitimin dëmtojnë më se shumti rritjen ekonomike e ndjekur pastaj nga deficitet dhe tatimet mbi konsumin.

Një studim tjetër i kryer nga Arnold et.al, (2011) në 21 vende të OECD-së për periudhën 1971 deri 2004 me qëllim të përcaktimit të barrës tatimore si pjesë e PBB-së për secilin nga këto vende, kanë gjetur efektet e llojeve të ndryshme të taksave në rritjen ekonomike. Ata gjetën se një ulje e normës tatimore prej 1% në të gjitha llojet e të ardhurave së bashku tatimit në korporata , tatimit në të ardhura personale, tatimit në konsum rritë normën e PBB-së për frymë nga 0.25 deri në 1%, në afatë të gjatë. Ata gjithashtu, gjetën se: Ngritja e nivelit të normës së tatimit mbi të ardhurat personale redukton rritjen e produktiviteti e me këtë edhe rritjen ekonomike, gjithashtu ata gjetën se tatimet e larta në korporata si në aspektin e normës ligjore tatimore ashtu edhe në aspektin e lejimeve dhe zhvlerësimit reduktojnë investimet dhe rritjen e produktivitetit.

Në një studim të tyre, mbi efektet e politikave fiskale në provincat kanadeze duke përdorur të dhëna për periudhën 1977 – 2006, Ferede dhe Dahlby (2012) kanë gjetur se normat e ulëta të TAK janë të lidhura me investime më të mëdha private dhe me rritje më të shpejtë ekonomike. Analiza e tyre empirike tregon se një shkurtim i normës tatimore të TAK për 1

% është i lidhur me një rritje të përkohëshme prej 0.1 deri 0.2 % të normës së rritjes së PBB-së për frymë. Gjithashtu, ata kanë gjetur një efekt pozitiv të ndikimit të normës së TVSH-së në rritje, ata konkludojnë se një normë më e lartë në tatim të shitjes sjellë investime me të mëdha private e më këtë edhe normë të rritjes ekonomike më të lartë. Ndërsa, nuk kanë gjetur ndonjë lidhje të rëndësishme në mes të normave tatimore marxhinale në rritjen ekonomike.

Ndikimin e barrës tatimore të përgjithëshme federale në SHBA përfshirë të gjitha llojet tatimore së bashku, si përqindje e PBB-së, duke përdorë të dhëna që nga lufta e dytë botërore David dhe Christina Romer gjetën se një rritje e taksave prej 1 % ulë –PBB-në reale me rreth 3% pas dy viteve.

Një studim tjetër i kryer nga FMN, (2010) në lidhje me konsolidimin fiskal, i kryer në 15 vende të zhvilluara gjatë 30 viteve të fundit ka konstatuar se shkurtimet e shpenzimeve buxhetore ndikojnë shumë më pak në rritjen afatshkurtër se sa shkurtimi i taksave. Rezultatet e studimit tregojnë se një shkurtim i shpenzimeve prej 1 % nuk tregon efekt të rëndësishëm në rritjen, ndërsa një rritje e taksave prej 1 % ul PBB-në me 1.3% pas dy vitesh.

Në një tjetër studim të ngjashëm, i kryer me qëllim të vlerësimit të stimujve fiskal për të ulur deficitet buxhetore, Alesina dhe Ardagna, (2010) kanë analizuar ndikimin e politikës fiskale në rritjen ekonomike në vendet e OECD-së në mes të viteve 1970 dhe 2006 dhe kanë gjetur se stimujt fiskal të bazuara mbi shkurtimin e taksave kanë më shumë gjasa për të rritur rritjen ekonomike se sa stimujt fiskal të bazuar në shkurtim të shpenzimeve. Ndërsa, në studimin e tyre Gemmell M., et. Al., (2001), të zhvilluar në vendet e OECD-së për

periudhën 1970-1995 kanë ardhur në konkludim se tatimet direkte ulin rritjen ekonomike ndërsa, tatimet e konsumit nuk sjellin ndryshime.

Duke përdorë të dhëna panel për të identifikuar ndikimin e tatimeve në rritjen ekonomike në 48 vende të SHBA-ve për periudhën 1970-1999, Red (2008), ka gjetur një efekt të fuqishëm të ndikimit të barrës tatimore në rritjen ekonomike, mesatarisht në periudha 5 vjeqare. Ndërsa, Mertens & Ravn, (2012), në analizën e tyre mbi ndikimin e tatimit në të ardhura personale dhe në të ardhura në korporata në rritjen ekonomike, në SHBA pas luftës së dytë botërore, gjetën se një ulje prej 1 % në normën mesatare të tatimit mbi të ardhurat personale rritë normën e PBB-së për frymë prej 1.4 % në tremujorin e parë dhe deri në 1.8 % rritje të PBB-së për frymë pas tre tremujorëve. Ndërsa, një ulje prej 1 % në normën mesatare të tatimit mbi të ardhurat (fitimit) nga korporatat rritë normën e PBB-së për frymë prej 0.4 % në tremujorin e parë dhe deri në 0.6 % rritje të PBB-së për frymë pas një viti.

Rezultatet empirike të Levin dhe Wright, (2004) në lidhje me prodhuesit e automobilave kanë treguar se normat e larta tatimore i detyrojnë prodhuesit të ulin çmimet e produkteve të tyre para taksave si kundër përgjigje ndaj normave të larta tatimore, sepse ulja e çmimeve është fitimprurëse për ta për faktin se absorbon një pjesë të tatimit. Në këto raste pra, normat e larta tatimore janë të dëmshme për qeveritë për arsye se shkaktojnë humbje nga taksat, mirëpo jo gjithmonë mund të ndodh kështu. Arsyeja është se normat e larta tatimore mund ose të ngritin ose të ulin çmimet para tatimit në varësi të kërkesës dhe kostos së produktit.

Tabela 1: Përmbledhje e rezultateve nga kërkimet empirike mbi ndikimin e tatimeve në rritjen ekonomike

Autori/Viti	Objekti I studimit	Metodologjia/ Të dhënat	Efektet	Përmbledhje e gjetjeve
Koester, R. & R. Kormendi, (1989). Ploser (1992)	Ndikimi I tatimeve në aktivitetin ekonomik, në 63 vende të ndryshme. Roli i taksave dhe shpenzimeve të qeverisë në 24 vende të OECD-së	Të dhëna Cros Section / Të dhëna panel:	Negativ Negativ	Rritja e normave tatimore marginale ka efekte negative në nivelin e aktivitetit ekonomik. Të ardhurat nga tatim fitimi kishin korrelacion negativ prej -0.52 në normen e rritjes së PBB-së për frymë; dekurajojnë investimet në kapitalin fizik dhe njerëzor dhe në këtë mënyrë do të ulë normën e rritjes ekonomike si dhe kishte gjetur lidhje negative mes shpenzimeve të qeverisë dhe rritjes
Dowrick, S. (1993)	Efektet e konsumit të qeverisë në investime dhe rritje ekonomike në vendet e OECD-së	Të dhëna panel:	TAP-negative ; TAK-Pa ndikim	Tatimi në të ardhura personale ka ndikim negativ në rritje ekonomike ndërsa, tatimi në të ardhura të korporatave nuk ka ndonjë efekt në rritjen ekonomike.
William Easterly & Sergio Rebelo, (1993).	Roli i politikës fiskale në rritjen ekonomike në vende të zhvilluar dhe në zhvillim për periudhën 1970-1988.	Cross section Regressions 1970-1988	Lidhje e fortë mes variabla ve	Vendet e varfra mbështeten në taksat e tregtisë ndërsa, vendet e pasura nga tatimi mbi të ardhurat.
Engen, E. & Skinner, (1996).	Ndikimi i tatimeve në rritjen ekonomike, në SHBA për periudhën 1959-1995	Të dhëna seri: 1959-1995, SHBA	Negativ	Shkurtimi i normave tatimore marginale prej 5% dhe atyre mesatare prej 2.5 % rritë normen e rritjes ekonomike në afat të gjatë 0.2-0.3 %
Mendoza, Milesi-Ferretti, Asea, (1997).	Roli i politikës tatimore në rritjen afatgjatë në vende të OECD-së për periudhën 1966-1970.	Të dhëna panel: 1966-1970, 18 vende të OECD-së	Negativ & Jo i rëndësishëm	Rritja e taksave të punës dhe kapitalit ndikon negativisht investimet por pa efekt të rëndësishëm në rritjen ekonomike ndërsa rritja e taksave të konsumit rritë investimet por jo rritjen ekonomike: Shkurtimi i taksave 10% rritë investimet 0.5-1.5 %.
Leibfritz, W., J. Thornton and A. Bibbe (1997). Chernik H., (1997).	Roli I taksave në performancën ekonomike, në vende të OECD-së për periudhën 1980-1995. Roli I tatimeve progressive në performancën e qeverisë në SHBA në periudhën 1977-1993	Të dhëna panel: 1980-1995. Të dhëna panel: 1977-1993	Negativ Negativ	Rritja e taksave për 10% redukton normën e rritjes për 0.5%, dhe se tatimet direkte reduktojnë rritjen me tepër sesa taksat indirekte. Të ardhurat nga tatimet progresive kanë ndikim negativ në rritjen ekonomike

Padovano, F. & Galli, E., (2001).	Efektet e normave tatimore në rritjen ekonomike në vendet e OECD për periudhën 1950-1990.	Të dhëna panel: 1950-1990,	Negativ	Normat efektive marxhinale të taksave janë të lidhura negativisht me normën e rritjes ekonomike.
Folster, S. & Henrekson, M., (2001). “	Efektet e rritjes nga shpenzimet e qeverisë dhe tatimet në vendet e pasura për periudhën 1970-1995.	OLS / Të dhëna panel: 1970-1995,	Negativ	Në vendet e pasura por jo- të OECD tatimet dhe shpenzimet qeveritare janë të lidhura negativisht me rritjen ekonomike
Bleany M., Gemmell N., Kneller R., (2001)	Roli i tatimeve dhe shpenzimeve publike në rritjen ekonomike afatgjatë në vendet e OECD në periudhën 1970-1995	Të dhëna panel: 1970-1995,	Negativ	Tatimet direkte ulin rritjen ekonomike ndërsa, tatimet e shitjes (konsumit)nuk sjellin ndryshime.
Holcomb, R., Lacombe, D., (2004).	Efektet e tatimit mbi të ardhurat shtetërore në rritjen e të ardhurave për frymë në vende të ndryshme në periudhën 1960-1990.	Të dhëna panel: 1960-1990,	Negativ	Shtetet që kanë rritur normat tatimore më shumë se fqinjet e tyre për 30 vite kishin reduktim në rritjen e të ardhurave për frymë mesatarisht 3.4 %.
Lee, Y., & Gordon, R., (2005).	Struktura e taksave dhe rritja ekonomike në 70 vende të ndryshme për periudhën 1980-1997	Analiza ndërsektoriale e regresionit/Të dhëna panel: 1980-1997,	Negativ	Ulja e normës ligjore e tatim fitimit në 10% rritë normën vjetore të rritjes ekonomike me 0.7-1.1 %.
Tosun M.S. & Abizadeh S., (2005)	Roli i taksave të ndryshme në rritjen ekonomike në vendet e OECD-së në periudhën 1980-1999.	Regresioni I efekteve fikse(FE)/ të dhëna panel:1980-1999.	Të perzier	Tatimi në të ardhura personale dhe ai në pronë kanë efekt pozitiv statistikisht të rëndësishëm në rritjen ekonomike ndërsa tatimi në paga dhe ai në mallra e shërbime ka efekt statistikisht të rëndësishëm negativ në rritjen ekonomike për frymë.
Reed R.W., (2008).	Marrëdhënia në mes të Taksave dhe rritjes të të ardhurave në 48 vende të SHBA-ve në periudhën: 1970-1999	OLS, FGLS, DPD/ Të dhëna cross section 1970-1999.	Negativ	Barra tatimore ka efekt të fuqishëm negativ në rritjen ekonomike, e matura në periudha 5 vjeqare në SHBA.
Alesina A., Ardagna S., (2010)	Ndryshimi i politikave fiskale dhe efektet e saj në zhvillimin ekonomik në vendet e OECD-së për periudhën 1970-2006.	Të dhëna panel: 1970-2006.	Negativ	Stimujt fiskal të bazuara mbi shkurtimin e taksave kanë më shumë gjasa për të rritur rritjen ekonomike se sa stimujt fiskal të bazuar në shkurtim të shpenzimeve
IMF (2010)	Efektet makroekonomike të konsolidimit fiskal në 15 vende të zhvilluara përgjatë 30 viteve.	Të dhëna Panel	Negativ	shkurtim i shpenzimeve prej 1 % nuk tregon efekt të rëndësishëm në rritjen, ndërsa një rritje e taksave prej 1 % ulë PBB-në me 1.3% pas dy vitesh.

Romer D.Ch & Romer H.D.,(2010)	Shkaqet dhe pasojat e ndryshimit të taksave në prodhim në vendet e SHBAve ne periudhën 1945-2007.	VAR (Vector Autoregressive) Model / Të dhëna panel:1945-2007	Negativ	Rritja e taksave në raport me PBB-në prej 1% ulë rritjen reale të PBB-së me 3%.
Robert Barro & C...J.,Redlick, (2011).	Efektet makroekonomike të taksave dhe shpenzimeve të qeverisë në SHBA për periudhën 1950-2006.	OLS/ Të dhëna seri 1950-2006	Negativ	Shkurtimi i normave tatimore marginale për 1 (një) pikë % rritë PBB-në për frymë rreth 0.5 % në vitin e ardhshëm
Arnold, et al.(2011).	Roli i politikës së taksave në rimëkëmbjen e rritjes ekonomike në 21 vende të OECD-së për periudhën 1971-2004.	Të dhëna panel, 1971-2004,	Negativ	Ulja 1% e të gjitha taksave rritë PBB-në për frymë prej 0.25-1% në afat të gjatë.
Gemmell, N., Kneller R., Sanz L.,(2011)	Efektet e rritjes nga tatimi në të ardhura personale dhe tatimi në korporata në 15 vende të OECD-së	Metoda e regresionit: PMG dhe FE/ Të dhëna Panel	Negativ	Ndryshimi me një pike % në normën tatimore të tatimit në të ardhura personale dhe atyre të korporata rritë PBB-në vjetore nga 2 në 2.03 %.
Ferede & Dahlbu, (2012).	Ndikimi i shkurtimit të taksave në rritjen ekonomike në provincat Kanadeze për periudhën 1977-2006.	Të dhëna panel, 1977-2006.	TAK-Negativ ; TVSH-Pozitiv; Normat marginale- pa ndikim	Shkurtimi i normës tatimore të TAK për 1 % lidhur me rritje të përkohëshme prej 0.1 deri 0.2 % të PBB-së për frymë. Taksa e lartë në Tvsh sjellë investime me të mëdha private e më këtë edhe normë të rritjes ekonomike më të lartë. Ndërsa, nuk kanë gjetur ndonjë lidhje të rëndësishme në mes të normave tatimore marxhinale në rritjen ekonomike.
Mertens, K. & Ravn, M., (2012).	Efektet e ndryshimeve të tatimit në të ardhura personale dhe tatimit në korporata në SHBA.	VAR Model	negativ	Ulja prej 1 % në normën mesatare të tatimit mbi të ardhurat personale rritë normën e PBB-së për frymë prej 1.4 % në tremujorin e parë dhe deri në 1.8% rritje të PBB-së për frymë pas tre tremujorëve. Ndërsa, një ulje prej 1 % në normën mesatare të tatimit mbi të ardhurat (fitimit) nga korporatat rritë normën e PBB-së për frymë prej 0.4 % në tremujorin e parë dhe deri në 0.6 % rritje të PBB-së për frymë pas një viti.

2.4 Politika fiskale dhe efektet e saj në evazionin fiskal

Problemi më i madh me të cilin përballen sistemet tatimore në çdo vend janë problemi i evazionit tatimor dhe shmangia tatimore. Përderisa, evazoni fiskal i parë ky në aspektin e evazionit që lind nga shkelja e qëllimshme dhe me paramendim e ligjit për të mos paguar tatimin i cili është i imponuar me ligj të juridiksionit tatimor, shmangia e tatimeve është mënyra aktive me të cilën tatimpaguesi kërkon për të reduktuar ose hequr tërësisht përgjegjësinë e tij të vërtetë tatimore pa thyer ligjin (Adebisi, J.F. and Gbegi ,D.O., 2013).

Evazoni tatimor nuk është vetëm një veprimtari e paligjëshme por është e lidhur edhe me vendimet e politikës fiskale nga qeveria. Kjo është vendimtare se si qeveria takson ekonominë dhe se si qeveria shpenzon këto të ardhura (Torgler & Schaltegger, 2006: 1-3) , sepse qeverisë për kryerjen e funksioneve të caktuara nga administrata e saj, i nevojiten përveq tjerash dhe:

- Mbledhja e burimeve nga ekonomia, në mënyrë të mjaftueshme dhe të përshtatëshme si dhe
- Shpërndarja dhe përdorimi i këtyre burimeve me përgjegjësi, eficiencë dhe efektivitet, (OECD, 2004: 17).

Siç ka theksuar Musgrave (1959) se tre kërkesat e politikës fiskale janë: mbledhja e të ardhurave, shpërndarja e tyre dhe stabilizimi i ekonomisë ku dy aspektet e para janë me interes për gatishmerinë e qytetarëve për të paguar apo jo detyrimet tatimore sepse madhësia e të ardhurave varet nga pajtueshmëria e njerëzve për të paguar taksat, poashtu shpërndarja e të ardhurave bazuar në parimet e barazisë, drejtësisë dhe në mënyrë transparente ndikon pozitivisht në pagimin e taksave (Torgler & Schaltegger, 2006: 3).

Kuptimi i konceptit të evazionit fiskal dhe faktorët përcaktues të tyre

Duke parë se dukuria e evazionit fiskal është shumë komplekse dhe prezente në masë të madhe në ekonominë e çdo vendi qoftë atyre të zhvilluara dhe atyre në zhvillim është parë me rëndësi që përgjatë studimit të sistemit tatimor në këtë studim të trajtohet edhe fenomeni i evazionit fiskal dhe atë evazioni që lind nga mosregjistrimi i bizneseve apo individëve për qëllime tatimore, që ndryshe quhet si informaliteti ekonomik dhe evazioni i shmangies së taksave që është mosgatishmëria e tatimpaguesve për të paguar në tërësi taksat në raport me të ardhurat e tyre reale por, i shmangin ato. Siç është përkufizuar nga Rosen (2003): Shmangia tatimore është ndryshimi i sjelljes së tatimpaguesit, në mënyrë që të ulë detyrimin e tij tatimor. Këtë fenomen, John Maynard Keynes e ka quajtur: “*I vetmi profesion intelektual që sjellë ndonjë shpërblim*”, (Rosen, 2003: 390).

Sot ka një numër të madh përkufizimesh dhe autorësh të cilët kanë trajtuar çështjet e ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal. Shumë studime dhe punime shkencore kanë treguar se luftimi i ekonomisë joformale është faktor shumë i rëndësishëm që ndikon në rritjen e mirëqënies së individëve dhe si rrjedhojë edhe rritjes ekonomike të çdo vendi. Mirëpo, nëse shihet në zhargonin e ekonomiksit të mirëqënies, në kushte të caktuara sidomos në vendet me të ardhura më të ulëta, ekzistenca e një ekonomie të fshehtë rritë mirëqënien sociale. Një pjesë e madhe e literaturës rreth informalitetit shpjegon shkaqet e këtij fenomeni kompleks dhe shumë kontraverz. Keith Hart, (1971), ishte i pari që përdori termin e sektorit informal në literaturën akademike në vitin 1971. Ai paraqiti konceptin e sektorit joformal si pjesë e punës urbane, forcë, që do të mbahet jashtë tregut formal të punës për të siguruar jetesën jashtë pagës në sektorin formal të ekonomisë, ose si një

alternativë për të plotësuar të ardhurat e fituara me të. Pavarsisht nga puna e Hart, kërkimi i parë i rëndësishëm në sektorin joformal konsiderohet të jetë raporti i zyrës ndërkombetare të punës (ILO) për punësim në Kenia (1972) ku informaliteti është karakterizuar kryesisht me shmangie nga rregulloret dhe taksat e qeverisë dhe se qëllimi kryesor i informalitetit është furnizimi i jetës për familjet dhe fuqizimi i tij ka efekte pozitive në tregun e punës dhe shpërndarjen e të ardhurave dhe argumenton se zgjedhja e problemeve në sektorin joformal e është i mundur vetëm atëherë kur problemet në këto fusha të jenë zgjidhur. Sipas Smith (1994), ekonomia në hije përfshinë të dy llojet e aktiviteteve, ato ligjore dhe joligjore, definicioni përfshinë: *“prodhimet e mallrave apo shërbimeve nga tregu, qoftë të ligjshme apo të paligjshme, të cilat nuk përfshihen në matjen zyrtare të BPV-se”*.

Gutmann (1977) ishte i pari që llogariti madhësinë e ekonomisë joformale dhe e përkufizoi ekonominë joformale si: *sasi të madhe të të ardhurave të padeklaruara si dhe punë dhe punësim i padekluar*. Gjithashtu, ai tregoi se pjesmarrës në ekonominë joformale është çdokush që përfshihet në transaksionet me para kesh, (Gutman, 1977: 2)

Schrage (1984) dhe Thomas (1992) e përkufizuan ekonominë joformale si: Një sërë aktiviteteve ekonomike që në parim ushtrohen legalisht por që nuk deklarohen si aktivitete ekonomike legale dhe si të tilla nuk i nënshtrohen pagesës së tatimeve dhe nuk përfshihen në vlerën e të ardhurës kombëtare. Ndërsa, shumë autorë që kanë studiuar këtë fenomen, thonë se me informalitet identifikohet puna ilegale që krijohet për të siguruar një pagë qoftë për të mbijetuar apo për të krijuar të ardhura shtesë nga paga. Pavarsisht, nga këto që u thanë më lartë, autorë të ndryshëm kanë identifikuar faktorë të shumtë si përcaktues për t'u përfshirë në ekonominë joformale si për të punësuarit edhe për punëdhënësit.

2.4.1 Faktorët që ndikojnë evazionin fiskal dhe shmangien tatimore

Për të kuptuar evazionin fiskal, çështja më e rëndësishme do të ishte marrja e përgjigjës në pyetjen se: Pse tatimpaguesit i shmangin taksat, në mënyrë që të kuptohet se cilët janë faktorët që i shtyejnë tatimpaguesit të shkaktojnë evasion fiskal.

Siç u tregua më parë, koncepte të shumta janë dhënë nga autorë të shumtë për të pasqyruar përpjekjet e tatimpaguesve, për të reduktuar sasinë e detyrimit tatimor. Gjithashtu, teori dhe modele, përfshirë edhe punën empirike të shumë autorëve janë zhvilluar me qëllim të përcaktimit të faktorëve kryesor që ndikojnë në sjelljen e tatimpaguesve për të hyrë në këtë veprimtari, qofshin ato veprimtari të ligjëshme apo të paligjëshme. Disa nga faktorët më të rëndësishëm me ndikim në shfaqjen e këtij fenomeni do të trajtohen si në vijim:

Barra e taksave (Detyrimet e larta tatimore)

Përceptimi i përgjithshëm i evazionit tatimor në shumicën e vendeve është theksi mbi barrën e taksave. Dëshira e shumë vendeve për të mbushur arkën e shtetit në një afatë më të shkurtër bënë që qeveritë e tyre të ndërhyjnë përmes ndryshimit në politikat fiskale vendosin norma të larta taksash duke krijuar kështu pakënaqësi nga ana e tatimpaguesve dhe në këtë mënyrë duke shkaktuar evasion fiskal. Prandaj, shumë autorë përcaktojnë se evazoni fiskal është shkaktuar kryesisht nga normat e larta tatimore dhe ulja e probabilitetit të auditimit, (Gerxhani, 2004). Efektet politike dhe psikologjike që dalin nga reagimet negative të tatimpaguesve për shkak të rritjes së taksave kur ata ndjejnë se taksat e detyrueshme janë shumë të larta në krahasim me të ardhurat e tyre i shtyejnë ata drejt evazionit fiskal dhe mashtrimit për t'i ulur detyrimet e tyre tatimore. Mirëpo, madhësia e barrës tatimore nuk duhet të shiqohet në mënyrë rigoroze si vlera relative në të gjitha vendet. Është e nevojshme të merret parasysh edhe fuqia blerëse e të ardhurave që mbesin

pas tatimit sepse ka vend që hasim barrë të njëjtë tatimore por, në kushte të ndryshme (Dragomir G., 2011).

Një numër i madh studimesh si Kaufmann dhe Kaliberda (1996), Schneider (2007), Yalama & Gumus, (2013), tregojnë se normat e larta tatimore dhe barra e taksave rrisin evazionin fiskal. Gjithashtu, në një studim të bërë në 145 vende të botës, përfshirë vende të zhvilluara, vende në zhvillim dhe vende në periudhë tranzicioni, Shnajder ka gjetur se madhësia mesatare e ekonomisë joformale si % e PBB-së në vitet 2002/2003, në 96 vende në zhvillim të përfshira në studim ishte 38.7%, në 25 vende që ishin në periudhë tranzicioni kjo pjesëmarrje ishte 40.1%, ndërsa në 21 vende të zhvilluara të OECD 16.3% e PBB-së i takonin ekonomisë joformale. Ai ka treguar edhe arsyet pse njerëzit hynë në aktivitete joformale si: normat e larta të tatimeve dhe kontributeve pensionale si dhe efektet e veprimeve rregulluese qeveritare, Shnajder (2008: 2-19).

Në një studim të tyre Agha dhe Haughton (1996: 307) ofruan një përmbledhje për evasion fiskal të TVSH-së në vende të ndryshme të Europës dhe treguan se: në fund të viteve të 70-eta , 40% e të ardhurave nga TVSH ishin të pambledhura, një e treta e bizneseve kishte shmangur një pjesë të TVSH-së, ndërsa raporti nga auditimet në vitin 1984 në Francë tregon se dy të tretat e bizneseve të audituara kishin nënvlerësuar vlerën e shitjeve të tatueshme. Në përgjithësi rezultatet e tyre tregojnë se respektimi apo pajtueshmëria e tatimpaguesve për të paguar TVSH-në rritet me një normë me të ulët të TVSH-së, gjithashtu, ata ardhën në përfundim se një normë e vetme tatimore me bazë të gjerë është ideale për një përgjigje pozitive të tatimpaguesve për pagesë të TVSH-së.

Faktorët demografik dhe socio-ekonomik dhe ndikimi i tyre në evazionin fiskal

Faktorët demografik, social dhe ekonomik si dhe faktorë të tjerë kanë ndikim të rëndësishëm në sjelljen e tatimpaguesve për evazion fiskal. Faktorët socio demografik janë faktor të rëndësishëm që ndikojnë në vendimin e tatimpaguesve për përfshirje apo jo në evazion të taksave duke filluar nga variablat e rëndësishme si mosha, gjinia dhe arsimimi. Në këtë aspekt Tittle (1980) argumenton se të moshuarit janë më të ndjeshëm nga kërcënimet e sanksioneve, pra ata janë më pak të prirur t'i shmangën taksat, ndërsa, sa i përket gjinisë poashtu Tittle (1980) tregon se femrat janë më pak të prirura t'i shmangin taksat sepse janë më pak të pavarura se meshkujt. Poashtu, sipas tyre shkalla e arsimimit të tatimpaguesve ka ndikim në evazionin e taksave sepse tatimpaguesit e arsimuar njohim me mirë ligjet e taksave dhe janë me të vetëdijshëm për përfitimet nga shërbimet që ofron shteti për qytetarët si dhe kuptojnë me mirë edhe keq përdorimet e mundshme të qeverisë dhe dinë të jenë më kritik për mënyrën se si shteti përdorë të ardhurat nga taksat për këtë arsye arsimimi ndikon në nivelin e evazionit tatimor. Gjithashtu, gjetjet empirike nga Yalama & Gumus, (2013) të zhvilluara në Turqi tregojnë një numër faktorësh me ndikim në sjelljen e tatimpaguesve për të shkaktuar evazion fiskal. Rezultatet e studimit të tyre tregojnë se: faktorët ekonomik, demografik, administrativ dhe faktorë të tjerë janë statistikisht të rëndësishëm në sjelljen e tatimpaguesve për evazion fiskal. Përpos tjerash, rezultatet e tyre tregojnë se shkalla e arsimimit ka efekt negativ në evazion fiskal. Ata treguan se tatimpaguesit me pak të arsimuar kanë tendencë me të madhe për të shmangur taksat se sa ata me arsimim më të lartë.

Faktorë tjerë të cilët mund të kenë ndikim në këtë dukuri janë edhe statusi martesor, punësimi, gjendja ekonomike dhe fetare. Vlenë të theksohet se përkatësia fetare luan një rol

të rëndësishëm në përcaktimin e shkallës së evazionit të taksave. Në ato vende ku lidhjet në mes të Kishes dhe autoriteteve shtetërore janë më të ngushta qytetarët ndjehen me të angazhuar për financimin e shtetit dhe cek se kjo mund të jetë arsye pse në vendet nordike morali për të paguar taksat është me i lartë (Torgler & Scholtegger, 2006: 11-17).

Përpos tjerash rezultatet e tyre tregojnë se normat tatimore dhe barra e taksave rrisin evazionin fiskal. Shkalla e arsimimit ka efekt negative në evasion fiskal. Ata treguan se tatimpaguesit me pak të arsimuar kanë tendencë me të madhe për të shmangur taksat se sa ata me arsimim më të lartë.

Në kuptim të gjerë, motivet për pjesëmarrje në ekonomi joformale janë të lidhura kryesisht me papunësinë dhe koston e lartë të prodhimit formal. Në këtë aspekt Swaminathan (1991) argumenton se arsyeja kryesore për të zhvilluar punë në sektorin joformal në vendët në zhvillim, është e lidhur me problemet e varfërisë dhe nevojat e mbijetesës. Një konkudim i ngjashëm jepet edhe nga Bernabe (2002) dhe Rutkowski (2006), të cilët thonë se mungesa e mundësive për të gjetur punë në tregun formal dhe nevoja për mbijetesë në vendet në tranzicion i motivon njerzit për punë në ekonominë e zezë ndërsa, në vendet e zhvilluara aktivitetet joformale zhvillohen qëllimisht, si mundësi për profit me të lartë. Përderisa, Ruffer dhe Knight (2007) mendojnë që, sikurse informaliteti i vullnetshëm, ashtu edhe ai i pavullnetshëm mund të aplikohen në shtetin e njejtë dhe siç e shpjegojnë ata, përfshirja në ekonomi të fshehtë shihet si mundësi e suksesit ekonomik dhe pastaj edhe punësimi joformal zgjidhet me vullnetin si mundësi për profit me të lartë. Për dallim nga këta të fundit, Kucera dhe Roncolato (2008) bëjnë dallimin në mes të punësimit joformal të vullnetshëm nga ai i pavullnetshëm dhe ky dallim varet nga shkalla e zhvillimit të shtetit.

Sipas tyre në shtetet e zhvilluara ku siguria sociale është më e madhe, të punsuarit mund të kenë alternativë punsimin joformal të vullneteshem nëse duan të krijojnë të ardhura shtesë përndryshe për ta kujdeset shteti ndërsa në shtetet në zhvillim ku siguria është e ulët apo nuk ekziston fare për disa kategori të njerëzve atëherë punësimi joformal i pavullnetshëm është i imponuar.

Mosbesimi në institucionet publike

Përveq faktorëve socio demografik dhe atyre socio ekonomik në nivelin e evazionit të taksave kanë ndikim të madh edhe besimi në vendimet dhe veprimet e qeverisë. Pra, qeveria mund të nxisë besimin tek tatimpaguesit nëse krijon një reputacion të mirë. Një sistem tatimor efektiv duhet të jetë i zbatueshëm në mënyrë që të siguroj stimujt për tatimpaguesit që ata të paguajnë taksat, një formë e këtyre stimujve do të ishte besimi në qeverinë se burimet e mbledhura nga pagesa e tatimeve do të kthehen në ofrim të shërbimeve të qytetarëve dhe nuk do të keqpërdorën nga zyrtarët qeveritar. Tatimi ndikon në procesin e rritjes ekonomike nëse nga viti në vit ai gjeneron rritje të burimeve për të financuar furnizimin e të mirave publike nga qeveria. Taksimi është i lidhur me shtetin në dy aspekte: Ekziston lidhja midis taksimit dhe llogaridhënjes nga shteti në njerën anë dhe mardhënja në mes të tatimit dhe kapacitetit shtetëror në anën tjetër. Për të respektuar këto mardhënje qytetarët për të paguar me shumë taksa kërkojnë me shumë shërbime në kthim nga shteti pra, rritja e të hyrave publike nepërmjet taksimit normalisht rritë kërkesën e qytetarëve për një qeveri me të përgjegjshme dhe të pakorruptuar gjithashtu shumë me rendësi është dëgjimi i zërit të qytetarëve se si ata e përceptojnë taksimin dhe përpjekjet e qeverisë për rritjen e taksave sepse rritja e taksave në njerën anë dhe papërgjegjshmëria e qeverisë në anën tjetër shtyejnë kontribuesit e taksave gjithnjë e më tepër drejt evazionit

tatimor. Pra, qeverisja e mirë rritë besimin e qytetarëve në institucionet publike dhe i shtyen qytetarët për t'ju pergjigjur vullnetarisht pagimit të tatimeve

Faktori me më rëndësi që mund të kontribuoj në dallimin në mes të ardhurave të mundëshme nga pagesa e tatimeve dhe atyre aktuale në secilin vend është: Agjensia e mbledhjes së taksave e cila në disa vende mund të tregoi joefikasitet institucional, aftësi të pamjaftueshme në mbledhje të taksave dhe personel menaxhues të dobët.

Sipas një klasifikimi të bërë nga Komisioni European, vendimi për të paguar apo shmangur një taks është përcaktuar nga faktorët si në vijim:

- Kuptimi i drejtësisë në shpërndarje- nënkupton se nëse një tatimpagues është i sigurtë që mjetet e mbledhura nga taksat shpërndahën në mënyrë të drejtë
- Drejtësia procedurale nënkupton një sjellje të duhur të administratorit të taksave me tatimpaguesin. Drejtësia në ndëshkim, do të thotë të aplikohet ndëshkim adekuat në rastet e shkeljes së ligjit tatimor, sepse nëse aplikohet ndëshkim shumë i rëndë, ai do të ndikojë negativisht në qëndrimet e tij ndaj pagesës së tatimit.
- Një faktor tjetër janë normat personale dhe ato shoqërore. Normat personale kanë të bëjnë me vendimet e individit për të paguar shumën e tatimit që i takon apo për t'a shmangur atë, ndërsa normat shoqërore kanë të bëjnë me qëndrimet e shoqërisë ndaj pagesës së drejtë të tatimit apo shmangies së tyre. Normat personale dhe ato shoqërore janë të ndërlidhura për faktin se personat mund të shfrytëzojnë sjelljet shoqërore për t'i kthyer ato në sjellje personale.
- Faktor me rëndësi në sjelljen e individit ndaj evazionit fiskal është edhe: perceptimi i probabilitetit të kontrollit tatimore dhe sanksionet. Një probabilitet me i lartë për

kontroll tek tatimpaguesi dhe një dënim i përcaktuar bënë të mundur që njërzit t'u binden ligjeve tatimore, (European Commission ,2010).

Në gatishmërinë për të paguar taksat ndikon shumë edhe mënyra e sjelljes së autoriteteve tatimore ndaj tatimpaguesve. Nëse zyrtarët tatimor sillen me korrektësi e drejtësi dhe me korrektësi e respekt ofrojnë shërbime për tatimpaguesit atëherë niveli i pajtueshmërisë për të paguar taksat do të rritet e bashk me të ulët edhe kostoja e mbledhjes së taksave, në të kundërtën një trajtim i pasjellshëm do të ulë moralin tatimor ndërsa kostoja e mbledhjes së taksave do të rritet për shkak se nevoja për auditim të bizneseve do të jetë e madhe dhe do të bëhet si rregull në vend se do të ishte shumë pak e nevojshme.

Analizat empirike nga (Frey 2003) kanë treguar dy aspekte të rëndësishme të trajtimit me respekt të tatimpaguesve: së pari transparenca e procedurave të përdorura nga autoriteti tatimor. Në rast se, procedurat janë të qarta dhe të hapura për komunikim nga zyrtarët e shtetit, atëherë, edhe gatishmëria për të paguar tatimin është e madhe dhe se dyti: trajtimi me respekt dhe i barabartë i tatimpaguesve dhe mënyra e trajtimit në mes të tatimpaguesve të ndershëm dhe atyre të pandershëm. Tatimpaguesit e ndershëm nëqoftëse, kanë bërë gabime të vogla me rastin e dorzimit të deklaratave të tyre tatimore nuk duhet të trajtohet si vepër penale për mashtrim të qëllimshëm tatimor njësoj sikurse të tatimpaguesit e pandershëm sepse morali tatimor i tatimpaguesit të ndershëm pastaj do të dëmtohet.

Poashtu, në lidhje me vendet në tranzicion, Kaufmann dhe Kaliberda (1996) specifikojnë se përcaktues të një ekonomie joformale në rritje të shpejtë përpos tjerash janë: shkalla e lartë burokratike, korrupsioni, lufta civile, tregu dhe mekanizmat e tij të pazhvilluara, shkalla e

ulët e liberalizimit ekonomik, barra e lartë e taksave, mungesa e besueshmërisë ndaj qeverisë dhe jostabiliteti makroekonomik.

Provat empirike të Shnajder dhe Neck, me rastin e reformave tatimore në Austri thonë se rënia e kompleksitetit të sistemit tatimor mund të nxitë ekonominë joformale duke kufizuar dhe reduktuar përjashtime të ndryshme tatimore. Në kundërshtim me këtë dëshmi, Thieben (2003), konstaton se ekonomia joformale e Ukrainës është rritur si pasojë e kompleksitetit të ligjeve tatimore.

Evazoni tatimor dhe Korrupcioni

Është krejt normale që nën kushtet e qeverisjes së keqe të të ardhurave publike, qytetarët mund ti rezistojnë pagesës se tyre nëse ata besojnë se sistemi i taksave është shumë i paligjeshëm dhe si një arenë morale ku nuk ka rregulla duke nxitur ata për të shmangur tatimin përmes strategjive të ndryshme, sidomos kur konsideron se vendi është futur nën kthetrat e korrupsionit dhe përvetsimit nga ana e zyrtarëve publik. Mosndëshkimi i zyrtarëve publik të cilët janë shëndrruar në pardon me ndikim në duart e të cilëve qytetarët e vendosin besimin e tyre në shumë vende të botës kryesisht në ato në zhvillim në vend se t'u besohet institucioneve shtetore ka bërë që korrupsioni të jetë një fenomen në rritje e bashk me të edhe evazoni tatimor (Orock & Mbuagbo, 2012: 480-482).

Schneider (2007) përpos barrës së rregulloreve edhe tatimeve të qeverisë si shkaqe të informalitetit shton edhe korrupsionin e zyrtarëve publik.

Në një studim të tyre Seren & Panades kanë theksuar se evazoni fiskal dhe korrupsioni kanë bërë krizën ekonomike më keq, për faktin se prania e evazionit fiskal ka tendencë për të bërë tatimpaguesit më të kujdesshëm ndaj zyrtarëve qeveritare dhe si pasojë më pak të gatshëm për të paguar taksat (Seren & Panades, 2013: 809)

Prezenca e korrupsionit në shoqëri sjellë ulje në normën e rritjes ekonomike përmes shtrembërimeve në mbledhjen e të ardhurave nga tatimet, nivelit të shpenzimeve publike dhe përbërjes së shpenzimeve publike. Kjo për arsye siç theksojnë Rose, Akcerman, Susan (1975), zyrtarët qeveritar të korruptuar preferojnë kryerjen e atyre shpenzimeve publike të cilat i'u mundsojnë atyre mbledhjen e ryshfeteve të cilat është më lehtë për t'i mbajtur të fshehura.

Kontrolli tatimor dhe efektet e tij në evazionin fiskal

Shumë autorë përcaktojnë se evazoni fiskal është shkaktuar kryesisht nga normat e larta tatimore dhe ulja e probabilitetit të auditimit, (Gerxhani, 2004). Për këtë arsye për të reflektuar ndikimin e tij në sjelljen e tatimpaguesit vlenë për të korrigjuar probabilitetin e auditimit. Sipas perspektivës së teorisë së Khaneman –Tversky, individët kanë tendencë për të mbivlersuar shanset e vogla të kontrollit tatimor duke marr parasyshë burimet e kufizuara të autoriteteve tatimore dhe intuitivisht mund të thojnë se probabiliteti i kontrollit është i vogël. Nga ana tjetër, autoritetet tatimore në gjithë botën përpiqen për të futur parime moderne të menaxhimit të riskut për të trajtuar tatimpaguesit në përputhje me sjelljen e tyre. Zhvillimet teknologjike kanë ndihmuar administratën e tatimeve për të kryer analiza të ndryshme në gjurmë të shmangieve të tatimpaguesve, por prapë nuk ka teknika të përsosura kur merren parasysh se kapacitetet që të merren me të gjitha shmangiet janë të kufizuara.

Studime empirike të cilat mundohen të shpjegojnë ndikimin e faktorëve administrativ në ndalimin e evazionit tatimor janë zhvilluar edhe në Gjermani. Një studim i bërë atje për vitet 1974-2001 tregon se gjobat e lidhura me kontrollin tatimor shkaktojnë ekonominë

joformale ndërsa, numri i mundshëm i firmave që do të auditohen nuk ka ndonjë rëndësi për përfshirje në këtë dukuri (Feld, Schmidt & Schneider, 2007: 23).

Poashtu, ka shumë arsye tjera që autoritetet të dështojnë në mbledhjen e të ardhurave të fshehura. Një aspekt është paaftësia e auditorit, e cila varet nga situata në tregun e punës të një vendi, nëqoftëse pagat në sektorin publik janë më të ulëta se në atë privat, autoritetet tatimore kanë shanse më të vogla për të tërhequr personel me kompetent. Pagat e ulëta dhe vlerat morale të auditorëve dërgojnë tek korruptimi i tyre i cili do të bashkpunon me tatimpaguesin, (Anciute & Kropiene,).

2.4.2 Morali tatimor dhe evazoni fiskal

Pagimi i taksave gjatë gjithë historisë ka qenë dhe do të qëndrojë në rolin kryesor të politikës fiskale pasi që krijon bazën e shtetit për të punuar. Prandaj, është shumë e rëndësishme për të analizuar moralin e taksave. Mund të supozohet se askujt nuk i pëlqen të paguaj taksat edhe pse të gjithë e dinë se taksat janë thelbësore për qeverinë. Janë disa instrumente të rëndësishme që ndihmojnë për të shpjeguar mos pajtueshmërinë apo pajtueshmërinë me taksat. Shumë studiues kanë theksuar se morali i taksave se pari shihet si motivim i brendshëm për të paguar taksat i ndikuar nga një sërë faktorësh si socio-demografik, socioekonomik, krenaria kombëtare apo fetare e një shoqërie; se dyti marrëveshjet institucionale me të cilat qeveria punon si shkalla e pjesëmarrjes demokratike e qytetarëve (tatimpaguesve) në vendimet e qeverisë, shkalla e decentralizimit të tatimit dhe niveli i besimit institucional, se treti sjellja e administratës tatimore, efektiviteti i administratës dhe sjellja e saj ndaj tatimpaguesve si dhe madhësia e barrës tatimore janë vendimtare që njerëzit të paguajnë apo jo tatimin. Pra, siç shifet evazoni tatimor nuk është vetëm një veprimtari e paligjshme por është e lidhur me vendimet e politikës fiskale nga qeveria,

sjelljen e zyrtarëve të taksave dhe aspektet kulturore prandaj jo vetëm niveli i zbatimit të ligjit, por edhe niveli i moralit tatimor është vendimtar për të kuptuar sjelljen e qytetarëve dhe gadishmërinë e tyre për pagesë të taksave sepse morali tatimor shihet i lidhur me justifikim ekonomik të taksimit. Kjo është vendimtare se si qeveria takson ekonominë dhe se si qeveria shpenzon këto të ardhura.

Një studim i bërë nga Adebisi dhe Gbegi tregon se lartësimi shpirtëror i qytetarëve për të paguar taksat dhe shfrytëzimi adekuat i të ardhurave tatimore për mallrat dhe shërbimet publike do të dekurajojë shmangien tatimore dhe evazionin fiskal ndërsa, normat e larta të taksave inkurajojnë shmangien tatimore dhe evazionin fiskal. Studimet e para në lidhje me pajtueshmërinë tatimore u bënë në vitet e 60 dhe 70 nga studiuesit gjerman të shkollës së psikologjisë tatimore të Këlnit. Ata e panë moralin e taksave si një qëndrim në lidhje me pajtimin tatimor, (Schmolders 1960). Sondazhet e tyre treguan se pesha e taksave është tregues për nivelin e moralit tatimor dhe gjetën se njerëzit e vetpunësuar kanë moralin e taksave më të ulët sesa të punsuarit ndërsa, Strumpel (1969) theksoi se trajtimi i tatimpaguesve me kujdes të madh ndihmon kultivimin e moralit të taksave (rritjen e nivelit të moralit tatimor) dhe reduktimin e kostove të pajtueshmërisë së taksave.

2.4.3. Matja e evazionit fiskal

Me shfaqjen gjithnjë e më të madhe të evazionit fiskal u shfaqen edhe metodat për të matur atë. Dy qasjet që janë të rëndësishme në literaturë janë: metoda direkte dhe ajo indirekte. Metoda indirekte fokusohet në studimin e statistikave që janë në dispozicion. Kjo metodë matë madhësinë e të ardhurave të paraportuara përmes matjes së masës monetare në qarkullim. Sipas kësaj logjike çdo kërkesë në rritje për para të gatshme korrespondon me

një rritje të aktivitetit ekonomik në sektorin joformal. Një tjetër metodë indirekte është metoda e mospërputhjes të ardhura/shpenzime. Ndërsa, metoda direkte përfshinë hulumtimet e drejtpërdrejta përmes përzgjedhjes së mostrës. Zakonisht, mostra përzgjidhet rastësishtë, p.sh. zgjidhen në mënyrë rastësore për hulumtim një moster prej 200 deklaratave tatimore të tatimpaguesve (Heintz James).

Michael G. Allingham dhe Agnar Sandmo, dhanë një model mikroekonomik për matjen e evazionit fiskal në vitin 1972. Qëllimi i modelit të tyre është që të zbuloi se sa të ardhura ka deklaruar një tatimpagues, duke e ditur se ka një normë të caktuar të probabilitetit që kontrolli tatimor tek ai do të ndodh. Supozimet e modelit kanë të bëjnë më atë se një tatimpagues me rastin e deklarimit të të ardhurave të tij, nëse është i ndershëm deklaron të gjitha të ardhurat e tij, ndërsa nëse nuk zgjedhë këtë rrugë dhe nuk tregon të gjithë shumën e të ardhurave të tij, ekziston mundësia që ai të kontrollohet nga autoriteti tatimore dhe të dënohet, kështuqë situata e tij bëhet me keq se sa të kishte paguar gjithë shumën e tatimit që i takon. Faktorët përcaktues të supozuar në këtë model janë:

W- janë të ardhurat totale të tatimpaguesit, të cilat ka mundësi të zbulohen dhe është një variabël ekzogjene;

X- shuma e të ardhurave të deklaruar nga tatimpaguesi. Nëse tatimpaguesi do të ishte i ndershëm $X=W$, nëse tatimpaguesi do të jetë i pandershëm $X<W$;

θ -Norma proporcionale e tatimit mbi të ardhurat;

p- probabiliteti që tatimpaguesi do të kontrollohet nga administrata tatimore, nëse kjo ndodhë atëherë të ardhurat e tij që do të përcaktohen janë W-X

π – është norma e dënimit e cila është më e lartë se norma e tatimit θ , nëse gjenden të ardhura të padeklaruara. Ky model nuk dha shumë rezultate të qarta, mirëpo ishte si

udhërrëfyes i shumë punimeve teorike e në veqanti atyre empirike. Aty nuk u qartësua nëse rritja e shkallës së tatimit inkurajon tatimpaguesit të përfshihen në evazion fiskal. Mirëpo, ata konstatuan se nëse norma e dënimit π rritet atëherë rritet edhe shuma e të ardhurave rritet, gjithashtu nëse shkalla e probabilitet të kontrollit tatimor rritet atëherë rritet edhe shuma e të ardhurave të deklaruar.

Meqenëse, modeli themelor i evazionit tatimor i quajtur modeli A-S bëri të mundur vetëm pjesërisht për të shpjeguar sjelljen e tatimpaguesve në lidhje me evazionin fiskal, modeli u përmirësua nga Shlomo Ytzhaki në vitin 1974. Ai përmirësoi modelin duke marrë në konsideratë aplikimin e dënimit mbi shumën e tatimit të papaguar të të ardhurave që nuk ishin deklaruar e jo imponimin e normës së dënimit mbi të ardhurat e padeklaruar. Kjo llogaritje ishte bazuar në faktin se ishte ekonomikisht me e rëndësishme, gjithashtu edhe ligjet tatimore ishin të formuluar në atë mënyrë që llogaritja e dënimeve ishte e përcaktuar mbi shumën e tatimit të papaguar. Ndryshimi i sygjeruar nga Ytzhaki dhe që përmirësoi modelin A-S tregoi se ndryshimi i normës së tatimit është me efekt pozitiv. Një ndryshim i normës së tatimit sipas këtij modeli vjen si rezultat i aplikimit të dënimit mbi shumën e padeklaruar të të ardhurave d.m.th. tatimi i përcaktuar mbi të ardhurat plus një normë dënimi ndikon që norma e tatimit të rritet. Ytzhaki shpjegoi se: kur norma e tatimit është rritur, të ardhurat e deklaruar janë rritur do të thotë tatimpaguesit veprojnë me më ndershmëri. Këtë rezultat ai e shpjegoi se për shkak se kur norma e tatimit rritet si rezultat i aplikimit të dënimeve, të ardhurat e disponueshme të tatimpaguesit zvoglohen, atëherë tatimpaguesi apo personi do të jetë më pak i prirur për të marrë rreziqe për të shmangë

tatimin. Kjo gjetje, gjithashtu është në kundërshtim me pikpamjet se norma e rritjes së tatimeve shkakton stimuj më të lartë për të shmangur ato, (Ytzhaki, 1974:)

Fakti se evazoni fiskal është shumë vështirë për t'u matur është shumë i qëndrueshëm për shkakun se evazoni fiskal lind kur ka një shansë për të ndodhur. Kjo mund të shpjegohet me atë se tatimpaguesi deklaron të ardhurat të cilat janë më lehtë për t'u zbuluar, kështu p.sh. tatimpaguesi deklaron të ardhurat që ka përmes transaksioneve bankare ndërsa, nuk deklaron të ardhurat përmes keshit. Poashtu, pagat e ulëta dhe vlerat morale të auditorëve dërgojnë tek korruptimi i tyre i cili do të bashkëpunon me tatimpaguesin. Pra, modeli A-S mund të përmirsohet me këtë element shtesë. Në këtë rast modeli merr parasysh një shumë ryshfeti proporcionale me tatimin e shmangur, ky sygjërim duket i arsyeshëm sepse, nëse një sasi më e madhe e tatimeve janë shmangur, kjo kërkon më shumë sasi financiare për të bindur auditorin për të bashkëpunuar (Ancute & Kropiene,).

Një nga autorët e A-S, më vonë ka modifikuar modelin bazë në dy aspekte: në vend të pyetjes sa për të deklaruar ai bazohet në atë sa për të fshehur. Ai, gjithashtu mori parasysh propozimet e Shlomo Ytzhaki në lidhje me llogaritjen e gjobës.

Përpjekjet për të zgjeruar dhe përmirësuar modelin A-S që nga paraqitja e tij nuk janë ndaluar. Përfshirja e faktorëve që janë vështirë për t'u matur korrespondon me punën e Geert Hofstede i cili zhvilloi teorinë e dimensionit kulturor. Kjo teori i jep një shprehje sasiore vlerave të caktuara dhe tregon se si maten ato. Ai tregon se evazoni tatimor ka lidhje reciproke me moralin e taksave. (Ancute & Kropiene, 2010).

Gjithashtu, në një punim empirik të bërë nga Cabelle & Panades(2007), në lidhje me ndikimin e evazionit fiskal në rritje ekonomike në periudhë afatgjate, ata kanë aplikuar normat e dënimit mbi sasinë e taksave të shmangura e jo në sasinë e të ardhurave të

padeklaruara (siç është propozuar nga Alingham dhe Sandmo në teorinë e tyre) përdorimi i normës së dënimit në sasinë e taksave të shmangur e jo në sasinë e të ardhurave të padeklaruara siç e shpjegojnë ata ishte përdorur se kjo e fundit është më pak tërheqëse për t'u përdorur në baza empirike pasi që ajo është në kundërshtim me dispozitat ekzistuese të ligjeve tatimore. Kjo mund të shpjegohet edhe me faktin se përdorimi i normës së dënimit në sasinë e pa deklaruar të të ardhurave rëndon shumë barrën tatimore. Gjetjet e tyre treguan se edhe kur gjobat janë proporcionale me sasinë e taksave të shmangur, shkalla e akumulimit të kapitalit nuk mund të rritet e më këtë as rritja ekonomike për shkak norma e aplikuar e dënimit ulë të ardhurat e disponueshme. Ata shpjeguan se evazioni fiskal i shkaktuar nga normat e larta tatimore mund të rrisë sasinë e të ardhurave të disponueshme dhe në këtë mënyrë kapitali mund të blihet me një ritëm të shpejtë. Kjo mund të shpjegohet me faktin se normat e larta tatimore shtyejnë tatimpaguesit për të shkaktuar evazion përderisa aplikimi i normave të ulëta tatimore rritë ndershmërinë e tatimpaguesve për të paguar detyrimet tatimore.

LLogaritja e probabilitetit tatimor

Në bazë të modelit A-S, vlera me e lartë e probabilitetit tatimor korrespondon me një shkallë më të lartë të ndershmërisë nga ana e tatimpaguesve. LLogaritja e thjeshtë e probabilitetit tatimor mund të përcaktohet duke përdorur përkufizimin klasik të tij:

$$P = p/N$$

Ku P – është probabiliteti tatimor

P – është numri i kontrolleve të mundshme

N- është numri i përgjithshëm i tatimpaguesve

Një përkufizim i tillë nënkupton një probabilitet apo mundësi të barabartë për të gjithë tatimpaguesit që do të kontrollohen. Mirëpo, një praktikë e tillë ka qenë e vlefshme në dekadat e mëhershme për të hetuar gjendjen e përgjithshme të tatimpaguesve dhe për të mësuar nëse personat e pandershëm kanë mësuar forma të reja të evazionit fiskal që autoritetet tatimore ende nuk i dinë. Kjo metodë pra, nuk është efikase për të luftuar evazionin fiskal. Duhet pasur parasysh se në atë periudhë numri i bizneseve ishte shumë më i vogël. Për këtë arsye probabiliteti i kontrollit tatimor, për të reflektuar ndikimin e tij në sjelljen e tatimpaguesit vlenë për të korrigjuar probabilitetin e auditimit. Sipas perspektivës së teorisë së Khaneman –Tversky, individët kanë tendencë për të mbivlersuar shanset e vogla të kontrollit tatimor duke marr parasyshë burimet e kufizuara të autoriteteve tatimore dhe intuitivisht mund të thojnë se probabiliteti i kontrollit është i vogël. Nga ana tjetër autoritetet tatimore në gjithë botën përpiqen për të futur parime moderne të menaxhimit të riskut për të trajtuar tatimpaguesit në përputhje me sjelljen e tyre. Zhvillimet teknologjike kanë ndihmuar administratën e tatimeve për të kryer analiza të ndryshme në gjurmë të shmangieve të tatimpaguesve, por prapë nuk ka teknika të përsosura kur merren parasysh se kapacitetet që të merren me të gjitha shmangiet janë të kufizuara. Për këtë arsye probabiliteti tatimor duhet të merret si funksion i përbërë nga parametrat siç janë: saktësia e zbulimit, numri i mashtruesve dhe burimet në dispozicion, (Anciute & Kropiene)

2.4.4 Evazoni fiskal në Kosovë dhe faktorët që shkaktojnë atë

Mbledhja e ulët e të ardhurave tatimore nga burimet e brendshme në Kosovë tregon për përfshirje të lartë të tatimpaguesve në shmangie të taksave. Përsderisa në shumë vende për shkak se taksat e detyrueshme janë shumë të larta në krahasim me të ardhurat e tatimpaguesve i shtyejn ata drejt evazionit fiskal dhe mashtrimit për t'i ulur detyrimet e tyre

tatimore. Mirëpo, jo gjithmonë duhet të shiqohet vlera relative e barrës tatimore në të gjitha vendet. Por duhet të merret parasysh edhe fuqia blerëse e të ardhurave që mbysin pas tatimit sepse ka vend që hasim barrë të njëjtë tatimore por, në kushte të ndryshme.

Si njëri ashtu edhe tjetri nga faktorët e lartëcekur nuk mund të konsiderohen si shkaktar të evazionit tatimor në rastin e Kosovës kur bëhët fjalë për barrën tatimore që rëndon mbi bizneset duke u nisur nga fakti që Kosova ka normat tatimore me të ulëta në rajon, ka numer të madh të shpenzimeve të lejueshme dhe se ka një situatë të qëndrueshme financiare, mirëpo këto faktor mund të merren parasysh tek të taksimi i të punsuarve kur dihet se niveli i pagave është tejet i ulët në të dy sektorët publik e privat dhe se Kosova ka normën më të lartë të varfërisë dhe papunësisë në rajon. Kjo tregohet edhe në raportin e FMN-së për vitin 2013, ku thuhet se Kosova ka treguar qëndresë të konsiderueshme ndaj turbulencave të jashtme, mirëpo papunësia në 35 % mbetet shumë e lartë edhe pse pjesa me e madhe e saj pasqyron punësimin informal, (IMF, 2013: 1-5).

Tabela 2: Barra mesatare e taksave në Kosovë , Rajon dhe BE, si % e PBB-së, (2012), në %

	Shteti	Tatimi i vlerës së shtuar	Tatim fitimi	Tatimi në të ardhura personale	Sigurimet shoqërore
Mesatarja	Kosova	2.75	2.28	1.75	2.24
Mesatarja	Rajoni	8.90	2.20	3.90	10.70
Mesatarja	BE	6.90	2.40	9.20	14.60

Burimi: www.atk-ks.org; IMF (Vlersimet e stafit te FMN-se, Qershor,2013); Source: Commission services

Siç shihet nga tabela 6.1, barra e taksave në Kosovë, është shumë e ulët, krahasuar me vendet e rajonit dhe ato të BE-së. Ndërsa, sa i përket kontributeve pensionale gjithashtu, Kosova ka barrën më të ulët në Rajon dhe BE. Barra tatimore në rajonin e Ballkanit në vitin 2012 (përfshirë të gjitha taksat jo vetëm ato të prezentuara në tabelën e mësipërme)

është mesatarisht sa 30.3 % e PBB-së. Në vitin 2013 është 30%, pra, me një ulje të barrës tatimore prej 0.3 pike % (Gjokutaj E. fq.8).

Pra, ekziston dallim i madh në mes të mesatares së BE-së dhe Kosovës në lidhje me nivelin e këtij treguesi. Niveli i barrës tatimore në Kosovë është i ulët, ndër më të ulëtat në rajon. Shpjegimi është se mbledhja e taksave në Kosovë është e ulët edhe pse, barra (normat) e taksave është e ulët. Gjithashtu, evazoni fiskal është shumë i lartë, tatimpaguesit kanë tendencë të fshehin tatimin dhe mos të paguajnë tatimin në mënyrë që të mos zvogëlojnë fitimet e tyre.

Edhe pse tek taksat indirekte (Tvsh-ja) mundësia për evasion thuhet se është e vogël për shkak se shumica e tij vjelet në kufi, prapë se prapë mundësia për evasion në TVSH është evidente do të thotë, edhe pse tatimi mbi TVSH-në është një taks indirekte dhe barra e tij bie mbi konsumatorin e fundit prapë se prapë tatimpaguesit janë të prirur për të fshehur atë përmes lëshimit të faturave fiktive.

Problemet që shkaktojnë këto dukuri dhe zgjidhja e këtyre problemeve ka rëndësi të madhe në aspektin ekonomik dhe social të vendit. Në përgjithësi këto dukuri zvogëlojnë rritjen ekonomike sepse shmangia nga taksat zvogëlon aftësinë e qeverisë për të ofruar të mira shoqërore për qytetarët e me këtë duke gjeneruar pa barazi në mes të atyre që bëjnë evasion dhe atyre që paguajn taksa, në këtë mënyrë duke kontribuar në krijimin e motivit për involvim në evazion edhe të bizneseve të tjera, e në shumë raste edhe nëndeklarimin e pagave të puntorëve. Nga frika se do të mbesin pa punë, të punësuarit pranojnë të punojnë ilegalisht e në disa raste edhe me vullnetin e tyre, në shumë raste paga e tyre është minimale dhe orari i punës është i tej zgjatur për shkak të luftës për mbijetesë. Përpos efekteve negative që shkakton punësimi joformal në zhvillimin ekonomik për shkak të

shmangjes nga tatimi në paga dhe kontributeve pensionale kjo kategori e të punësuarve përpos që në të ardhmën nuk kanë benefite nga pensionet dhe sigurimet shëndetësore, në fakt në periudha afatgjata do të ngritin koston sociale për shtetin (Institute Riinvest, 2013). Informaliteti i fuqisë punëtore në Kosovë sipas një studimi empirik të bërë në vitin 2013 nga Instituti Riinvest në Kosovë, rezultatet tregojnë se mesatarisht 37 % e fuqisë punëtore të punësuar nuk është ligjërisht e deklaruar.

Bazuar në të dhënat (anketat e bëra me biznese) e Institutit Riinvest në Kosovë del se barrierat më të mëdha në të bërit biznes në Kosovë janë: evazoni fiskal dhe informaliteti që rënditet në vendin e parë ndërsa barriera e dytë me e madhe në të bërit biznes është korrupcioni dhe duke krahasuar të dhënat e vitit 2013 me vitin 2011 del se ndikimi i tyre është rritur ndjeshëm në krahasim me vitin 2011, (Riinvest 2013: 5-16).

Sipas raportit të UNDP (2014), përceptimet e qytetarëve sa i përket korrupsionit në Administratën Tatimore të Kosovës, sipas këtij raporti janë se në prill të vitit 2013 korrupsioni ishte 42.5 % ndërsa në prill të vitit 2014 është 16.5%.

Lidhur me përcaktuesit e moralit tatimor të lartcekur sa i përket rastit të Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës ka bërë një sërë reformash duke u fokusuar në përmirësim të cilësisë së shërbimeve në pajtim me nevojat e konsumatorëve, transparencë dhe përmirësimin e procesit. Por, prapë shmangia e tatimit dhe evazoni tatimor në të ardhurat e biznesit në Kosovë konsiderohet të jetë i madh kur merren parasysh të dhënat (faktet) në terren të cilat sjellin tatim të padeklaruar poashtu edhe tatim shtesë me rastin e auditimeve (kontrolleve) që u bëhet këtyre bizneseve nga ana e zyrtarëve tatimor.

Bazuar në modelin Alingham – Sandmo, probabiliteti i kontrollit të bizneseve në Kosovë

është:

$$p = P / N = 1056 / 69864 = 1.5 \%$$

Siç tregon rezultati i mësipërm, bizneset në Kosovë kanë probabilitet shumë të ulët për t'u kontrolluar, nëse merret parasysh se probabiliteti tatimor duhet të merret si funksion i përbërë nga parametrat siç janë: saktësia e zbulimit, numri i mashtruesve dhe burimet në dispozicion (Anciute & Kropiene), atëherë me kapacitete të vogëla të inspektorëve të angazhuar (numri i tyre në vitin 2014 ishte 294), me numër të madh të atyre që shmangin taksat, evazoni tatimor është shumë vështirë të luftohet në Kosovë. Në shumicën e rasteve shmangja tatimore vërehet edhe në TVSH mirëpo, dallimi këtu qëndron se transaksionet e tyre janë me lehtë për t'u hetuar dhe përcaktuar tatimi i shmangur, pasi që niveli i pajtueshmërisë me taksat është shumë i ulët.

2.5 Përmbledhje e kapitullit

Në këtë kapitull është trajtuar shqyrtimi i literaturës ekzistuese në lidhje me temën që është objekt i zgjedhur në këtë studim. Shqyrtimi i literaturës fillimisht, përfshinë konceptet, parimet, karakteristikat, klasifikimin e sistemeve tatimore si dhe veqoritë e një sistemi tatimor optimal. Në këtë kapitull u pa se koncepte të shumta janë vënë nga autorë të ndryshëm për qëllimin e taksimit por, në përgjithësi qëllimi mbi vendosjen e tatimit nga ana e qeverive është për të gjeneruar burime financiare të nevojshme për kryerjen e shpenzimeve të domosdoshme për nevojat e sektorit publik. Gjithashtu u tregua se çdo sistem tatimor duhet të jetë i ndërtuar mbi parime të drejta, të sigurta, të përshtatshme dhe ku veprohet me përgjegjësi nga ana e administartorëve publik. Dhe fare në fund të këtij kapitulli është shqyrtuar edhe evazoni fiskal, ekonomia joformale, konceptet dhe faktorët shkaktues të tyre. Literatura mbi evazionin fiskal dhe ekonomin joformale thekson disa nga shkaktaret kryesor të këtyre dukurive si: normat e larta tatimore, korrupcioni i

zyrtarëve publik, papërgjegjshmëria e qeverisë, cilësia e ulët e shërbimeve publike, pastaj, mostransparenca në shpërndarje, papunësia dhe pagat e ulëta, procedurat e komplikuar, ligjet e paqarta dhe të komplikuar , trajtimi i pabarabartë i tatimpaguesve e shumë faktor të tjerë të cilët kanë shërbyer si piknisje për hartimin e pyetsorit me qëllim të identifikimit të faktorëve që shkaktojnë evazion tatimor dhe ekonomi joformale në Kosovë.

Kapitulli III: Analizë e sistemit tatimor në Kosovë, dhe krahasueshmëria me vendet e Rajonit dhe BE-së

3.1 Vështrim i përgjithshëm mbi historikun e sistemit tatimor të pasluftës në Kosovë

Sistemi tatimor i Kosovës është sistem i ri, i krijuar që nga fillimi bazuar kryesisht në përvojën e vendeve të zhvilluara përendimore. Megjithatë, për nga specifikatë dhe veçoritë e strukturës ekonomike dhe sociale të vendit, politika tatimore dhe rregullat për administrimin e tyre kanë qenë në ndryshim të vazhdueshëm. Ndër këto specifika mund të veqohen: kultura tepër e ulët e pagimit të taksave, shkalla e lartë e informalitetit dhe evazionit fiskal si dhe korrupsionit në ekonomi. Përgjatë këtyre viteve të tranzicionit ekonomik, shpesh mos përputhja e politikës së taksave me këto specifika, si dhe mangësitë në administrim kanë krijuar baza të ngushta tatimore dhe sisteme taksash jo edhe të lehta për t'u kuptuar dhe administruar. Ky fakt ka ndikuar gjithashtu, në deformimin e vendimeve të binzesit për investime dhe në realizimin me vështirësi të aktivitetit të tyre. Në këtë kontest reformimi i sistemit tatimor ka qenë i vazhdueshëm dhe intensiv në vitet e fundit duke konsideruar si objektiv kryesor të politikës së taksave mbledhjen e të ardhurave për financimin e buxhetit të shtetit, nxitjen e investimeve, punësimit dhe formalizimin e ekonomisë.

Pas përfundimit të luftës, në vitin 1999 në Kosovë fillon një epokë e re në aspektin politike, social dhe ekonomik, si dhe në ndërtimin e sistemit të taksave në përgjithësi. Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) u themelua me 17 janar 2000 nën drejtimin dhe administrimin e UNMIK-ut ¹, bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/16, të datës 6 nëntor 1999, Mbi Themelimin e Organit Qendror Fiskal dhe çështje tjera të lidhura me të.

¹ Misioni I Kombeve të Bashkuara, në Kosovë

Nga muaji shkurt i vitit 2003, kompetencat e udhëheqjes barten nga UNMIK-u, tek Ministria për Ekonomi dhe Financa, dhe që nga ajo kohë ATK funksionon si agjenci ekzekutive e menaxhuar tërësisht nga vendoret. Pra, nga viti 1999 deri në vitin 2003, UNMIK-u ishte krijuesi i sistemit dhe politikës tatimore, ku ndërhyrjet e taksave janë të bazuara kryesisht në përvojat e vendeve të tjera dhe jo në përputhje me nevojat reale që kishte Kosova menjëherë pas luftës. Duke filluar nga viti 2004, sistemi tatimor në Kosovë, ka evoluar nga sistem i përbërë nga rregulloret e UNMIK-ut, në sistem të ligjeve tatimore të nxjerra nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mënyrë që të bëjë të mundur fillimin e zbatimit të reformave, të cilat konsiderohen se i plotësojnë standardet ndërkombëtare dhe parimet e BE-së, në Shtator të vitit 2011 u hartua Strategjia e Përmbushjes 2012-2015 për ATK-në me synim të implementimit në kontest të rritjes ekonomike dhe ndikim pozitiv në mbledhjen e të hyrave tatimore. Objektivi i strategjisë është krijimi i një mjedisi të përmbushjes ku procedurat e lehtë administrative, udhëzimi sistematik i tatimpaguesve dhe një sërë shtytas tjera bëjnë që tatimpaguesit t'i përmbushin obligimet e tyre në mënyrë vullnetare. ATK, sipas strategjisë do të fokusohet në zgjerimin e bazës tatimore, përmes rritjes së kapaciteteve teknike dhe shtimit të informatave në dispozicion të ATK-së të cilat do të sigurojnë se tatimpaguesit janë duke deklaruar detyrimet e tyre tatimore në mënyrë të duhur, drejt zvogëlimit të hendekut tatimor, i cili paraqet diferencë në mes të të hyrave të mundshme dhe të hyrave të mbledhura, (ATK, Strategjia e Përmbushjes 2012-2015, Shtator 2011: 8).

Ashtu si në të gjitha vendet moderne edhe në Kosovë, sistemin tatimor e përbëjnë lloje të ndryshme të tatimeve, kontributeve dhe të instrumente të tjera fiskale qeverisur nga ligjet tatimore. Respektimi i ligjeve e tatimore është përgjegjësi thelbësore e çdo qytetari. Siç

citon Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 119, “ Secili person është i obliguar të paguaj tatimet dhe kontributet e tjera të parapara me ligj”. Në një vend modern që Kosova synon të jetë, nga qytetarët kërkohet pagesa e taksave dhe detyrimeve të tjera që financojnë programet qytetare, për shpërndarjen e shërbimeve publike dhe standard të lartë të arsimit, mirëqenies, shëndetit, mbështetjes sociale, mbrojtjes, zbatimit të ligjit dhe të infrastrukturës së përgjithshme. Të gjitha këto bëhen të mundshme vetëm me mbledhjen e duhur të tatimeve. Gjithashtu, siç citohet në nenin 120 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës “ Mbledhja e të hyrave publike dhe shpenzimet publike duhet të bazohen në parimet e llogaridhënjës, efektshmërisë, efikasitetit dhe transparences”, (Kushtetuta e Republikës së Kosovës: f.43).

Fillimisht, nga themelimi i saj ATK, në janar të vitit 2000, bazuar në rregulloren e UNMIK-ut 2000/3 ka filluar me zbatimin e *Tatimit mbi Shitjen*. Ky lloj tatimi është vendosur për mallrat e importuara apo të prodhuara në Kosovë me normë tatimore prej 15% dhe është aplikuar deri në korrik 2001 kur u zëvendësua me Tatimin e Vlerës së Shtuar.

Në shkurt të vitit 2000 u vendosë Tatimi në Hotele dhe Restorante (THR), bazuar në rregullorën 2000/5, ndërsa në korrik 2000 u vendos Tatimi i Paragjykuar (TP) me të cilin janë tatimuar të gjitha llojet e tjera të të ardhurave të biznesit të vendosura bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/29, datë 20 Maj 2000. Tatimpaguesit e vegjël me të ardhura bruto tremujore deri në 15.000.00 DM (7500.00 €) paguanin taksën paushalle (kuotën fikse) tremujore varësishtë nga lloji dhe vendi i veprimtarisë ndërsa, tatimpaguesit e mëdhenjë paguanin taksën fikse, gjithashtu sipas llojit dhe vendit të veprimtarisë ekonomike plus 3% të të ardhurave bruto mbi shumën 15.000 DM. Kjo nuk vlente edhe

për kompanitë e sigurimeve të cilat paguanin 10% të mbivlerës nominale bruto,(Rregullorja-UNMIK-ut 2000/29, 2000: 3-7).

Në korrik të vitit 2001, në Kosovë filloi aplikimi i *Tatimit mbi Vlerën e Shtuar* (TVSH) i cili zëvendësoi TSH, TSHHR si dhe TP për të ardhurat vjetore mbi kuotën 200,000 DM (100,000 €) ndërsa, TP ka vazhduar të operojë dhe të zëvendësoj TSHHR dhe të gjitha llojet tjera të të ardhurave që përfshinë të ardhurat nën kuotën e cekur më lart. Ky lloj tatimi u vendos bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/11, të datës 31 maj 2001.

Në prill të vitit 2002, ka filluar së zbatuari *Tatimi i Mbajtur në Burim mbi Pagat*. TMB u vendos bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/04, të datës 20 shkurt 2002 e cila filloi se zbatuari me 1 prill 2002.

Tatimi në fitim u vendos me rregulloren e UNMIK-ut 2002/03, datë 20 shkurt 2002, për të gjitha bizneset me qarkullim mbi 100.000€, në normë 20%. Tatimi në të ardhurat në Korporata e ka zanafillën nga Rregullorja e UNMIKut nr. 2004/51, dhjetor 2004. Ndërsa, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/35 e datës 22 dhjetor 2001 vuri bazat mbi Pensionet në Kosovë dhe filloi se zbatuari me 1 gusht 2002, fillimisht për të punsuarit në sektorin publik ndërsa, një vit me vonë edhe për të punsuarit në sektorin privat.

Nga janari 2005 u bë një reformë tatimore, duke zëvendësuar Tatimin e Paragjykuar, Tatimin në Paga dhe Tatimi në Fitim me dy lloje të reja të tatimeve si: Tatimi në të Ardhurat Personale (TAP), i cili tatimon personat fizik (individët që përfitojnë një pagë dhe bizneset individuale) dhe Tatimi në të Ardhura të Korporatave që vlenë për personat juridik, (ATK, Strategjia e Përmbushjes 2012-2015, shtator, 2011: 8).

3.1.1 Kuadri Ligjor

Sistemi tatimor i Kosovës në kuadër të tij përbën një pako ligjesh dhe udhëzimesh administrative tatimore, të nxjerra nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Kuvendi i Kosovës për herë të parë prej themelimit të tij (pas luftës 1998/1999) me 27 shtator 2004, me qëllim të vendosjes se një grupi gjithëpërfshirës të rregullave dhe procedurave për administrimin e tatimeve dhe kontributeve, miraton: Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 2004/48 i cili zëvendësoi rregullat e vendosura nga ndërkombtarët në Kosovë, (Rregullorën e Unmikut Nr. 2000/20 të datës 12 prill 2000) e cila ka vendosur rregullat dhe procedurat për administrimin e tatimeve në Kosovë. Ky Ligj ka hyrë në fuqi me 1 maj 2005 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 03/L- 071 të datës 04 dhjetor 2008. (ATK, 2010, fq. 11, Legjislacioni Tatimor i Kosovës). Ndërsa, tani rregullat dhe procedurat bazë për administrimin e tatimeve në Kosovë janë të përcaktuara me Ligjin 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat të datës 12 korrik 2010 (ATK, 2011, Legjislacioni Tatimor i Kosovës), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-102 të datës 15 qershor 2012, dhe së fundmi i ndryshuar me Ligjin 04/L-223, datë 13 janar 2014.

Legjislacioni bazë aktual në fushën e tatimeve në Republikën e Kosovës

Legjislacioni tatimor i Kosovës përpos Ligjit dhe Udhëzimeve Administrative për Administratën Tatimore dhe Procedurat, për administrimin e tatimeve në Kosovë, është i përbërë edhe nga një pako ligjesh dhe udhëzimesh administrative të cilat përmbajnë informacion rreth: Tatimit në të Ardhura të Korporatave; Tatimit në të Ardhurat Përsonele; Tatimit mbi Vlerën e Shtuar dhe Kontributeve Pensionale. Këto lloje të tatimeve zbatohen për bizneset, varësisht nga lloji i entitetit të biznesit, statusit të tij dhe qarkullimit vjetor gjithashtu, zbatohen edhe për personat fizik që realizojnë të ardhura si nga paga apo formë

tjetër të ardhurash nga sektori publik dhe ai privat. Pra, sistemi tatimor i Kosovës është i përbërë nga *tatimet direkte* që përfshinë: Tatimin në Korporata (TAK), Tatimi mbi Fitimin, Tatimin në të Ardhurat Përsonele (TAP), Tatimin në Lojërat e Fatit dhe Kontributet Pensionale (KP) si dhe *tatimet indirekte* që përfshinë: Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), Doganat dhe Akcizat.

Tatimi në të ardhurat e Korporatave

Në mbështetje të nenit 65(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës, me 18 dhjetor 2008 miratoi ligjin Nr. 03/L-113 për Tatimin në të ardhurat e Korporatave, i cili hyri në fuqi me 1 janar të vitit 2009, i ndryshuar me ligjin Nr. 03/L-162, i miratuar me 29 dhjetor 2009 dhe efektet e këtij ligji ishin nga hyrja e tij në fuqi në janar 2010, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-103, datë 15.06 2012. TAK aplikohet në të ardhurat e tatueshme të Korporatave, tatimpaguesit me të ardhura vjetore bruto me pak se 50,000 € tatohen në masen 3% të të ardhurave bruto nga tregtia për tremujor, ndërsa 9 % të të ardhurave bruto për tremujor nga shërbimet, por jo me pak se 37.50 € për tremujor. Tatimpaguesit më të ardhura bruto vjetore mbi 50,000 €, nga 1 janar 2009 tatimohen në normën 10 % në të ardhurat e tatueshme, përderisa që nga janari 2005 norma e tatimit ishte 20% e të ardhurave të tatueshme. Të ardhurat e tatueshme për një periudhë tatimore nënkupton ndryshimin në mes të të ardhurave bruto të realizuara gjatë një periudhë tatimore dhe zbritjeve të lejueshme në lidhje me të ardhurat bruto të tilla. Periudhë tatimore për TAK është viti kalendarik. Mirëpo, edhe tatimpaguesit e kësaj kategorie me qarkullim me të vogël se 50,000 € mund të zgjedhin vullnetarisht të jenë objekt i tatimit të korporatave. Tatimpagues në bazë të Ligjit për Tatimin në të Ardhura të Korporatave, janë: një korporatë apo ndërmarrje tjetër që mbanë statusin e personit juridik

sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë; një ndërmarrje që vepron me pasuri në pronë shoqerore ose publike; çdo organizatë e regjistruar si organizatë joqeveritare është e obliguar të paraqesë pasqyrat vjetore për këtë lloji tatimi; një person jorezident me njësi të përhershme në Kosovë, i nënshtrohet këtij lloji tatimi vetëm në të ardhurat që i atribuohen aktivitetit ekonomik të ushtruar në Kosovë.

Kompanitë e sigurimit që bëjnë sigurimin e jetës, pronës e rrisqeve tjera paguajnë 5% tatim në primet bruto të periudhës tatimore në vend të tatimit në të ardhura të Korporatave.

Tatimi në të Ardhura Personale (TAP)

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me 18 dhjetor 2008 miratoi Ligjin Nr. 03/L-115 për TAP, që hyri në fuqi me 1 janar 2009, i ndryshuar me Ligjin 03/L-161, që hyri në fuqi nga janari 2010, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-104, të datës 15 qershor 2012. Tatimpaguesit që i nënshtrohen këtij ligji janë personat fizik rezident dhe jorezident, ndërmarrjet personale afariste, ortakët, të cilët pranojnë apo krijojnë të ardhura bruto nga çfarëdo burimi, duke përfshirë pagën, veprimtarinë afariste, qiranë, fitorët në lotari, interesat, dividendët, fitimet kapitale (pas 1 janarit 2010), shfrytëzimin e pasurisë së paprekshme, pensionet, si dhe çdo e ardhurë tjetër që rritë vlerën neto të tatimpaguesit. Periudha e tatueshme për TAP është viti kalendarik. Objekt i tatimit për personin rezident janë të ardhurat e krijuara në Kosovë dhe ato të krijuara nga një burim i huaj të ardhurash, ndërsa objekt i tatimit për tatimpaguesin jorezident janë të ardhurat e krijuara nga një burim në Kosovë. Tatimpaguesit me të ardhura bruto vjetore nga veprimtaritë afariste deri në 50,000€ prej të cilëve nuk kërkohet dhe që nuk zgjedhin t'i mbajnë librat dhe regjistrimet e tyre sipas Standardeve të Kontabilitetit të Kosovës (i cili është i harmonizuar me standardet ndërkombëtare të Kontabilitetit) duhet të paguajnë: 3% të të ardhurave të tyre bruto për

tremujor për të ardhurat e krijuara nga tregtia, transporti, bujqësia, si dhe aktivitete tjera afariste të ngjashme por jo me pak se 37.50 € për tremujor, ndërsa 9 % të të ardhurave bruto për tremujor duhet të paguajnë për të ardhurat e krijuara nga shërbimet, veprimtaritë profesionale, të zanatit, të argëtimit dhe të ngjashme, por pagesa duhet të jetë jo me pak se 37.50 € për tremujor. Ndërsa, tatimpaguesit me të ardhura vjetore mbi 50,000 € që janë objekt i tatuarjes në të ardhura personale paguajnë tatimin në TAP sipas shkallëve tatimore progresive 0,4, 8 dhe 10 % varësisht nga niveli i fitimit (pasiqë nga të ardhurat e tyre bruto të jenë zbritur shpenzimet e lejueshme). Të ardhurat nga paga, gjithashtu janë objekt i tatimit në të ardhura personale dhe janë të tatueshme poashtu sipas shkallëve tatimore : 0, 4, 8 dhe 10 % varësisht nga niveli i pagës. Secili punëdhënës është përgjegjës të mbajë në burim të ardhurat nga paga për të punsuarit çdo muaj dhe të paguaj deri me datë 15 të muajit vijues dhe atë: për të punsuarit që realizojnë pagë vetem nga një punëdhënëse sipas shkallëve tatimore të lartcekura, pasi nga paga bruto të zbritet shuma prej 5% e cila shkon për pagesë të kontributeve pensionale. Ndërsa, për të punsuarit që kanë edhe një pagë të dytë, atëherë punëdhënësi është i obliguar të llogarisë për të mbajtur në burim 10% të shumës totale të asaj page (pas zbritjs 5% për pagesë të KP).

Paguesit e interesit, dividendës, honorarit, lotarisë dhe lojrave të fatit janë të detyruar të mbajnë në burim dhe të paguajnë në periudha tremujore 10% mbi pagesën e këtyre burimeve të të ardhurave. Qiradhënsit gjithashtu, janë të obliguar të paguajnë 9% e të ardhurave të krijuara nga qeraja.

Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH)

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me 18 dhjetor 2008 miratoi Ligjin Nr. 03/L-114 për TVSh, i cili hyri në fuqi me 1 janar 2009, i ndryshuar me Ligjin 03/L-146 , datë 29 dhjetor

2009 dhe efektet e këtij ligji do të jenë me hyrjen e tij në fuqi nga janari 2010, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 03/L-197, të datës 15.04. 2010, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L- 108, datë 15.06.2012. Norma standarde e TVSH-së që nga hyrja në fuqi me 1 korrik 2001 e deri në fund të vitit 2009 ishte 15% ndërsa, që nga janari 2010 është 16% e vlerës së furnizimeve të importuara dhe furnizimeve të brendëshme të tatueshme me përjashtim të atyre të liruara dhe atyre të trajtuara si eksporte. Eksportet janë të tatueshme me normën 0 %. Bizneset me qarkullim mbi 50,000€ në 12 muajt e fundit janë të detyruar të regjistrohen për TVSH. Bizneset me qarkullim nën këtë shumë mund të regjistrohen për TVSH. Bizneset me qarkullim nën 50,000 € në 12 muajt e fundit të cilët importojnë ose eksportojnë, duhet të regjistrohen për TVSH si importues ose eksportues, mirëpo nuk kërkohet nga ta të deklarojnë për TVSH. Për prodhuesit të cilët importojnë asete kapitale pagesa e TVSH-së mund të vonohet për gjashtë muaj, ndërsa për bizneset që importojnë asete bujqësore TVSH është e rimbursueshme. Në përputhje me parimet e BE-së dhe të TVSH-së, eksportet tatohen me normë 0 %. TVSH-ja në importe mblidhet në kufijtë shtetror të Kosovës. Bartësi i transaksionit paguan TVSH-në në bazë të vlerës doganore dhe në çdo tatim tjetër të importit (taksa doganore dhe akciza, nëse janë të aplikueshme) pavarësisht origjinës së tyre.

Kontributet pensionale

Baza ligjore për mbajtjen në burim dhe pagesën e kontributeve pensionale në Kosovë qëndron në Ligjin 03/L-084 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës me datë 04 dhjetor 2008 – për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/20, për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2001/35, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-101, datë 15 maj 2012 – për Fondet Pensionale në Kosovë. ATK është agjension i autorizuar i Trustit të Kursimeve

Pensionale të Kosovës (TKPK) për mbledhjen e Kontributeve Pensionale, përderisa ato menaxhohen dhe shpërndahen nga TKPK dhe nuk bëjnë pjesë në të ardhurat e buxhetit të Kosovës. Skema pensionale në Kosovë është e organizuar në atë mënyrë që llogaritë e pensioneve janë individuale pra, secili i punsuar kur të pensionohet merr shumën e pensionit të cilën e ka akumuluar (paguar) për vetvetën, plusë një normë rritëse apo edhe rënëse nga kthimi i investimit të mjeteve. Mjetet e mbledhura nga kontributet pensionale, pjesa më e madhe e tyre janë të investuara në institucione financiare jashtë vendit.

Norma e obligueshme për llogaritjen dhe pagesën e kontributit pensional (për të punsuarit) është 5% e pagës bruto të të punsuarit, të cilën punëdhënësi obligohet të mbajë në burim dhe të zbres nga paga e të punsuarit, ndërsa punëdhënësi obligohet që edhe një shumë tjetër të njëjtë prej 5% të paguaj në emër të të punsuarit, duke mos u kufizuar deri në 30% të pagës bruto e cila mund të paguhet në mënyrë vullnetare si nga ana e të punsuarit ashtu edhe nga punëdhënësi. KP, përpos të punsuarve me pagë, janë pagesa të detyrueshme edhe për të gjithë personat fizik (të vetpunsuarit), pronar të bizneseve të vogla dhe të mëdha individuale. Shuma obligative për të vetpunsuarit, deri më 1 korrik 2012 ka qenë 1/3 e shumës së detyrimit tatimor tremujor nga të ardhurat e biznesit, por jo më pak se 23.40 € pagesë tremujore. Ndërsa, për personat, pronar të bizneseve të mëdha individuale shuma obligative për pagesë të KP deri në periudhën në fjalë (korrik 2012) ka qenë 10 % e shumës së detyrimit tatimor tremujor në të ardhurat e biznesit, por jo më pak se 23.40 € çdo tremuj dhe jo më shumë se 600 € për tremujor. Duke filluar nga 1 korrik 2012 e tutje, shuma obligative për pagesë të KP lindë varësisht nga mosha e të vetpunsuarit dhe madhësia e biznesit individual. Personat që janë pronar (të vetpunesuar) të bizneseve të vogla individuale dhe që kanë moshën nën 35 vjeqe paguajnë 1/3 e detyrimit tatimor

tremujor nga të ardhurat e biznesit, por jo me pak se 39.00 € pagesë tremujore. Ndërsa, personat e vetpunsuar, mbi moshën 35 vjeqe paguajnë 1/3 e detyrimit tatimor tremujor nga të ardhurat e biznesit, por jo më pak se 51.00 € pagesë tremujore për KP. Për pronarët e bizneseve të mëdha individuale nën moshën 35 vjeqe shuma obligative për pagesë të KP është 10 % e shumës së detyrimit tatimor tremujor nga të ardhurat e biznesit, por jo me pak se 39.00 € dhe jo më shumë se 600 € për tremujor, ndërsa për ata mbi 35 vjeqe shuma obligative për pagesë të KP është 10 % e shumës së detyrimit tatimor tremujor nga të ardhurat e biznesit, por jo me pak se 51.00 € çdo tremuaj dhe jo me shumë se 600 € për tremujor. Pronarët aksionar të kompanive nuk obligohen të paguajnë KP, por vetëm nëse zgjedhin vullnetarisht.

Lojërat e fatit

Baza ligjore për tatimin në lojrat e fatit është vendosur me Rregullorën Nr.2004/35, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/ L- 080, në prill 2012.

3.1.2 Kuadri institucional

Kuadri institucional është i përbërë nga rregullat të cilat promovojnë modele të kordinuara të jetës sonë ekonomike brenda të cilit njëzë kryejnë aktivitetet e tyre. Pothuajse, të gjitha shkollat e mendimit përcaktojnë se qeveria luan një rol të rëndësishëm në mbajtjen dhe ruajtjen e këtij kuadri institucional, për gjëra të tilla si ushtarake , policore, gjykata si instrumente për ruajtjen dhe mbajtjen e këtij kuadri institucional, por qeveritë moderne bëjnë shumë më tepër se kaq, ato përmes operacioneve të tyre buxhetore ofrojnë një koleksion të gjërë të shërbimeve, përfshirë shkolla, infrastrukturë rrugore, pensione për të moshuarit, sigurime mjeksore, (Richard E. Wagner, fq. 1).

Përgjegjësi e Administratës Tatimore, si Agjension Ekzekutiv me Autonomi të plotë, është që të administroj zbatueshmërinë e çdo lloji të tatimit të aplikuar me legjislacionin tatimor në Republikën e Kosovës. Pra, misioni i ATK-së është zhvillimi në nivelin më të lartë të përmbushjes vullnetare në përputhje me ligjet dhe udhëzimet në fuqi e gjithashtu, edhe dhënja e shërbimeve profesionale, transparente dhe efektive dhe zbatim të njëtrajtshëm të dispozitave ligjore për të gjithë tatimpaguesit në mënyrë të njëjtë për situata të njëjta (Legjislacioni Tatimor i Kosovës. 2010, fq. 7).

Sa i përket strukturës organizative, ATK përbëhet nga Zyra Qendrore dhe nëntë Zyra tjera Rajonale: tri në Prishtinë, dhe nga një në: Mitrovicë, Ferizaj, Gjilan, Pejë, Prizren e Gjakovë. Zyra qendrore përbëhet nga Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm, Zyra Ligjore, Drejtoria për Modernizim, Planifikim dhe Analizë, Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve dhe Drejtoria për Teknologji Informative. Ndërsa, secila zyre rajonale është e udhëhequr nga një menaxher dhe zëvendës-menaxher regional dhe në kuadër të saj, secila zyre rajonale ka Zyrën e Shërbimit të Tatimpaguesve, Zyrën e Përmbushjes (që përfshinë Inspektorët Tatimor të kontrollit dhe të mbledhjes së detyrueshme që udhëhiqen në grupe, nga një udhëheqës për çdo ekip) dhe Zyrën e Teknologjisë Informative. ATK ka aktualisht gjithsej 756 të punësuar. Sa i përket TI-së, ATK ka zhvilluar nënsisteme të brendshme, të cilat janë të ndërlidhura me sistemet e institucioneve të tjera si të Bankës Qendrore, Thesarit, Doganës së Kosovës etj. Përveq kësaj në Bashkpunim me MTI (Zyrën e Regjistrimit të Bizneseve), përmes qendrës ” One Stop-Shop” që tashmë është funksionale pranë çdo qendre komunale, mundësohet regjistrimi i tatimpaguesve dhe paisja e tyre me numër fiskal brenda ditës, si dhe ka zhvilluar Modulin për Menaxhim të Riskut i cili tashmë është funksional.

Prioritetet e ATK -së që nga viti 2011 kanë qënë:

- Hartimi i strategjisë së përmbushjës 2012-2015 dhe Planit gjithpërfshirës për trajtimin e riskut për menaxhimin e përmbushjes, me planet operative të ATK, por mendoj se është vështirë për t'u arritur nivel i lartë i menaxhimit të këtyre rrisqeve për shkak të numrit të madh të tyre në njerën anë edhe numër të vogël të inspektorëve tatimor të angazhuar;
- Vazhdimi i realizimit të projektit të arkave fiskale me synim të luftimit të evazionit fiskal dhe ekonomisë joformale - projekt që filloi me 2010 por që akoma (viti 2014) nuk ka përfunduar sipas planit;
- Përsheptimi i procedurave për lëshimin e numrave fiskal në ditën e aplikimit-detyrë që është kryer me sukses nga qendrat tatimore të ATK- së dhe ka ndihmuar në identifikimin e tatimpaguesve që shkaktojnë evazion fiskal duke ju pamundësuar atyre regjistrim të biznesit të ri pasi që grumbullonin tatime të papaguara nga biznesi paraprak, mirëpo që nga viti i kaluar ky projekt ka kaluar për implimentim në zyrat regjionale të regjistrimit të bizneseve me njësi pranë çdo Komune në Kosovë;
- Fillimi i punës së qendrës së thirrjeve për tatimpaguesit që kanë detyrime tatimore - si rezultat i punës së saj janë mbledhur të hyra shtesë prej 2 milion € vetëm në vitin 2012;
- Funksionalizimi i Njesisë për Hetime Tatimore – që është funksionale; zhvillimi i sistemit për përpunimin e të dhënave - që është zhvilluar në masë të madhe;
- Lansimi i projektit të E- deklarimit- projekt që ka nisur zbatimin në vitin 2010 fillimisht për deklarimin e TVSH-së, pastaj TMB dhe kontributet pensionale nga 1 korriku 2012, ndërsa, që nga 1 korrik 2014 do të jetë obligativ për të gjitha llojet e

tatimeve që sipas mendimit tim është një hap i gabueshëm nga ATK, për shkakun se sistemi i E-deklarimit nuk është i thjeshtë për t'u përdorur dhe kjo shkakton neglizhencë në deklarimin e tatimeve, (posaqërishtë tatimit të mbajtur në burim dhe kontributeve pensionale nga paga e të punësuarve) dhe kosto për tatimpaguesit kur dihet shkalla e arsimimit të tyre e poashtu, edhe niveli i ulët i të ardhurave për disa biznese të vogla;

- Paraqitja e blerjeve në ATK nga tatimpaguesit për blerjet që tejkalojnë shumën prej 500 € nga i njëjti tatimpagues. Pra, siq shifet, ATK ka të zhvilluar strategji dhe plane veprimi si dhe ka të identifikuar prioritetet të cilat do të sillnin tek realizimi me i madh i të hyrave tatimore mirëpo, prapë se prapë mbledhja e të hyrave nuk është në nivelin e kënaqshëm, duke u nisur që nga numri i vogël i inspektorëve tatimor, pagat e ulëta të tyre, korrupsioni në mesin e tyre dhe zyrtarëve tjerë qeveritar, evazioni fiskal, pra mosgatishmëria e tatimpaguesve për të paguar taksat qoftë si arsye e mos kulturës së tyre për pagesë të taksave apo edhe arsye tjera të shumëta që i shtyen ata ti shmangin taksat.

Nisur nga problemet e lartcekura një dokument i OECD-së (Principles of Good Tax Administration, September, 2001) ka paraqitur një sërë pikëpamje mbi parimet e Menaxhimit Strategjik për një administrim të mirë tatimor. Siç tregohet aty roli kryesor i autoriteteve tatimore është për të siguruar efektivitet në përputhje me ligjet tatimore i cili varet nga shumë faktor të jashtëm si gjendja e ekonomisë, mbështetja publike për prioritetet e qeverisë dhe gatishmëria e tatimpaguesve në përputhje me rregullat e taksave. Autoritetet e taksave duhet të përmirësojnë imazhin e tyre publik dhe organizimin e proceseve të punës, në mënyrë që të rrisë shkallën e pajtueshmërisë vullnetare për pagesë të taksave.

Autoritetet tatimore duhet të kenë punonjës të rekrutuar në bazë të meritave dhe mundësive të barabarta për punë; të trajnuar, të kualifikuar, të përkushtuar dhe me vlerë të lartë etike të cilët do të jenë në gjendje të veprojnë në mënyrë të drejtë dhe në mënyrë profesionale në të gjitha mardhënjet e tyre me tatimpaguesit. Pajtueshmëria vullnetare e tatimpaguesve për të paguar taksat rritet jo vetëm nga pritjet e tyre për një trajtim të drejtë dhe efikas por edhe nga sisteme tatimore të qarta, procedura administrative të thjeshta dhe miqësore. Kur kjo pajtueshmëri nuk është arritur në baza vullnetare, autoritetet e të ardhurave duhet të identifikojnë dhe adresojnë rrisqet që lidhen me mospërputhje me zhvillimin e strategjive për shënjestrim të atyre rrisqeve. Një autoritet i mirë konsultohet me tatimpaguesit dhe palët e tjera për ndryshimet në zhvillimin e politikave dhe procedurave të rëndësishme, ai duhet të aplikojë ligjet tatimore në mënyrë të drejtë, të besueshme, bindëse dhe transparente (në përputhje me ligjet e brendshme tatimore dhe standardet ndërkombëtare). Informimi i tatimpaguesve duhet të përdoret vetëm në masën e lejuar me ligj, në mënyrë të saktë dhe me kohë në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre si dhe procedurat e ankesave dhe mekanizmave të dëmshpërblimit në dispozicion të tatimpaguesve.

3.1.3 Vlersimet ndërkombëtare

Sipas vlersimeve të ekspertëve ndërkombëtarë siç janë FMN-se dhe BB, ekonomia e Kosovës u rritë me një mesatare prej 4.3% në dekadën e fundit (2003-2012), për të vendosur Kosovën në krye të rajonit, por e pamjaftueshme për të gjeneruar përmirësime të kënaqshme në standardin e jetës. Rritja e popullsisë, 1.5% më e madhe në rajon, ndërsa për frymë PBB 2.8% më e ulët në rajon, edhe indeksi i çmimeve të konsumit, për 2.3% më e lartë në rajon (FMN,2013). Kjo tregon se pavarësisht se Kosova ka pasur rritje ekonomike dhe kriza e vitit 2008 nuk ka ndikuar në ekonominë e Kosovës, të hyrat e

Kosovës janë të vogla për frymë dhe se pavarësisht nga normat më të ulëta tatimore dhe reformimi e sistemit tatimor, Kosova nuk ka arritur sukses në mbledhjen e të ardhurave të mjaftueshme, si rezultat i pranisë së ekonomisë joformale dhe korrupsionit të zyrtarëve publikë. Iniciativat për të përmirësuar regjistrimin e biznesit dhe për të mbrojtur investitorët ndihmuar Kosovën që të rritet për 30 shkallë në raportin e Bankës Botërore, ku Kosova është renditur në vendin e 98 – të, (Banka Botërore, 2013).

3.2. Analizë e reformave në strukturë dhe norma tatimore në Kosovë, Rajon dhe BE


Siç u shtjellua edhe më parë, gjatë 10 vjeçarit të fundit janë ndërmarrë reforma të shumta në sistemin tatimor në Kosovë si në drejtim të reformave në strukturën tatimore, ashtu edhe në drejtim të ndryshimit të normave tatimore. Siç thuhej nga klasa politike, qëllimi i këtyre reformave ka qenë ndërtimi i një sistemi tatimor optimal, thithja e investimeve dhe zhvillimi ekonomik. Prandaj, ky kapitull ndër tjera ka si qëllim studimin dhe paraqitjen e reformave në strukturën dhe normat tatimore në Kosovë, duke filluar nga viti 2000 deri në vitin 2014 dhe analizimin e prirjes së tyre përgjatë viteve të fundit, në mënyrë që të konstatohet se sa efekt patën reformat e vazhdueshme në rritjen e bazës së tatueshme dhe rritjen ekonomike. Gjithashtu, në këtë kapitull paraqitet një analizë e përgjithshme e tatimeve të veqanta, sipas rëndësisë së tyre dhe peshës specifike që kanë në të ardhurat e përgjithshme tatimore dhe sipas peshës që zënë si përqindje në PBB. Në kuadër të këtij kapitulli do të realizohet edhe një analizë krahasuese e strukturës dhe normave tatimore të sistemit tatimor në Kosovës me vendet e rajonit dhe BE-së si dhe një analizë për efektet që patën reformat në ato vende pas krizës së vitit 2008.

Ecuria e të ardhurave tatimore (të brendëshme) dhe përbërja e tyre në vite

Ecuria e të ardhurave tatimore të brendëshme përgjatë viteve që nga themelimi i sistemit të ri tatimor të Kosovës në vitin 2000 e deri më tani ka treguar një performancë të dobët kur merret parasysh pjesëmarrja e tyre në raport me PBB-në dhe shumë tregues të tjerë. Me gjithë përmirsimët dhe reformat e vazhdueshme si në strukturë ashtu edhe në norma tatimore kjo gjendje mbetet e pandryshuar. Në anën tjetër, nëse merren parasysh të dhënat e Autoritetit Fiskal, raportet e tyre tregojnë se të ardhurat realizohen në masën 100 % e nganjëherë edhe tejkalohet plani i të hyrave tatimore, ndërkohë që niveli i evazionit tatimor është në nivel shumë të lartë. Kjo shpjegohet me faktin se menaxhimi dhe mbledhja e të ardhurave bëhet kundrejt planit të të ardhurave e jo kundrejt treguesve të tjerë domethënës siç janë numri i bizneseve të regjistruara , numri i atyre që nuk deklarojnë apo nuk paguajnë për qëllime tatimore. Në të shumtën e rasteve normat e larta tatimore kryesisht ato marxhinale dhe administrimi jo i mirë i taimeve janë element që ndikojnë në mbledhjen e të ardhurave. Mirëpo, në rastin e Kosovës nuk bëhet fjalë për norma të larta tatimore përfshirë edhe ato marxhinale, por kjo përbën riskun e fshehjes së dobësive në menaxhim kryesisht të operacioneve të Autoritetit tatimor.

Ecuria e të ardhurave tatimore të cilat mblidhen nga ATK, përgjatë viteve që nga themelimi i sistemit të ri tatimor të Kosovës do të paraqitet përmes grafikut në vijim:

Grafiku 1. Ecuria e të ardhurave tatimore 2000-2014 të mbledhura nga ATK, në mil.€



Burimi: Agjensioni i Statistikave të Kosovës; Administrata Tatimore e Kosovës

Ecuria e të ardhurave tatimore të mbledhura nga Administrata Tatimore e Kosovës siç tregohet në figurën e paraqitur më lartë në tre vitet e para të krijimit të sistemit të ri tatimor të Kosovës është rritur me ritme me të shpejta. Rritja në vitin 2001 ishte 700%, në vitin 2002 mbi 100 %, ndërsa në vitet në vijim kjo rritje sillet prej 15- 30% në vit, deri në vitin 2009 kur pati një rënje për 7.2% në mbledhjen e të hyrave, në krahasim me vitin paraprak ndërsa, nga viti 2009 e deri në vitin 2013 rritja vjetore e të hyrave nuk kaloi me tepër se 8%. Nëse, këtë ecuri të të ardhurave përgjatë viteve e përkthejmë në %, siç na tregojnë të dhënat e ATK-së vihet re se të ardhurat në përgjithësi realizohen në masën mbi 100%, ndërkohë që niveli i evazionit tatimor është relativisht i lartë. Si rezultat i kësaj analize vlenë të përcaktohet se çfarë sollën reformat në uljen e normave tatimore që u ndërmorën në fillim vitin 2009, që u bënë kinse me qëllim të rritjes së investimeve, zgjerimin e bazës tatimore dhe zhvillimin ekonomik, d.m.th, përkundrazi në fund të vitit 2009 pati rënje në realizimin e të hyrave, gjithashtu edhe në vitet vijuese rritja në realizimin e të hyrave nuk ishte më e lartë, krahasuar me vitet para ndërmarrjes së reformave. Vlenë të theksohet se

kjo ulje normash tatimore u bë për interesat personale të klasës politike dhe argatëve të tyre. Kjo shpjegohet me faktin se menaxhimi i të ardhurave është bërë kundrejt planit të të ardhurave e jo kundrejt treguesve tjerë domethënës si numri i të regjistruarve, numri i atyre që paguajnë etj., kur dihet se pjesmarrja e të ardhurave tatimore të mbledhura nga Administrata Tatimore në buxhetin e shtetit është tejet e ulët.

Tabela 3. Ecuria e të ardhurave të veqanta tatimore (2000-2013), ndaj totalit të të ardhurave të mbledhura nga ATK dhe Dogana, në %

Lloji i tatimit /Viti	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
THP	28.8	1.0	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
TP	71.2	67.1	42.2	-	12.0	5.1	0.01	0.00	0.00	0.01	0.00	0.00	0.00	0.00
TVSH(B)	-	31.9	37.8	-	41.0	35.6	28.6	30.9	27.4	41.6	42.9	46.5	45.8	48.8
TF	-	-	8.4	-	28.4	9.7	18.3	1.51	0.01	4.1	0.0	0.00	0.00	0.00
TMB(Paga)	-	-	11.6	-	18.6	18.5	17.4	18.4	18.7	18.5	20.0	21.3	21.2	20.3
TAP	-	-	-	-	-	9.38	9.0	9.58	8.7	10.0	11.5	9.0	9.1	9.29
Tjera*	-	-	-	-	-	-	6.8	5.36	6.3	7.2	1.7	1.3	1.7	0.55
TAK	-	-	-	-	-	21.7	19.9	34.3	38.9	18.6	24.6	21.9	22.2	21.06
Totali:ATK	100	100	100	-	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100
Taksa Doganore	27.3	19.7	-	-	16.9	17.2	28.2	26.9	27.3	24.3	25.3	24.8	14.3	14.4
Akciza	17.2	31.8	-	-	40.5	37.8	25.2	24.3	21.8	23.8	22.6	24.2	35.9	36.1
TVSH(Kufi)	-	32.3	-	-	42.6	45.0	46.6	47.9	50.5	51.6	51.7	50.7	49.7	49.3
Tjera**	55.5	16.2	-	-	-	-	0.00	0.9	0.4	0.3	0.4	0.3	0.1	0.2
Totali:Dogan	100	100	-	-	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100

Burimi: Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të siguruara nga:Instituti Riinvest; MF(Departamenti


Makroekonomik-Pasqyrat financiare); ASK, ATK.

*Tatimi mbi qiranë, interesin, dividendën dhe lojrat e fatit; ** Tatimi në shitje, shitja e mallrave të konfiskuara, banderollat, denimet doganore, Fast dogana.

Shënim: Në të hyrat nga ATK janë të llogaritura të hyrat e mbledhura bruto (pa kthimet) , ndërsa të hyrat doganore janë të llogaritura të hyrat neto d.m.th. pasiqë janë zbritur shumat nga kthimet. Për vitin 2003 nuk janë gjetur të dhëna për lloje të veqanta të tatimeve vendore, ndërsa për lloje të veqanta të të hyrave doganore nuk janë gjetur të dhëna për vitet 2002 dhe 2003

Siç shihet në tabelën e mësipërme janë paraqitur të ardhurat tatimore në % (ndërsa, vlerat në milion € - shih tabelën 1 në shtojcë të këtij punimi), të realizuara brenda vendit dhe ato doganore, të gjitha sipas llojeve të veqanta tatimore, pra pjesëmarrjes se tyre në totalin e të ardhurave tatimore të mbledhura nga ATK dhe Dogana e Kosovës. Siç tregohet edhe në tabelë ulja e normave tatimore në vitin 2009 ka rezultuar në zvoglim të të hyrave të brendëshme tatimore, në veqanti, ulja e normave të tatimit në korporata (TAK) nga 20 % në 10% ka shkaktuar zvoglim të të ardhura për këtë kategori për 57.14 % krahasuar me vitin paraprak, d.m.th. siq është prezentuar në tabelë të hyrat nga TAK në vitin 2008 ishin 82.6 milion, ndërsa në vitin 2009 të hyrat për këtë lloj tatimi janë 35.4 milion €, gjithashtu vërehët rënje edhe në tatimin e mbajtur në burim (TMB) në paga nga 41.6 milion sa ishte në vitin 2008 në 38.2 milion në vitin 2009, përderisa rritja e normës së TVSH-së për 1% ka rezultuar me rritjen e të hyrave nga 60.8 milion € në 85.8 milion në vitin 2009 d.m.th. të hyrat e kësaj kategorie të të ardhurave janë rritur për 29.13 % në krahasim me vitin paraprak.

Grafiku 2. Kategoritë e ndryshme e të ardhurave ngaj totalit të të ardhurave në Kosovë




Burimi: Përpunuar nga autori bazuar në të dhënat e siguruara nga: ATK, ASK, BQK

Shënim: Në të ardhurat tjera bëjnë pjesë të ardhurat tjera tatimore dhe jotatimore nga qeveria qendrore dhe lokale si Dividenda e PTK-së, Aeroportit, taksat koncensionale, tantiemat, tatimi në pronë, gjobat.

Siç tregohet në grafikun e mësipërm, të ardhurat e mbledhura nga dogana përbëjnë pjesë më të madhe të të ardhurave, duke filluar nga minimumi prej 54.93 % deri në maximum prej 80 % e të ardhurave totale. Të ardhurat e mbledhura nga ATK, përfaqësojnë nga 15.91 deri në 23 % e të ardhurave totale. Ndërsa, të ardhurat tjera bëjnë pjesë në të ardhurat totale me një minimum prej 3.44 % e deri në maksimum prej 28.09 %. Vlenë të theksohet se në vitin 2009 kur u zbatuan reforma në normat tatimore të ardhurat e brendëshme dhe ato nga dogana patën rënje të konsiderueshme përderisa shifet qartë se në këtë periudhë patën rritje të konsiderueshme të ardhurat tjera në krahasim me vitin paraprak.

Grafiku 3: Ecuria e kategorive të veqanta e të ardhurave të mbledhura nga ATK, në million €.




Burimi: Përpunuar dhe llogaritur nga autori bazuar në të dhënat nga: Agjensioni i Statistikave të Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës.

Të dhënat e paraqitura në grafikun 3 të paraqitur më lartë tregojnë nivelin e kategorive kryesore për të ardhurat e mbledhura nga Administrata Tatimore e Kosovës. Siç prezentohet edhe në grafik, në përgjithësi kategoria kryesore e të ardhurave të ATK-së janë të ardhurat e realizuara nga tatimi në vlerën e shtuar. Kategoria tjetër më e madhe për nga rëndësia janë të ardhurat e realizuara nga tatimi në të ardhurat personale ndërsa, të ardhurat nga tatimi në korporata përbën pjesën më nivelin më të ulët krahasuar me dy kategoritë tjera. Mirëpo, siç shihet edhe në grafik në periudhat 2005 deri 2009 kemi luhatshmëri sa i përket pjesëmarrjes dhe nivelit të këtyre kategorive të të ardhurave. Në vitin 2005 kur edhe u vendosë baza tatimore në këto tri kategori kryesore të të ardhurave, shohim se pjesëmarrja e tyre në të ardhurat e realizuara pothuajse është e njëjtë. Ndërsa,

duke filluar nga viti 2006 e deri në vitin 2009, pjesa kryesore e të ardhurave janë të ardhurat nga tatimi në të ardhura personale i ndjekur nga tatimi në korporata. Pastaj në vitin 2009 kur edhe filluan së zbatuari reformat në uljen drastike të normave tatimore për të ardhurat nga tatimi në korporata dhe tatimi në të ardhura personale shihet qartë edhe rënja e nivelit dhe pjesëmarrjes së tyre në të ardhurat totale të mbledhura nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe pjesëmarrja më e ulët e këtyre të ardhurave në krahasim më të ardhurat e realizuara nga tatimi në vlerën e shtuar vazhdon edhe përgjatë viteve në vazhdim.

Grafiku 4: Ecuria e të ardhurave tatimore të mbledhura nga ATK, ndaj PBB-së, në %




Burimi: Përpunuar nga autori , bazuar në të dhënat nga: ATK nga viti 2009, ASK, Vjetari statist. i RK 2014

Në grafikun e mësipërm është paraqitur pjesëmarrja në përqindje e llojeve të ndryshme të të ardhurave tatimore të realizuara nga ATK ndaj Produktit të Brendshëm Bruto. Siç edhe tregohet në grafik tatimi në vlerën e shtuar bënë pjesë mesatarisht me 2.03% ndaj PBB-së për periudhën e lartcekur 2002-2015 dhe përbën pjesëmarrjen me të lartë. Tatimi në të

ardhurat personale bënë pjesë mesatarisht me 1.72 % për këtë periudhë. Ndërsa, tatimi në të ardhura nga korporatat bënë pjesë mesatarisht me 1.34 % për vitet e cekura në grafikë dhe përbën pjesëmarrjen me të ulët në % ndaj PBB-së. Ndërsa, totali i raportit të të ardhurave tatimore të mbledhura nga ATK, ndaj PBB-së është mesatarisht 5.09 % për periudhën e paraqitur në tabelë.

Grafiku 5.: Kategoritë e ndryshme të të ardhurave ndaj PBB-së në Kosovë, në %



Burimi: Përpunuar dhe llogaritur nga autori bazuar në të dhënat nga: ASK, ATK, BQK.

Shënim: Të ardhura tjera përfshinë: Të ardhurat tatimore dhe jotatimore të qeverive qendrore dhe lokale si: Dividenda e PTK-së, Aeroportit, Taksat koncensionale, Tantiemat, Tatimi në pronë, Gjobat e ndryshme etj.

Siç tregohet nga grafiku i mësipërm të ardhurat tatimore të brendëshme d.m.th. të ardhurat që administrohen nga ATK, në vitin 2002 përbënin 3.31 % e të hyrave totale të buxhetit të Kosovës. Ndërsa, në vitin 2015 ato përbëjnë 5.83 % të PBB-së, që krahasuar me vitin 2002 kjo përqindje është për 2.5 2% më e lartë. Pjesëmarrja mesatare e këtyre të ardhurave përgjatë viteve të përfshira në këtë studim është 5.09 % e PBB-së që tregon për një përfshirje tejet të ulët. Një përfaqësim me të lartë kanë të ardhurat e mbledhura nga

kufiri. Në vitin 2002 ato përbënin 15.93 % të totalit të të ardhurave buxhetore ndërsa, në vitin 2015 ato përfaqësojnë 16.56 %, do të thotë një rritje shumë simbolike prej 0.63% përgjatë periudhës në trajtim. Pjesëmarrja mesatare e këtyre të ardhurave përgjatë viteve të përfshira në studim është 16.14 % e PBB-së që tregon se këto të ardhura kanë peshën kryesore të të ardhurave në buxhet. Të ardhurat tjera përfaqësojnë 1.56% e të ardhurave buxhetore në vitin 2002 dhe 3.29 % në vitin 2015 që i bie një rritje prej 1.73 %. Mesatarja e pjesëmarrjes së tyre është 3.65 %.

3.2.1 Reformat në strukturën tatimore në Kosovë

Është e ditur se struktura tatimore paraqet pjesën që zënë tatimet e veqanta, në përqindje ndaj totalit të të ardhurave tatimore. Struktura tatimore në Kosovë që nga themelimi i sistemit tatimor të pasluftës së vitit 1999 në vazhdimësi ka qenë pjesë përbërëse e reformave të shumta si në strukturë ashtu edhe norma tatimore. Prandaj, struktura tatimore e aplikuar që nga themelimi i sistemit të ri tatimor ka qenë si në vijim:

Tatimi mbi shitjen (TSH) është tatimi i parë i aplikuar në Kosovë pas luftës 1998-99. TSH, hyri në fuqi në Janar 2000, është vendosur për mallrat e importuara apo të prodhuara në Kosovë dhe u aplikua me normë tatimore prej 15%. Në Korrik të vitit 2001 ky tatim u shfuqizua dhe u zëvendësua me TVSh me të njëjtën normë.

Tatimi për Shërbimet Hoteliere, Ushqim dhe Pije (TSHHUP) hyri në fuqi në Shkurt të vitit 2000 për ato ndërmarrje që realizojnë të ardhura mbi 15.000 DM bruto në cilindo muaj kalendarik, të cilat do të paguanin 10% tatim të asaj shume bruto, në Maj 2000, ulët qarkullimi nga 15.000 DM në 10.000 DM. Prej 1 Korrikut me hyrjen në fuqi të tatimit të paragjykuar këto lloj të ardhurash i nënshtrohen TP në normën fikse për të ardhurat deri në

15.000 DM, norma fikse ishte e vendosur varsisht prej vendodhjes se biznesit sië është përshkruar më lartë, pastaj për të ardhurat mbi 15.000 DM, TP vendosej 3% e shumës mbi 15.000 DM pasiqë nga totali i të ardhurave të jetë zbritur tatimi prej 10% i paguar si TSHHUP. TSHUP është shfuqizuar me 1 Korrik të vitit 2001 me hyrjen në fuqi të TVSH-së , ku të ardhurat deri në 200.000 DM(100.000 € - nga 1 Janar 2002) nga këto shërbime do të tatimohen sipas rregullave të TP, ndërsa të ardhurat mbi shumën 100.000 € do t'i nënshtrohen TVSH-së.

Tatimi i paragjykuar (TP) ka filluar të implementohet me 1 Korrik 2000. Të gjithë tatimpaguesit do të paguajnë në çdo tremujor një taks fikse duke u bazuar në llojin e veprimtarisë dhe vendodhjes së biznesit, plus 3% të të ardhurave tremujore bruto që tejkalon shumën 15.000 DM (7500€). Ky lloj tatimi zëvendësohet me hyrjen në fuqi të TAP (për bizneset individuale) , në Janar 2005.

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) filloi të implementohet me 1 Korrik 2001, për bizneset me të ardhura me të larta se 100.000 €, ky kufi ulët në 50.000 € në Korrik të vitit 2002. Norma tatimore e aplikuar për këtë lloj tatimi deri me 1 Janar 2009 ishte 15% ndërsa, nga Janari 2009 është 16%. Mirëpo, baza e strukturës tatimore në Kosovë vendoset në Janar të vitit 2005 dhe përbëhet nga tri lloje kryesore të tatimeve të administruara nga Administrata Tatimore e Kosovës: Tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi në të ardhurat personale dhe tatimin në të ardhurat e korporatave d.m.th. është bërë harmonizimi me llojet e tatimeve sipas direktivave të BE-së. Baza tatimore u ndryshua në funksion të thjeshtësimit dhe ofrimit të lehtësirave tatimore, (Strategjia e Përmbushjes 2012-2015, ATK, 2011: 9).

Nga Administrata Tatimore e Kosovës administrohen (mblidhen) edhe Kontributet Pensionale, por ato nuk bëjnë pjesë në të hyrat e buxhetit të Kosovës. Ecuria e të ardhurave

tatimore përgjatë viteve 2005 – 2013 sipas strukturës tatimore të vendosur me reformat e vitit 2005 do të paraqitet në formë tabelare në vazhdim duke përfshirë edhe përqindjen e pjesëmarrjes për secilën kategori tatimore, në të ardhurat totale të ATK-së, ku ecuria e të ardhurave përfshinë periudhën para dhe pas reformave edhe në normat tatimore të ndërmarra në vitin 2009.

Tabela 4. Struktura e të ardhurave tatimore, ndaj totalit të të ardhurave të mbledhura nga ATK, në %

Përshkrimi	Para reformave në normat tatimore				Pas reformave në normat tatimore				
Struktura tatimore/Viti	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Tatimi në Vlerën e Shtuar	35,70	28.49	31.00	27.30	40.25	51.00	46.85	46,28	48.84
Tatimi në të Ardh. Personale	42.56	52.81	35.42	35.60	38.46	32.35	30.89	30.77	29.58
Tatimi në Korporata	21.74	18.70	33.58	37.10	21.29	16.65	22.27	22.94	21.58
Totali:	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00
Kontributet Pensionale	40.09	34.05	33.37	32.85	39.80	42.99	42.14	38.38	39.34

Burimi: Përpunuar nga Autori , bazuar në të dhënat nga: ATK nga viti 2009, ASK, Vjetari statis.i RK 2014.

Siç tregohet në tabelën 4, Tatimi mbi vlerën e shtuar përbën mesatarisht 40% të të hyrave totale tatimore të mbledhura nga ATK në vitet 2005- 2013. Krahësuar me vitin 2008, d.m.th. para aplikimit të reformave në normat tatimore, përqindja e pjesëmarrjes së tyre u rritë nga 27.30 % sa ishte në vitin 2008 në 40,25 % në vitin 2009 kur norma tatimore për këtë lloj tatimi u rritë me një pikë % nga 15 në 16 %. Kjo përbërje e Tvsh-së në totalin e të ardhurave tatimore mund të shpjegohet për faktin se Kosova është e varur nga importi

d.m.th shumë pak prodhohet në vend dhe duke qenë objekt i tatimit në kufij, tatimpaguesit me qëllim të rimbursimit të Tvsh-së të paguar në kufij për këto produkte i deklarojnë të ardhurat me rastin e shitjes së tyre dhe paguajnë diferencën e Tvsh-së, pas zbritjes së Tvsh-së në blerje, në këtë menyrë edhe mundësia e evazionit fiskal të këto lloj të ardhurash është më e vogël, krahasuar me lloje të tjera të të ardhurave. Tatimi në të ardhurat personale përbën mesatarisht 36% të të hyrave totale tatimore të mbledhura nga ATK në vitet 2005-2013. Në vitin 2013 pjesëmarrja e tyre është 29.58 %, që i bie për 12.98% me e ulët krahasuar me vitin 2005 kur edhe filloi se zbatuari ky lloj tatimi , ndërsa krahasuar me vitin 2008 d.m.th. para aplikimit të reformave në normat tatimore, përqindja e pjesëmarrjes së tyre është për 8.88% me e ulët në vitin 2013. Kjo rënje në pjesëmarrjen e këtij lloj tatimi ndaj të ardhurave totale mund të shpjegohet me faktin se pati një rënje në normat progresive të aplikuara në vitin 2009 siç është shpjeguar me lart norma me e lartë progresive 20% u ulë në mënyrë drastike në 10% dhe mendoj se ishte një ulje e panevojshme dhe e dëmshme për faktin se edhe mundësia për evazion fiskal të ky lloj të të ardhurash është shumë me e madhe, ndërsa mundësia dhe mënyra e kontrollimit të tyre nga administrata tatimore është me e vogël. Tatimi në të ardhurat në korporata përbën mesatarisht 24% të të hyrave totale tatimore të mbledhura nga ATK në vitet 2005-2013. Në vitin 2013 pjesëmarrja e tyre është 21.58 %, që i bie për 0.16 pikë me e ulët krahasuar me vitin 2005 kur edhe filloi se zbatuari ky lloj tatimi, ndërsa krahasuar me vitin 2008 d.m.th. para aplikimit të reformave në normat tatimore, përqindja e pjesëmarrjes së tyre është për 15.52 % me e ulët në vitin 2013. Kjo rënje në pjesëmarrjen e këtij lloj tatimi ndaj të ardhurave totale, gjithashtu mund të shpjegohet me faktin e uljës së normave .tatimore nga

20 në 10% në vitin 2009 që u bë me qëllim të rritjes së investimeve mirëpo, edhe pas 6 viteve nuk vërehet se ky qëllim pati sukses për tu theksuar.

Kontributet pensionale edhe pse mbledhen nga i njëjti autoritet d.m.th Administrata Tatimore e Kosovës, ato nuk janë pjesë përbërëse e buxhetit në Kosovë, llogaritja e tyre në përqindje ndaj PBB-së (që i bie të jetë mesatarisht 2.13%) është bërë me qëllim të pasqyrimin të humbjes që i bëhet buxhetit të Kosovës në mungesë të këtyre mjeteve. Ato pra, mbledhen nga ATK, menaxhohen nga TKPK dhe investohen në kompani të huaja botërore që nga muaji gusht i vitit 2002 kur filloi aplikimi i mbledhjes së tyre. Vendimi për investimin e tyre jashtë vendit u bë nga Qeveria e përkohshme e Kosovës kuptohet me tryesnin e ndërkombëtarëve sepse, Kosova akoma nuk ishte shtet i pavarur, dhe ky investim i mjeteve jashtë vendit ishte bërë me një marrveshje për një periudhë 10 vjeçare, mirëpo edhe tani pas 10 viteve një gjë e tillë nuk ndodhi. Ajo çka përfiton Buxheti i Kosovës nga këto mjete janë të ardhurat nga gjrobat e aplikuar nga Administrata tatimore për tatimpaguesit të cilat nuk deklarojnë dhe paguajnë me kohë obligimet e kontributeve pensionale për të punësuarit dhe veten e tyre (vetpunuarit).

Struktura tatimore sipas llojit të tatimeve

Kemi thënë se perspektiva evropiane siç është përshkruar nga Hutsebaut, M.(2013) mbështetet në tri shtylla të sistemeve tatimore: Sipas llojit të tatimit; sipas bazës së tatueshme dhe sipas nivelit administrativ. Sipas llojit të tatimit, tatimet ndahen në: Tatimet direkte, tatimet indirekte dhe Kontributet sociale. Tatimet direkte përfshin tatimin mbi të ardhurat personale, tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin e korporatave. Tatimet indirekte përfshin TVSh-në, taksat dhe akcizën për produktet e importuara. Në vazhdim do të

paraqesim strukturën tatimore të ndarë sipas llojeve tatimore të lartëcekura për të parë se sa reflekton kjo ndarje në raport me PBB-në (në përqindje):

Tabela 5. Struktura sipas llojeve të tatimeve ndaj PBB-së në Kosovë, në %

Struktura /Viti	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Tatimet indirekte	19.60	16.14	17.69	18.27	18.04	19.91	20.59	19.68	18.78
T.në Vlere e Shtuar	9.86	8.29	9.49	10.08	10.35	11.66	11.77	11.10	10.72
Aksiza	6.70	3.70	3.89	3.64	3.81	3.89	4.35	6.13	5.76
Taksat doganore	3.04	4.15	4.31	4.55	3.88	4.36	4.47	2.45	2.32
Tatimet direkte	3.40	3.85	3.99	4.45	3.11	2.66	3.02	3.08	2.99
T. në të Ardh. Personale	2.25	2.85	2.05	2.17	2.01	1.76	1.75	1.77	1.73
T. në Korporata	1.15	1.00	1.94	2.28	1.10	0.90	1.27	1.31	1.26
Totali:	23.00	19.99	21.68	22.72	21.15	22.57	23.61	22.76	21.79
Kontributet Pensionale	2.12	1.83	1.93	2.01	2.07	2.34	2.39	2.20	2.29

Burimi: Përpunuar nga autori , bazuar në të dhënat nga: ATK nga viti 2009, ASK, Vjetari statistikor i RK 2014 ASK, FMN, BB, MF (Pasqyrat financiare).

Siç është paraqitur në tabelën 5 tatimet indirekte bëjnë pjesë mesatarisht me 18.74% ndaj PBB-së për periudhën 2005-2013, ndërsa tatimet direkte bëjnë pjesë mesatarisht me 3.40% ndaj PBB-së për periudhën e njëjtë.

3.2.2 Struktura tatimore në disa vende të Europës Juglindore dhe rajonit

Në vazhdim do të prezantohet struktura tatimore në disa vende të Europës Juglindore dhe rajonit si dhe struktura tatimore në 27 vende anëtare të BE-së e marr kjo në % ndaj PBB-së. Qëllimi i prezantimit të tyre është që të bëhet një analizë krahasuese se si qëndron Kosova në raport me këto vende sa i përket strukturës që përbëjnë tatimet dhe sa është pjesëmarrja e secilës kategori të të ardhurave në raport me PBB-në.

Tabela 6. Struktura tatimore në disa vende të Europës Juglindore dhe rajonit (2006-2011), në % ndaj PBB

Pershkrimi	Tatimet direkte				Tatimet indirekte			Tjera		
Vendi	T.Indi- viduale	T.Kor- porata	Të pa alokuar	Tatimi pronës	Tvsh	aksiza	Taksa tregtare	Tatime tjera	Tatime totale	Sigurimet shoqrore
Kosova	1.6	1.4	0.5	0.3	9.9	5.5	2.5	0.0	21.7	-
Shqipëria	1.9	2.0	0.0	0.3	9.3	2.9	0.9	2.1	19.4	3.9
Bosnja& Herceg.	0.7	0.7	1.6	0.4	13.9	4.0	2.1	0.0	23.3	14.4
Bullgaria	2.9	2.5	0.0	1.4	9.6	5.4	0.3	0.0	22.1	6.4
Kroacia	2.9	2.5	0.0	0.4	11.7	3.6	0.5	0.7	22.3	11.7
Republika Çeke	3.9	4.2	0.0	0.4	6.9	3.8	0.0	0.9	20.1	15.8
Hungaria	7.3	2.2	0.0	0.9	8.1	3.8	0.0	3.8	26.1	12.5
Latvia	6.0	2.1	0.0	0.6	7.2	3.4	0.2	0.5	20.0	8.7
Lituania	5.2	2.2	0.3	0.4	7.6	3.1	0.0	0.4	19.2	10.7
Maqedonia	2.5	1.6	0.0	0.4	8.8	4.0	1.6	1.4	20.3	9.7
Mali i Zi	3.7	1.3	0.0	0.6	12.0	4.3	1.6	1.4	24.9	9.7
Polonia	4.9	2.4	0.0	1.2	7.9	4.1	0.0	0.8	21.3	11.8
Rumania	3.4	2.6	0.0	0.7	7.9	3.0	0.3	0.5	18.4	9.4
Serbia	5.0	1.2	0.0	0.7	11.3	4.7	1.9	0.2	25.0	13.6
Sllovakia	2.5	2.8	0.3	0.4	6.8	3.0	0.0	1.2	17.0	12.1
Sllovenia	5.8	2.3	0.0	0.6	8.5	3.8	0.3	1.6	22.9	14.4
Turqia	3.9	1.8	0.0	1.0	5.2	4.8	0.3	2.1	19.1	5.8
Barra mesatare	3.9	2.2	0.1	0.7	8.9	3.9	0.6	1.1	21.3	10.7

Burimi: IMF (Vlersimet e stafit të FMN-së, Qershor,2013)

Siç shihet nga tabela 6 - raporti i totalit të tatimeve ndaj PBB-së është 21.7 %, dhe është i krahasueshëm me mesataren e periudhës 2006-2011 të Evropës Juglindore. Mirëpo, në të kundërtën tatimi direkt në Kosovë, është i ulët në krahasim me vendet e tjera të Europës Juglindore. Gjithsej, tatimet direkte përbëjnë me pak se gjysmën e të ardhurave të vjela nga ky burim në rajon. Përformanca e ulët e tatimeve direkte është si rezultat i normave të ulëta

të tatimit në korporata, mungesa e progresivitetit të mjaftueshëm në strukturën e të ardhurave personale dhe bazat e ngushta tatimore, për shkak të sektorit joformal. Nga ana tjetër taksat indirekte, sa i përket aksizes dhe taksave doganore janë më të lartat në rajon. Ndërsa, Tvsh është për një pikë % me e lartë sesa mesatarja e vendeve të rajonit. Çfarë jep për të kuptuar se nevoja për një reformë graduale të sistemit tatimor në Kosovë, për të shmangur shpenzimet e panëvojshme ose përjashtimet tatimore dhe rishikimi i ritmeve shumë të ulëta sikurse tatimi mbi të ardhurat e korporatave, si dhe ato personale, është e domosdoshme.

3.2.3 Struktura Tatimore në vendet e BE-së

Në vazhdim do të paraqesim strukturën tatimore në vendet e BE-së me qëllim të pasqyrimin të një analize krahasuese me strukturën tatimore të sistemit tatimor të Kosovës.

Tabela 7. Struktura tatimore në vendet e BE-së, ndaj PBB-së në %

Struktura /Viti	2000	2002	2004	2006	2008	2010	2012
Tatimet indirekte	13.5	13.2	13.2	13.4	12.9	12.9	13.3
T.në Vlere e Shtuar	7.0	6.7	6.6	6.8	6.8	6.9	6.9
Aksiza dhe taksat e konsumit	2.7	2.7	2.6	2.5	2.3	2.4	2.4
Taksat doganore	1.7	1.7	1.8	2.0	1.7	1.6	1.6
Taksa tjera ne prodhim	2.1	2.1	2.1	2.1	2.0	2.1	2.4
Tatimet direkte	13.0	12.1	11.9	12.6	12.7	11.8	12.7
T. në të Ardh. Personale	9.1	8.7	8.3	8.5	8.9	8.7	9.2
T. në Korporata	3.0	2.5	2.6	3.2	2.9	2.2	2.4
Tjera	0.9	0.9	1.0	0.9	0.9	0.9	1.0
Kontributet Pensionale	14.5	14.3	14.3	14.1	14.1	14.4	14.6
Totali:	40.9	39.5	39.2	40.0	39.6	39.0	40.4

Burimi : Commission services

Gjithashtu si shihet nga tabela e mësipërme në 27 shtete të BE-së pjesëmarrja e tatimeve në PBB është 40.4% në vitin 2012, pjesëmarrja e tatimeve indirekte është shumë e vogël në krahasim me Evropën Lindore, ndërsa taksat direkte (12.7%), kontributet pensionale (14.6%), janë në pjesëmarrje shumë më të gjerë në krahasim me vendet e mësipërme dhe në veçanti në krahasim me Kosovën. Vlenë të përmendet se ndryshe nga vendet e BE-së, të ardhurat nga kontributet shoqërore nuk janë pjesë e PBB në Kosovë, janë të administruara nga ATK, por menaxhohen nga një organ i pavarur i quajtur Trusti i Kursimeve Pensionale që mbajnë llogaritë personale të individëve të cilët paguajnë 5% në muaj (i punsuari), dhe 5% në muaj (punëdhënësi). Kjo shumë përfaqëson më shumë se një të tretën e të ardhurave tatimore të përgjithshme të administruara nga ATK.

3.3 Reformat e normave tatimore

3.3.1 Reformat e normave tatimore në Kosovë

Reformat janë nganjëherë të vështira për t'u arritur, sepse ato krijojnë fitues dhe humbës. Kriza financiare dhe ekonomike që filloi në vitin 2008 ka rezultuar në një përkeqësim të financave publike në shumë vende të BE-së. Rrjedhimisht, politikat fiskale në vitin 2011 dhe 2012 janë shtyrë në mënyrë tipike për të sjellë financat publike në një rrugë të qëndrueshme. Megjithatë, reformat e taksave në BE në vitin 2011 dhe 2012 janë përgjigja më së e nevojshme për konsolidim të financave publike, duke përfshirë edhe anën e të ardhurave, e cila është reflektuar në rritjen e barrës tatimore në përgjithësi, duke përfshirë edhe sigurimet shoqërore (Komisioni Evropian, 2012).

Tabela 8. Normat e Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TAP), në Kosove , në %

Tatimi mbi Vleren e Shtuar dhe normat ne %	
Deri ne 2008	Nga 2009
15%	16%

Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës

Tabela 9. Normat e Tatimi në të ardhurat personale (TAP) në Kosovë, në %

Tatimi në të Ardhura Personale dhe normat tatimore në %			
Shumat e të ardhurave personale në €		Norma e tatimeve ne %	
Mujore (Paga)	Vjetore(paga dhe biznesore)	Deri në Janar 2009	Nga Janari 2009
Deri 80 €	Deri 960€	0%	0%
80-250 €	960-3000 €	5%	4%
250-450 €	3000-5400 €	10%	8%
Mbi 450 €	Mbi 5400 €	20%	10%

Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës

Ndërsa, të gjitha bizneset individuale me të ardhura bruto vjetore prej 50.000 € ose me pak, që nuk kërkohet ose nuk zgjedhin të regjistrohen si tatimpagues të mëdhenjë në TAP, detyrohen të paguajn për çdo tremujor si në vijim:

Të ardhurat vjetore 0-5000 €	37.50 € / tremujor
Të ardhurat vjetore 5000- 50.000€	3% e të hyrave bruto nga tregtia, transporti, bujqësia e të ngjashme, por jo më pak se 37.50 € për tremujor.
Të ardhurat vjetore 5000- 50.000€	5 % (deri në Korrik 2012), ndërsa nga Korriku 2012, 9% e të hyrave bruto nga veprimtaritë shërbyese si: ato profesionale, zanate, argëtim apo veprimtari tjera të ngjashme, por jo më pak se 37.50 € për tremujor.

Normat tatimore të TAK – Tatimi në korporata hyri në fuqi me 1 Janar 2005. Normat e TAK poashtu, varen nga të ardhurat vjetore të korporatave siç është paraqitur në tabelën në vijim:

Të ardhurat vjetore nga 0 - 5000 €	37.50 € / tremujor
Të ardhurat vjetore 5000- 50.000 €	3 – 10% e të hyrave bruto.
Të ardhurat vjetore 5000- 50.000 €	20 % deri janar 2009; nga janari 2009, 10% e fitimit.

Korporatat me qarkullim vjetor mbi 50.000 € kanë qenë dhe janë të obliguara të paguajnë në bazë të fitimit të tyre neto (pas zbritjes së shpenzimeve të lejueshme) sipas normave të paraqitura në tabelën në vazhdim:

Tabela 10. Normat e Tatimi në të ardhura të korporatave (TAK) në Kosovë, në %

Tatimi në të ardhura të Korporateve dhe normat në %	
Deri në Dhjetor 2008	Nga Janari 2009
20%	10%

Burimi: ATK

Normat në Kontributet Pensionale, filluan të implementohen nga 1 Gusht 2002 për të punsuarit e sektorit publik, ndërsa nga 1 gusht 2003 për të punsuarit dhe të vetpunsuarit në sektorin privat. Normat e obligueshme nga pagat e të punsuarve në të dy sektoret janë 5% nga paga bruto që do t'i ndalet të punsuarit dhe 5% nga paga bruto do të paguaj punedhenesi në llogari të të punsuarit. Individët e vetpunsuar, pronar të BVI paguajnë pension sa 1/3 e detyrimit tatimor ndërsa pronarët e BMI paguajnë 10 % të detyrimit tatimor, por të dy kategoritë paguanin jo më pak se 23.40 € për tremujor deri në muajin Korrik 2012, ndërsa që nga kjo periudhë jo më pak se 39 € respektivisht 51 € për tremujor (varësisht nga mosha e kontribuesit) dhe jo më shumë se 600 € për tremujor.

Në tabelën në vijim do të paraqitet një përmbledhje e reformave në strukturë dhe norma tatimore të aplikuara në sistemin tatimor të pas luftës së vitit 1999 në Kosovë.

Tabela 11. Reformat në strukturë dhe norma tatimore në Kosovë (2000 -2012)

Vitet	Llojet e tatimeve								
	Tatimi mbi shitjen	Tatimi në Shërbime për Hotele Ushqim dhe Pije	Tatimi i Paragjykuar	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	Tatimi në Fitim	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	Kontributet Pensionale	Tatimi në Korporata	Tatimi në Lojra të Fatit
2000	° janar 15%	° shkurt 10%	° korrik 3%						
2001	×Korrik	×Korrik		°Korrik 15%					
2002					°Shkurt 20%	°Prill 5;10;20%	°Gusht 5+5%		
2003							°Gusht 5+5 %		
2004									°Shtator 20%
2005			× Janar		×Janar	°Janar BVI:3;5% BMI: 5;10;20%		°Janar 20%	5;10;20%
2009				Janar 16%		Janar 4;8;10% BVI:3;9%		Janar 10%	4;8;10%
2012									
2015				Shtator 8%; 18%					

Burimi: Punuar nga Autori, bazuar ne Ligjet e Aplikueshme në Administratën Tatimore të Kosovës

° Hyrja ne fuqi; × Shfuqizimi

Në tabelën e mësipërme siç u cekë më parë janë paraqitur reformat në norma dhe strukturë tatimore, të cilat kanë qenë të vazhdueshme që nga themelimi i sistemit tatimor të Kosovës në vitin 2000. Siç tregohet në tabelë lloje të ndryshme tatimore duke filluar me tatimin e paragjykuar, dhe norma të ndryshme tatimore janë aplikuar që nga viti 2000 deri në vitin 2005 kur u vendos baza ligjore tatimore që përfshinë tri lloje kryesore të tatimeve si: Tatimi në të ardhura personale, tatimi në korporata dhe tatimi në vlerën e shtuar. Poashtu, edhe në vitin 2012 reformat kanë vazhduar me ndryshimin e normave të tatimit në të ardhura

përsonele për bizneset që realizojnë të ardhura vjetore më të ulëta se 50.000 euro për bizneset e përfshira në veprimtari shërbyese.

3.3.2 Normat tatimore në vendet e rajonit

Me qëllim të pasqyrimin se si qendron sistemi tatimor i Kosovës në raport me vendet e ndryshme të rajonit dhe BE-së sa i përket normave tatimore të aplikuara për kategoritë e ndryshme të të ardhurave në vazhdim do të prezentohen përmes paraqitjeve tabelare.

Tabela 12. Barra e taksave në Kosovë dhe në rajon (2012-2013), në %

Nr.	Shteti	Tatimi i Vlerës së shtuar	Tatim fitimi	Tatimi në të ardhura personale	Sigurimet shoqerore
1	Kosova	16	10	4 8 10	10
2	Maqedonia	5 18	0	10	27
3	Shqipëria	10 20	0	10	27.9
4	Bullgaria	7 20	10	5 10	30.3
5	Mali I Zi	7 17	9	19	33.8
6	Kroacia	5 10 25	20	12 15 40	35.2
7	Greqia	6,6 13 23	26	10 20 22 32 42	44.5
8	Bosnja Hercegovina	17	10	5 10	31
9	Serbia	8 20	15	12 20 25	35.8
10	Rumania	5 9 24	16	16 50	44.2
Totali		17	12	15,6	27.6

Burimi: www.al-tax.org; www.atk-ks.org

Tabela 12 paraqet barrën e taksave në Kosovë, e cila siç tregohet në tabel në përgjithësi është me e ulët se sa mesatarja e barrës tatimore në rajon. Mëqenëse, në Kosovë deri tani aplikohet vetëm një normë tatimore mbi tatimin në vlerën e shtuar 16 % , e ajo është më e ulët krahasuar me normat më të larta që aplikohen në vendet tjera të rajonit dhe është edhe më e ulët sesa mesatarja e vendeve të rajonit. Tatimi në fitim përpos Maqedonisë dhe Shqipërisë që nuk është fare i aplikueshem, Mali i zi ka normë më të ulët sesa Kosova për një % dhe norma të barabarta me Kosovën kanë Bullgaria dhe Bosnja Hercegovina, vendet tjera kanë normë me të lartë dhe prapë se prapë Kosova ka normë më të ulët sesa mesatarja

e rajonit edhe për këtë lloj tatimi. Ndërsa, sa i përket tatimit në të ardhura personale dhe kontributeve pensionale Kosova ka normat më të ulëta tatimore në rajon.

3.3.3 Normat tatimore në vendet e BE-së

Tabela në vazhdim prezanton normat e aplikuara tatimore në 27 vende anëtare të BE-së

Tabela 13. Normat tatimore në të ardhurat personale (TAP), në BE (EU-27), në %

Përshkrimi	Normat tatimore në të ardhurat personale					
Vendi/Vitet	2000	2005	2010	2011	2012	2013
Belgjika	60.6	53.7	53.7	53.7	53.7	53.7
Bullgaria	40.0	24.0	10.0	10.0	10.0	10.0
Republika Qeke	32.0	32.0	15.0	15.0	15.0	22.0
Danimarka	62.9	62.3	55.4	55.4	55.4	55.6
Gjermania	53.8	44.3	47.5	47.5	47.5	47.5
Estonia	26.0	24.0	21.0	21.0	21.0	21.0
Irlanda	44.0	42.0	41.0	41.0	41.0	41.0
Greqia	45.0	40.0	49.0	49.0	49.0	46.0
Spanja	48.0	45.0	43.0	45.0	52.0	52.0
Franca	59.0	53.5	45.8	46.7	46.8	50.2
Italia	45.9	44.1	45.2	47.3	47.3	47.3
Qipro	40.0	30.0	30.0	30.0	28.5	38.5
Latvia	25.0	25.0	26.0	25.0	25.0	24.0
Lituania	33.0	33.0	15.0	15.0	15.0	15.0
Luksemburgu	47.2	39.0	39.0	42.1	41.3	43.6
Hungaria	44.0	38.0	40.6	20.3	20.3	20.3
Malta	35.0	35.0	35.0	35.0	35.0	35.0
Holanda	60.0	52.0	52.0	52.0	52.0	52.0
Austria	50.0	50.0	50.0	50.0	50.0	50.0
Polonia	40.0	40.0	32.0	32.0	32.0	32.0
Portugalia	40.0	40.0	45.9	50.0	49.0	56.5
Rumania	40.0	16.0	16.0	16.0	16.0	16.0
Slovenia	50.0	50.0	41.0	41.0	41.0	50.0
Slovakia	42.0	19.0	19.0	19.0	19.0	25.0
Finlanda	54.0	51.0	49.0	49.2	49.0	51.1
Suedia	51.5	56.6	56.6	56.6	56.6	56.6
Britania	40.0	40.0	50.0	50.0	50.0	45.0
Totali (Mesatarja)	44.8	40.0	37.9	37.6	38.1	38.9

Burimi: Eurostat (European Commission,2014)

Të dhënat e prezentuara në tabelën e mësipërme pasqyrojnë normat tatimore të aplikuara në të ardhurat personale përgjatë viteve 2000-2013 ku shihet se mesatarja e këtyre normave në vendet antare të BE-së në vitin 2000 ishte 44.8 %, përderisa në vitin 2013 ka një rënje në këtë mesatare që siç tregohet në tabelë është 38.9%. Dhe, poqëse krahasojmë normat e aplikuar në këtë lloj tatimi në Kosovë shihet qartë se ka një ndryshim të madh meqenëse

norma më e lartë progresive e aplikuar në këtë kategori të ardhurash para reformave të vitit 2009 ishte 20% ndërsa pas vitit 2009 ka pësuar rënje drastike në 10%.

Tabela 14. Normat tatimore në të ardhurat e korporatave (TAK), në BE (EU-27), në %

Përshkrimi	Normat tatimore në të ardhurat e korporatave					
Vendi/Vitet	2000	2005	2010	2011	2012	2013
Belgjika	40.2	34.0	34.0	34.0	34.0	34.0
Bullgaria	32.5	15.0	10.0	10.0	10.0	10.0
Republika Qeke	31.0	26.0	19.0	19.0	19.0	19.0
Danimarka	32.0	28.0	25.0	25.0	25.0	25.0
Gjermania	51.6	38.7	29.8	29.8	29.8	29.8
Estonia	26.0	24.0	21.0	21.0	21.0	21.0
Irlanda	24.0	12.5	12.5	12.5	12.5	12.5
Greqia	40.0	32.0	34.0	30.0	30.0	26.0
Spanja	35.0	35.0	30.0	30.0	30.0	30.0
Franca	37.8	35.0	34.4	34.4	36.1	36.1
Italia	41.3	37.3	31.4	31.4	31.4	31.4
Qipro	29.0	10.0	10.0	10.0	10.0	10.0
Latvia	25.0	15.0	15.0	15.0	15.0	15.0
Lituania	24.0	15.0	15.0	15.0	15.0	15.0
Luksemburgu	37.5	30.4	28.6	28.6	28.6	29.2
Hungaria	19.6	17.5	20.6	20.6	20.6	20.6
Malta	35.0	35.0	35.0	35.0	35.0	35.0
Holanda	35.0	31.5	25.5	25.0	25.0	25.0
Austria	34.0	25.0	25.0	25.0	25.0	25.0
Polonia	30.0	19.0	19.0	19.0	19.0	19.0
Portugalia	35.2	27.5	29.0	29.0	31.5	31.5
Rumania	25.0	16.0	16.0	16.0	16.0	16.0
Slovenia	25.0	25.0	20.0	20.0	20.0	17.0
Sllovakia	29.0	19.0	19.0	19.0	19.0	23.0
Finlanda	29.0	26.0	26.0	26.0	24.5	24.5
Suedia	28.0	28.0	26.3	26.3	26.3	22.0
Britania	30.0	30.0	28.0	26.0	24.0	24.0
Totali (Mesatarja)	31.9	25.5	23.7	23.4	23.5	23.0

Burimi: Eurostat (European Commission,2014)

Ulja e normave tatimore në të ardhurat e korporatave në vendet e BE –së, e cila bëhet për qëllime të konkurrencës në tregjet e këtyre vendeve ka rëndësi të tërthortë mbi efektet e tatimit në të ardhurat personale, sepse taksat mbi të ardhurat e korporatave shërbejnë si barrierë për tatimet në të ardhura personale, për faktin që konkurrenca e ashpër e kompanive që janë objekt i tatimit në korporata kufizon ngritjen e të hyrave potenciale të tatimit në të ardhura personale, Ganghof dhe Genschel, (2008, fq. 58-77). Kjo vërtetohet edhe nga të dhënat e normave tatimore të paraqitura në tabelat 13 dhe 14 ku shihet se

normat tatimore në të ardhurat e korporatave në shumicën e vendeve anëtare të BE-së janë më të larta se normat e tatimit në të ardhurat personale, përjashtim bëjnë vendet si Belgjika, Estonia, Lituania, Malta, Rumania ku normat tatimore për të dy llojet e të ardhurave në fjalë janë të barabarta që nga viti 2010 ndërsa, për dallim nga të gjitha vendet tjera anëtare të BE-së Hungaria ka normën e tatimit në të ardhura të korporatave më të lartë se sa ajo e të ardhurave personale, edhe pse në shumë simbolike prej 0.3 pikë. Ngjashëm me rastin e Hungarisë edhe në Kosovë norma tatimore në të ardhurat e korporatave është më e lartë se sa dy normat e para tatimore progresive të tatimit në të ardhurat personale, vetëm norma më e lartë progresive prej 10% e tatimit në të ardhurat personale është e barabarte me normën tatimore të të ardhurave në korporata në Kosovë.

Tabela 15. Normat tatimore në TVSh në %, në BE (EU-27)

Përshkrimi	Normat tatimore në të ardhurat e TVSh-se					
Vendi/Vitet	2000	2005	2010	2011	2012	2013
Belgjika	21.0	21.0	21.0	21.0	21.0	21.0
Bullgaria	20.0	20.0	20.0	20.0	20.0	20.0
Republika Qeke	22.0	19.0	20.0	20.0	20.0	21.0
Danimarka	25.0	25.0	25.0	25.0	25.0	25.0
Gjermania	16.0	16.0	19.0	19.0	19.0	19.0
Estonia	18.0	18.0	20.0	20.0	20.0	20.0
Irlanda	21.0	21.0	21.0	21.0	23.0	23.0
Greqia	18.0	19.0	23.0	23.0	23.0	23.0
Spanja	16.0	16.0	18.0	18.0	18.0	21.0
Franca	19.6	19.6	19.6	19.6	19.6	19.6
Italia	20.0	20.0	20.0	20.0	21.0	22.0
Qipro	10.0	15.0	15.0	15.0	17.0	18.0
Latvia	18.0	18.0	21.0	22.0	22.0	21.0
Lituania	18.0	18.0	21.0	21.0	21.0	21.0
Luksemburgu	15.0	15.0	15.0	15.0	15.0	15.0
Hungaria	25.0	25.0	25.0	25.0	27.0	27.0
Malta	15.0	18.0	18.0	18.0	18.0	18.0
Holanda	18.0	19.0	19.0	19.0	19.0	19.0
Austria	20.0	20.0	20.0	20.0	20.0	20.0
Polonia	22.0	22.0	22.0	23.0	23.0	23.0
Portugalia	17.0	21.0	21.0	23.0	23.0	23.0
Rumania	19.0	19.0	24.0	24.0	24.0	24.0
Slovenia	19.0	20.0	20.0	20.0	20.0	20.0
Sllovakia	23.0	19.0	19.0	20.0	20.0	20.0
Finlanda	22.0	22.0	23.0	23.0	23.0	24.0
Suedia	25.0	25.0	25.0	25.0	25.0	25.0
Britania	18.0	18.0	18.0	20.0	20.0	20.0
Totali (Mesatarja)	19.2	19.6	20.4	20.7	21.0	21.2

Burimi: Eurostat (European Commission,2014)

Siç tregohet në tabelën 15 të dhënat e paraqitura në tabelë pasqyrojnë normat tatimore të aplikuara në të ardhurat nga tatimi në vlerën e shtuar përgjatë viteve 2000-2013 ku shihet se mesatarja e këtyre normave në vendet anëtare të BE-së në vitin 2000 ishte 19.2 %, përderisa në vitin 2013 ka një rritje në këtë mesatare që siç tregohet në tabelë në 21.2 %. Dhe poqëse krahasojmë normat e aplikuara në këtë lloj tatimi në Kosovë shihet qartë se ka ndryshim sa i përket kësaj mestare në raport me këto vende pasiqë, norma tatimore e aplikuar në këtë kategori të ardhurash para reformave të vitit 2009 në Kosovë ishte 15 % ndërsa pas vitit 2009 ka pësuar rritje simbolike në 16%.

3.4 Përmbledhje e kapitullit

Objekt shqyrtimi në këtë kapitull ishte historiku i sistemit tatimor të Kosovës, kuadri ligjor, kuadri institucional dhe llojet tatimore që përbëjnë atë. Siç është treguar sistemi tatimor i Kosovës është i ri i krijuar në vitin 2000, fillimisht mbi bazën e rregulloreve të Misionit të Kombeve të Bashkuara të instaluar pas luftës në Kosovë, e pastaj gradualisht janë vënë bazat ligjore të tatimeve bazuar në ligje tatimore të miratuara nga Kuvendi i Kosovës. Sistemi tatimor në Kosovë vazhdimisht ka qenë i shoqëruar me reforma si në strukturë, norma dhe rregulla për administrimin e tatimeve. Në vitin 2005 është vendosur baza tatimore e përbërë nga: TAP, TAK, TVSH dhe KP. Në qendër të kapitullit të tretë poashtu kanë qenë analiza e reformave në normat dhe strukturën tatimore në sistemin tatimor të Kosovës si dhe një analizë krahasuese me normat dhe strukturën tatimore në vendet e rajonit dhe BE-së. Analiza e tillë ka pasqyruar saktë se ekziston një dallim i madh si në norma , ashtu edhe në strukturë tatimore ndërmjet Kosovës me vendet e rajonit e sidomos atyre të BE-së. Pasqyrohet saktë se normat tatimore të aplikueshme në Kosovë janë me të

ulëta në rajon dhe BE, ndërsa ka dallim edhe në mes të strukturës që përbën sistemi tatimor në Kosovë sidomos, krahasuar me vendet e BE-së, ku shihet se tatimet indirekte dominojnë strukturën tatimore në Kosovë, ndërsa e kundërta ndodh në vendet e BE-së.

Kapitulli IV: Metodologjia e kërkimit

4.1 Metodologjia dhe metodat bazë të hulumtimit

Realizimi i këtij studimi ka karakter përshkrues, analitik dhe vlerësues. Dy lloje burimesh të të dhënave janë përdorur për të bërë të mundur testimin e hipotezave dhe gjetjen e rezultateve të këtij studimi. Burimet parësore kanë shërbyer për mbledhjen e informacioneve përmes pyetsorëve ku të dhënat janë mbledhur drejtëpërdrejtë duke intervistuar bizneset në gjithë territorin e Kosovës. Gjithashtu realizimi i studimit është bërë përmes informacioneve nga burime dytësore. Fillimisht, burimet dytësore kanë shërbyer si pikënisje për trajtimin teorik të tematikës së zgjedhur për trajtim në këtë studim të cilat më vonë më kanë shërbyer si bazë për gjetjen e variablave kryesore të studimit. Gjithashtu, përdorimi i të dhënave sekondare është bërë me qëllim të njohjes me mënyrën e trajtimit të tematikës së njëjtë në vende të ndryshme si dhe rezultatet e dala në vende të ndryshme dhe nga autorë të ndryshëm. Përdorimi i të dhënave sekondare është një pikënisje që më ka shërbyer edhe si bazë për përpilimin e pyetsorëve. Për të realizuar këtë, burimet sekondare përfshinë: literaturë e cila konsiston në libra, artikuj shkencor nga autor kryesisht të huaj, punime online nga burime interneti, raporte të Bankës Botërore, FMN-së, burime të huaja të statistikave si: Eurostat si dhe burime të brendshme të statistikave si ASK, ATK dhe BQK.

4.1.1 Burimet dytësore në funksion të gjetjes së rezultateve nga modeli empirik

Fillimisht, zgjedhja e variablave në funksion të gjetjes së rezultateve të studimit është bazuar në modelin teorik i cili sygjeron një investigim empirik për analizimin e efektit të variablave fiskalë dhe jofiskalë ndaj rritjes ekonomike. Sipas këtij modeli i cili është

paraqitur në seksionin 2.3 në kapitullin e dytë me ekuacionin....(12) i bazuar në modelin teorik të zhvilluar nga Bleaney, Kneller dh Gemmell (2001) dhe i mbështetur në punën e Barro (1990), Barro i Sala Martin (1992, 1995), dhe Mendoza, Milessi – Ferreti dhe Asea (1997).

Variablat tona fiskale të përfshira në këtë model janë klasifikuar në të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore si dhe deficitin buxhetor. Ndërsa, variablat jofiskal janë: Norma vjetore e investimeve private ndaj PBB-së; Norma vjetore e eksporteve neto ndaj PBB-së dhe kapitali human (rritja vjetore e forcës së punës në %).

Për qëllime të studimit të ardhurat tatimore janë klasifikuar në: Të ardhurat e mbledhura nga administrata tatimore të cilat janë edhe fokusi kryesor në këtë studim, të ardhurat të mbledhura nga dogana dhe të ardhura tjera ².

Të ardhurat e mbledhura nga ATK për qëllime të këtij studimi janë ndarë në tri kategori: Të ardhurat nga tatimi në korporata, tatimi në të ardhura personale dhe tatimi në vlerën e shtuar². Të ardhurat nga dogana përbëhen nga tatimi në importe dhe akciza. Ndërsa në të ardhurat tjera bëjnë pjesë të ardhurat tatimore dhe jotatimore të qeverisë qendrore dhe lokale si: Dividenda e PTK-së, Aeroportit, Taksat koncesionale, Tantiemat, Tatimi në pronë dhe gjobat e ndryshme.

Shpenzimet janë klasifikuar në dy kategori: shpenzime të kapitalit dhe shpenzime rrjedhëse³. Të dhënat e marra në studim korrespondojnë me periudhën 2002-2015 dhe janë të llogaritura në baza vjetore. Një përshkrim i detajuar i këtyre të dhënave jepet në tabelën 16 në vijim:

² Të gjitha kategoritë e të ardhurave janë të llogaritura në raport me PBB-në, do të thotë bëhet fjalë për normat mesatare efektive të kategorive të veqanta tatimore.

³ Të dy kategoritë e shpenzimeve janë të llogaritura në raport me PBB-në


Tabela 16. Përshkrimi i variablave (të dhënave dytësore) për modelin empirik

Variabli	Përshkrimi	Burimi i të dhënave	Metodologjia
NRrPBB(p.f)	Norma vjetore e rritjes së PBB-së për frymë, në %	Banka Botrore	Banka Botrore
NTpTAK	Norma tatimore ligjore (proportionale) e TAK	ATK	Llogaritur nga autori: norma ligjore tatimore e TAK/bazën e taueshme të TAK
NTmTAP	Norma tatimore ligjore marginale e TAP	ATK	Llogaritur nga autori: norma ligjore tatimore e TAP/bazën e taueshme të TAP
NTpTVSH	Norma tatimore ligjore proporcionale e TVSH	ATK	Llogaritur nga autori: norma ligjore tatimore e Tvsh/bazën e taueshme të Tvsh
INVp, si % e PBB-së	Investimet private si % e PBB-së	BQK	Llogaritur nga autori: Investimet private në mil.€ / PBB-në miliard €
RrFP	Rritja vjetore e forcës së punës	ASK	ASK
(NemTAK)	Norma efektive mesatare (proportionale) eTAK-së	Raportet vjetore: ATK, ASK, BQK	Llogaritur nga autori: Tatimet direkte (TAK) në raport me PBB-në.
(NemTAP)	Norma efektive mesatare (progresive) e TAP-së	Raportet vjetore: ATK, ASK, BQK	Llogaritur nga autori: Tatimet direkte (TAP) në raport me PBB-në.
(NemTVSH)	Norma efektive mesatare e sheshtë e TVSH-së	Raportet vjetore: ATK, ASK, BQK	Llogaritur nga autori: Tatimet indirekte (TVSH) në raport me PBB-në.
TAtjera	Norma tatimore mesatare për të ardhura tjera , si % e PBB-së	Raportet vjetore: ASK, BQK	Llogaritur nga autori: Të ardhura tjera tatimore dhe jotatimore (Dogana, aksiza, tatimi në pronë, dividenda, tantiema) në raport me PBB-në.
ShProd	Shpenzimet productive(kapitale), si % e PBB-së	Raportet vjetore: ASK, BQK	Llogaritur nga autori: Shpenzimet kapitale në raport me PBB-në.
ShIProd	Shpenzimet joproductive(rrjedhese), si % e PBB-së	Raportet vjetore: ASK, BQK	Llogaritur nga autori: Shpenzimet rrjedhëse në raport me PBB-në.
DB	Deficiti buxhetor, si % e PBB-së	Raportet vjetore: BQK	BQK
EXn	Eksportet neto, si % e PBB-së	Raportet vjetore: ASK	ASK


Burimi: Autori

Grafikët e variablave të përfshira në analizën ekonometrike


Grafiku 6: Norma tatimore e tatimit në korporata




Grafiku 7: Tatimi në korporata si % e PBB-së




Grafiku 8: Norma tatimore e tatimit në TAP




Grafiku 9: Tatimi në TAP në raport me PBB-në




Grafiku 10: Norma vjetore e PBB-së për frymë




Grafiku 11 : Tatimi në Tvsh në raport me PBB-në




Grafiku 12: Të ardhurat doganore si % PBB-së




Grafiku 13: Investimet private si % e PBB-së




Grafiku 14: Të ardhurat tjera si % e PBB-së




Grafiku 15: shpenzimet rrjedhese si % e PBB-së




Grafiku 16 shp. Kapitale në raport me PBB-në



Grafiku 17: Exportet neto në raport me PBB-në



Grafiku 18: Deficiti buxhetor në raport me PBB-në Grafiku 19: Rritja vjetore e forces së punës



Burimet: Autori

Të dhënat do të përpunohen me anë të programit Eviews. Modeli që do të përdoret për analizën ekonometrike është modeli i regresionit i ashtuquajtur modeli OLS apo i katrorëve më të vegjël, mëqenëse të dhënat e përfshira në analizë kanë seri kohore të shkurtër. Përpara se të kalohet në analizën empirike të modelit të dhënat do të testohen në lidhje me stacionaritetin e tyre. Për të kryer këtë test është përdorur testi Augmented Dickey Fuller (ADF). Ky test është përdorur për të përcaktuar nëse secila seri e variablave ka rrënjë njësi – pra është jostacionare apo nuk ka rrënjë njësi dhe është stacionare. Në qoftë se variablat e përfshira në një model regresi nuk janë stacionare ato nuk janë të vlefshme, dhe nuk do të jetë e mundur të bëhen testime të hipotezave për to. Seria e cila testohet dhe nuk ka rrënjë njësi, ajo seri është stacionare dhe shënohet me $I(0)$. Ndërsa, nëse seria ka rrënjë njësi do të thotë është jostacionare ajo duhet të diferencohet deri sa të bëhet stacionare. Nëse seria e cila është jostacionare diferencohet njëherë dhe kthehet në seri stacionare, quhet seri e integruar e rendit të parë dhe shënohet me $I(1)$. Ndërsa, nëse seria diferencohet njëherë dhe nuk kthehet në stacionare ajo duhet të testohet prapë dhe nëse pas testimit të dytë rezulton stacionare shënohet me $I(2)$. Për të vërtetuar nëse seria është stacionare testohen Hipoteza

zero (H_0)- seria ka rrënjë njësi - është jostacionare) dhe Hipoteza alternative (H_a) - seria nuk ka rrënjë njësi- është stacionare). Nëse hipoteza H_0 hidhet poshtë seria është stacionare, pra në këtë rast fiton H_a (alternative). Ndërsa, nëse H_0 fiton atëherë seria testohet përsëri do të thotë diferençohet deri sa H_0 të hidhet poshtë. Pasiqë, variablat të jenë testuar për stacionaritet zhvillohet analiza e regresionit me metodën -OLS. Për të vlersuar se sa i qëndrueshëm është modeli i aplikuar, gjithashtu do të kryhen disa teste për ta testuar atë, mëqenëse një model regresioni kërkon që të plotësohen disa nga supozimet e Gujaratit për modelin OLS (Gujarati, D., 2004: 65-76) të cilat do të paraqitën në vijim:

- Vlerë të lartë të $R^2 > 60\%$. Kjo vlerë tregohet në analizën e regresionit.
- Mungesë të korrelacionit serial, pra mbetjet në dy periudha të ndryshme të mos jenë të korreluara me njëra tjetrën do të thotë duhet të vlejë barazimi:

$\text{Corr}[\mu_t, \mu_s|X]=0$ do të thotë për çdo $t \neq 0$. Nëse ky supozim nuk plotësohet, atëherë midis mbetjeve ka korrelacion serial apo autokorrelacion pasi që janë të lidhura në kohë.

- Mbetjet duhet të mos jenë hetroskedastike por homoskedastike. Do të thotë se varianca e gabimit e kushtëzuar nga variabli shpjegues X të jetë e njëjtë për çdo periudhë t . Kjo nënkupton se varianca e gabimit duhet të jetë konstante dhe të vlejë parimi i homoskedasticitetit.
- Mbetjet duhet të kenë shpërndarje normale.
- Nuk duhet të ketë kolinaritet (Multikolinariteti) perfekt në mes të variablave të pavarur (lidhje jo, por jo perfekte).

Në të gjitha supozimet e lartcekura kushti është që të fitoj hipoteza 0 ndërsa ajo alternative të bie poshtë si dhe probabilitetet (p-value) duhet të jenë më të mëdha se 0.1 ose 10%.

Për të provuar testin e korrelacionit serial (autokorrelacionit) është kryer testi: Breusch-Godfrey Serial Correlation LM Test. Për të testuar heteroskedasticitetin është përdorur testi: Heteroskedasticity Test: Breusch-Pagan-Godfrey dhe White Test. Ndërsa për të vërtetuar nëse shpërndarja e mbetjeve është normale janë përdorur Testet Histograma dhe Jarqua Bera.

4.1.2 Burimet parësore – në funksion të gjetjes së rezultateve të studimit

Për të identifikuar faktorët që ndikojnë në performancën e ulët të të ardhurave tatimore të shkaktuar kryesisht nga evazioni fiskal dhe ekonomia joformale në Kosovë janë përdorur të dhëna primare, mbledhja e të cilave është realizuar përmes pyetsorëve drejtuar bizneseve në Kosovë.

Popullata dhe kampioni i studimit

Përzgjedhja e numrit dhe llojit të mostrës së bizneseve të përfshira në hulumtim është bërë duke e përshtatur numrin e bizneseve që operojnë në qytete të ndryshme dhe sektor të ndryshëm. Në fokusin e këtij studimi janë bizneset që operojnë në Kosovë, pavarësisht llojit kryesor të veprimtarisë biznesore të tyre prodhuese, shërbyese apo tregtare. Popullata e studimit përfshinë numrin e bizneseve aktive që operojnë në Kosovë. Ky numër është nxjerrë nga të dhënat e ATK-së dhe përfshinë shifrën prej 69,864 biznese aktive që kanë deklaruar transaksionet e tyre deri në tremujorin e tretë të vitit 2014. Përzgjedhja e bizneseve individualisht pët t'u bërë pjesë e intervistës është bërë në mënyrë të rastësishme, por e selektuar me qëllim ruajtjen e proporcioneve të popullatës për nga pikëpamja e sektorëve dhe regjionit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit. Hulumtimi është bërë me një

përzgjedhje prej 779 biznese, ku 776 prej tyre kanë pranuar t'i përgjigjen intervistës ndërsa, 3 të tjera refuzuan të bëhën pjesë e hulumtimit.

Për nxjerrjen e kampionit nga tërsia e popullatës në këtë studim është marr në konsideratë formula e Taro Yamane (Yamane, 1967). Madhësia e mostrës (kampionit) të zgjedhur sipas formulës së Yamane ka nivel besueshmërie prej 95% ndërsa madhësia e gabimit është konsideruar të jetë 5%.

Formula e Yamane: $n = N / (1 + N \cdot e^2)$

Ku, n = madhësia e mostrës apo të anketuarve

N = madhësia e popullatës

e = niveli i saktësisë (95% niveli i besueshmërise ose 5%
niveli i gabimit)

Në rastin konkret kemi: $n = 69864 / [(1) + (69864 \cdot 0.05^2)]$

$n = 69864 / [(1 + 174.66)]$

$n = 397.72$

Megjithatë, madhësia e mostrës prej 779 të anketuarve në këtë studim është marr sa dyfishi i mostrës së llogaritur më formulën e lartshënuar me qëllim të arritjes së nje niveli sa më të lartë besueshmërie për shkak të natyrës së ndjeshme të tematikës së shtjelluar në studim.

Pyetësori

Pyetësori i përdorur në këtë studim është i përbërë nga: 3 seksione, me gjithesej 24 pyetje dhe 94 nënpyetje të cilat ofrojnë të dhëna cilësore dhe sasiore në çështjet që do të trajtohen në seksionet si në vijim: Seksioni i parë tenton të japë informacion rreth karakteristikave themelore të bizneseve të përfshira në studim dhe të dhëna bazike për personat e përfshirë në aktivitet biznesi. Në seksionin e dytë, informacionet e kërkuara kanë për qëllim të japin

një pasqyrim rreth prezencës së evazionit fiskal dhe ekonomisë joformale, arsyet, shkaktarët dhe pengesat në afarizëm që i shtyejnë bizneset dhe të punsuarit e tyre të krijojnë shmangie tatimore dhe të bëhen pjesë e ekonomisë së zezë. Seksioni i tretë jep informacion për perceptimin nga ana e bizneseve, rreth dukurive të ryshfetit dhe korrupsionit të zyrtarëve tatimor si dhe shkaqeve dhe pasojave të tyre. Një pjesë e madhe e pyetjeve janë të shkallëzuara në formën e shkallëve Likert, një pjesë tjetër e pyetjeve janë në formën e shkurtër të kërimit të informacioni me Po dhe Jo, ndërsa pjesa më e madhe e pyetjeve kërkon informacion më të detajuar.

Pyetsori është hartuar bazuar në një pyetsor të zhvilluar dhe publikuar nga **INSTAT, 2010** por, me disa përmirësime dhe reduktime duke e përshtatur me tematikën e veçantë të studimit.

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave

Para se të fillohet me mbledhjen e të dhënave, pyetsori është testuar për korrektësi nga ana e bizneseve dhe për ndonjë vërejtje eventuale të mundëshme. Kështuqë, 50 kopje të pyetsorit janë shpërndarë tek bizneset përmes kontabilistëve të tyre, ku vetëm 12 nga to janë plotësuar dhe atë duke mos dhënë përgjigje në qështjet kryesore si evazoni fiskal dhe korrupsioni edhe pse, ata janë njohtuar se të dhënat do të jenë konfidenciale. Pra, vërejtja ka qenë hezitimi për t'u përgjigjur për shkak të natyrës së ndjeshme të tematikës që trajton pyetsori. Për këtë arsye, pyetsori u zhvillua përmes intervistave ballë për ballë tek bizneset pra duke i shmangur format tjera si e-mailat dhe lënja e pyetsorit biznesit apo kontabilistit. Pra, për zhvillimin e intervistës është përdorë metoda e intervistimit ballë për ballë mirëpo disa nga pyetjet janë shtruar indirekt për shkak të ndjeshmërisë së tematikës, në mënyrë që

informacionet e marra të jenë sa më të sakta. Pyetsorët janë zhvilluar kryesisht me pronar dhe menaxher të bizneseve, për faktin se këta e dinë më së miri gjendjen e biznesit. Mëqenëse, kemi të bëjmë kryesisht më të dhëna cilësore, rezultatet që kanë rrjedhë nga pyetsorët fillimisht do të paraqiten në formë tabelare dhe grafike përmes programit EXEL më metodën statistikore përshkruese.

Analiza përshkruese- Të dhënat janë përpunuar dhe shfaqur në formë të grafikëve. Kjo lloj analize përshkruese përmes grafikëve është bërë me qëllim që përmes tyre të pasqyrohet rezultati i përgjithshëm i gjetjeve që dalin nga pyetsori. Përmes kësaj analize rezultatet janë paraqitur të shprehura në vlera numerike dhe në %.

4.2 Përmbledhje e kapitullit

Në kapitullin e katërt janë shpjeguar metodat dhe metodologjia e hulumtimit, burimet e informacionit dhe mënyrën e mbledhjes së të dhënave për të kryer hulumtimin si dhe llojet e analizave të përdorura për përpunimin e të dhënave.

KAPITULLI V: Rezultate dhe diskutime

5.1 Analiza empirike dhe interpretimi i rezultateve

Në këtë kapitull do të paraqiten analiza empirike dhe interpretimi i rezultateve të saj. Kjo është shumë e nevojshme pasi që shërben për t'i kthyer përgjigje pyetjeve të ngritura si dhe për të vërtetuar apo hedhur poshtë hipotezat e ngritura që në fillim të këtij punimi.

5.1.1 Analiza e testimit të modelit

Fillimisht, duke u bazuar në hipotezat e ngritura dhe në mbështetje të tyre të cilat i referohen ndryshimit të normave tatimore dhe efektit të tyre në krijimin e të ardhurave për buxhetin e shtetit, pra se cili është efekti i tyre në raport me PBB-në dhe rritjen ekonomike të Kosovës. Për të parë këtë është zhvilluar një analizë empirike në kuadër të së cilës janë kryer tri analiza regresioni rezultatet e testimit të të cilave do të prezentohen në vazhdim.

Testi i rrënjës njësi - Stacionariteti

Stacionariteti i variablave të përfshira për analizë në këtë studim siç kemi shpjeguar në kapitullin paraprak është testuar përmes testit Augmented Dickey- Fuller (ADF) Rezultatet e këtij testi do të përmblihdhen në tabelën 5.1 në vijim. Rezultatet në tabelë tregojnë se një numër i vogël i serive variablave të modelit tonë ekonometrik janë stacionare në nivel $I(0)$. Ndërsa, pjesa më e madhe e serive të variablave janë bërë stacionare pas integritit në rëndë të parë $I(1)$. Do të thotë seritë e variablave të cilat nuk kanë rrënjë njësi probabiliteti tyre (p-value) është më e vogël se 0.05 apo 5 % ndërsa, vlera absolute e t-statistik duhet të jetë më e madhe se vlerat absolute të t- kritik në nivelet 1, 5 dhe 10 %. Si përfundim mund të thuhet se të gjitha variablat mund të përdorën për analizë me anë të modelit OLS.

Tabela 5.1 Përmbledhje e rezultateve nga testet e stacionaritetit të variablave

Përshkrimi i variablave	Metodo-logjia/	Stacionariteti	P-value test ADF/ P-value Equation ADF	t-statistik	t-kritik/nivel
TAK/PBB-së	ADF	I(1) None	0.0263/0.0421	-2.298739	-1.974028/5%
TAP/PBB-së	ADF	I(0) Constant	0.0156/0.0039	-3.850238	-3.144920/5%
TVSH/PBB-së	ADF	I(1) Constant	0.0058/0.0012	-4.460693	-3.144920/5%
NPTAK	ADF	I(1) Constant	0.0296/0.0061	-3.464102	-3.144920/5%
NPTAP	ADF	I(1) Constant	0.0296/0.0061	-3.464102	-3.144920/5%
NPTVSH	ADF	I(1) Constant	0.0296/0.0061	-3.464102	-3.144920/5%
PBBVJF	ADF	I(0) Constant- Linear Trend	0.0005/0.0000	-7.065685	-3.828975/5%
Tdog/PBB	ADF	I(0) Constant-	0.0194/0.0048	-3.721334	-3.144920/5%
Tatjeta/PBB	ADF	I(1) Constant	0.0010/0.0002	-5.603034	-3.144920/5%
ShpRr/PBB	ADF	I(1) Constant	0.0284/0.0058	-3.492924	-3.144920/5%
Shpk/PBB	ADF	I(1) None	0.0174/0.0294	-2.502080	-1.974028/5%
InvP/PBB	ADF	I(1) Constant	0.01174/0.049	-3.846673	-3.175352/5%
Exneto/PBB	ADF	I(1) None	0.0165/0.0281	-2.527899	-1.974028 5%
DB/PBB	ADF	I(0) Constant	0.0068/0.0028	-4.357231	-3.144920/5%
RrvFP	ADF	I(1) Constant	0.0045/0.0015	-4.732576	-3.175352/ 5%

Burimi: Autori

Duke u nisur nga ekuacioni nr.12, fq. 58 në këtë punim i cili shpjegon teorikisht ndikimin e variablave fiskal dhe jofiskal në rritjen ekonomike kjo lidhje është testuar duke krijuar 3 ekuacione regresi të cilat tregojnë ndikimin e madhësisë së normave tatimore në krijimin e të ardhurave nga tatimet si pjesë përbërëse e të ardhurës kombëtare si dhe ndikimin e këtyre të ardhurave dhe variablave tjera fiskale dhe jofiskale në rritjen ekonomike.

Ekuacioni i parë merr parasysh ndikimin e normës tatimore të reduktuar të tatimit nga korporatat në krijimin e kësaj kategorie të ardhurash në raport me Produktin e Brendshëm Bruto. Ekuacioni i dytë merr parasysh ndikimin e normës tatimore të reduktuar të tatimit nga të ardhurat personale në krijimin e kësaj kategorie të ardhurash në raport me Produktin e Brendshëm Bruto. Ndërsa, ekuacioni i tretë tregon ndikimin variablave fiskale përfshirë kategoritë e ndryshme të të ardhurve dhe shpenzimeve publike në raport me PBB si dhe ndikimin e variablave tjera jofiskale në rritjen ekonomike. Përpara se të kalohet tek vlersimi i ekuacioneve të regresit do të tregohen rezultatet e testimit të modelit për të parë nëse plotësohen supozimet të cilat përcaktojnë se sa i qëndrueshëm është modeli i përdorur i regresionit OLS. Për të vërtetuar këtë në vazhdim do të paraqiten dhe shpjegohen të gjitha rezultatet që kanë dalë nga testet e kryera për këtë qëllim:

Testimi i Vlerës R^2 (R Square)

Përmes këtij testi në vazhdim do të tregohet masa e fuqisë shpjeguese të modelit për secilin ekuacion regresi. Ky test na tregon se sa mund të shpjegohet variacioni i variablilit të varur, nga variablat e pavarur. Sa më e madhe të jetë kjo vlerë, aq më e madhe është fuqia shpjeguese e saj. Për dy ekuacionet e para të regresit këto vlera kanë rezultuar tejjet të ulëta 0.07 %, që do të thotë se variablat e varur: të ardhurat nga tatimi nga korporatat dhe të ardhurat nga tatimi në të ardhurat personale si pjesë të Prodhimit të Brendshëm Bruto shpjegohen shumë dobët nga normat tatimore të tyre edhe për shkak se ato norma janë shumë të ulëta. Ndërsa, për ekuacionin e tretë të regresionit, variacioni i variablilit të varur shpjegohet kënaqshëm nga variablat e pavarura dhe rezultatet e tyre në mënyrë më të detajuar do të shpjegohen gjatë analizës së regresionit në vijim për secilin ekuacion.

Testi i korrelacionit serial -LM Test

Për të pëmbushur një nga pesë supozimet tjera të një modeli të mirë regresioni është zhvilluar edhe ky test i cili supozon se nuk duhet të ketë korrelacion midis mbetjeve të variablave në periudha të ndryshme kohe (seri). Për të vërtetuar këtë janë testuar $H_0: \rho=0$ që do të thotë se mbetjet nuk kanë korrelacion serial dhe $H_a: \rho \neq 0$, pra ka korrelacion serial. Testi LM është përdorur për të bërë vërtetimin apo hedhjen poshtë të këtyre hipotezave dhe për të bërë akoma më të fuqishme vërtetimin e këtij supozimi është zhvilluar edhe Testi i Autokorrelacionit (AC) i cili ka dhënë po të njëjtat rezultate sikurse LM Test.

Testet e korrelacionit për rastin e parë të modelit tonë të regresionit (OLS) kanë rezultuar me p-value prej 0.0321 do të thotë më e vogël se 0.1 apo 10 % siç supozohet dhe me këtë vërtetohet se mbetjet në këtë model kanë korrelacion serial, pra H_0 nuk fiton (tabelat në shtojcë të punimit. Ndërsa, testet e korrelacionet për të dy modelet tjera të OLS të përfshira në analizë kanë rezultuar me P-value më të madhe se 0.1 apo 10% që do të thotë se mbetjet nuk kanë korrelacion serial, pra fiton H_0 ndërsa, hidhet poshtë H_a (Tabelat në shtojcë).

Testi i Heteroskedasticitetit - Breusch-Pagan-Godfrey (BPG) dhe White Test

Karakteristikat e një modeli të qëndrueshëm regresioni supozojnë mbetje jo heteroskedastike pra, mbetjet duhet të jenë homoskedastike që nënkupton se varianca e gabimit të jetë konstante. Për të gjykuar nëse mbetjet janë heteroskedastike apo homoskedastike testojmë përseri hipotezat $H_0: \rho=0$ dhe $H_a: \rho \neq 0$, pra e ndryshme nga zero. Për të vërtetuar apo hedhur poshtë hipotezat e ngritura në lidhje me supozimin në fjalë është përdorur testi i heteroskedasticitetit BPG dhe Testi White. Rezultatet e tyre tregojnë se për analizën e parë të regresionit mbetjet kanë dalë të jenë heteroskedastike dhe jo homoskedastike që do të thotë se bie poshtë H_0 . Ndërsa në analizat tjera regressive modeli

ka dal të jetë i qëndrueshëm meqenëse variancat e gabimit kanë dalë të jenë konstante me p-value me të lartë se 5%. Pra mbetjet janë homoskedastike me ç'rast fiton H_0 dhe H_a hidhet poshtë.

Testi i normalitetit – Histograma dhe Jarqua Bera

Nëpërmjet testit të normalitetit i cili gjithashtu është një nga supozimet e modelit OLS, mbetjet janë testuar nëse kanë apo jo shpërndarje normale. Pas aplikimit të testit, vlerat e Jarqua Bera dhe probabilitetet e saj p-value > 0.05 % (më e madhe se 5%) për të gjitha analizat tona të regresionit kanë treguar shpërndarje normale të mbetjeve, pra fiton H_0 .

Multikolinariteti

Fare në fund për të gjykuar nëse variablat e pavarura të ekuacionit të shumfishtë (ekuacionit 3) të regresionit janë apo jo të korreluara me njëra tjetrën, ato janë testuar për multikolinaritet. Nga rezultatet e këtij testi ka dal se disa nga variablat e pavarura të ekuacionit tonë kanë kolinaritet të lartë mes tyre (tabela e multikolinaritetit në shtojcë), p-value > 0.05 , me ç'rast variablat të cilat kanë pasur vlerë më të madhe kolinariteti se tjetra janë hequr nga modeli , meqenëse ato mund të shkatërrojnë edhe vlerat e variablave e rëndësishme të modelit. Kjo është aplikuar deri në shfaqjen e modelit më të mirë.

Meqenëse rezultatet nga testet e paraqitura më lartë tregojnë se supozimet e modelit tonë OLS, më përjashtim të ekuacionit të parë për të cilin supozimet e një modeli të mirë nuk janë plotësuar ndërsa, për të dy ekuacionet tjera supozimet e modelit OLS plotësohen, tani mund të kalohet në ndërtimin e ekuacioneve të regresit dhe interpretimin e rezultateve të tyre.

5.2 Interpretimi i rezultateve dhe diskutimi i tyre

Pas përpunimit të të dhënave serike me anë të metodës OLS kalojmë në interpretimin dhe diskutimin e rezultateve për secilin nga ekuacionet e modelit tonë.

Efektet e normes tatimore të TAK në të ardhurat nga TAK, si % e PBB-së

Për të bërë të njohura efektet e reduktimit të normes tatimore të tatimit në të ardhurat e korporatave në të ardhurat e realizuara nga ky lloj tatimi në raport me Produktin e Brendshëm Bruto në kuadër të analizës empirike në këtë punim është zhvilluar analiza e parë e regresionit për këtë qëllim në të cilën norma tatimore proporcionale e të ardhurave nga korporatat paraqet variablin e pavarur, ndërsa të ardhurat nga korporatat në raport me PBB-në është variabli i varur në këtë analizë

Tabela 5.2: Analiza I e OLS-së

Variabli i pavarur	Koeicientët	Statistika-t	P-value
Konstantja C	1.302857	2.801549	0.0160
NPTAK	0.271429	0.092284	0.9280
R ²	0.000709	Durbin Watson (DW)	0.379228

Burimi: Llogaritjet e autorit

Nga analiza e OLS-së në tabelen 5.2 shohim se nga rezultatet e përfituara R² (0.000709) është vlerë relativisht shumë e ulët që tregon se vetëm 0.07% e të ardhurave nga tatimi në korporata në raport me PBB-në shpjegohen nga norma tatimore e këtyre të ardhurave. Poashtu shohim një vlerë shumë të lartë të p-value për NPTAK që do të thotë një vlerë e parëndësishme të saj në variablin e varur. Kjo është treguar edhe nga testet e korrelacionit

serial dhe testit të heteroskedasticitetit të cilët rezultuan të parëndësishëm për qëllime të kësaj analize.

Nëse i referohemi vlerave të koeficienteve në tabëlen 5.2, ekuacioni i modelit merr formën:

$$Tak_Pbb = 1.302857 + 0.271429 NPTAK$$

Edhe pse analiza e regresit tregoi rezultate të parëndësishme për të shpjeguar variacionin e TAK si % e PBB-së nga normat tatimore të saj prapë se prapë duke i'u referuar vlerave të koeficientëve themi se një rritje prej 1 % në normen tatimore të TAK-së do të rriste këtë kategori të ardhurash prej 0.27 % në raport me PBB në.

Efektet e normes tatimore të TAP në të ardhurat nga TAP, si % e PBB-së

Analiza e dytë e regresionit në këtë punim është zhvilluar për të bërë të njohura efektet e reduktimit të normes tatimore progresive (margjinale) të tatimit në të ardhurat personale (NPTAP) në të ardhurat e realizuara nga ky lloj tatimi në raport me Produktin e Brendshëm Bruto ku norma tatimore marginale e të ardhurave personale paraqet variablin e pavarur në këtë rast, ndërsa të ardhurat nga tatimi në të ardhura personale i llogaritur në raport me PBB-në është variabli i varur në këtë analizë. Rezultatet e kësaj analize do të paraqiten në tabelën në vazhdim.

Tabela 5.3: Analiza e II e OLS-së

Variabli i pavarur	Koeicientët	Statistika-t	P-value
Konstantja C	1.737143	9.043045	0.0000
NPTAP	-0.114286	0.094588	0.9262
R ²	0.000745	Durbin Watson (DW)	1.988843

Burimi: Llogaritjet e autorit

Nga analiza e zhvilluar me metoden OLS-së në tabelën 5.3 shohim se nga rezultatet e përfituara R^2 (0.000745) është vlerë shumë e ulët që tregon se vetëm 0.07% e të ardhurave nga tatimi i të ardhurave personale në raport me PBB-në mund të shpjegohen nga norma tatimore e këtyre të ardhurave. Poashtu shohim një vlerë shumë të lartë të p-value për NPTAP që do të thotë vlerë e parëndësishme e saj në variablin e varur. Edhe pse testet e korrelacionit serial, heteroskedasticitetit dhe shpërndarjes normale treguan vlera të rëndësishme të modelit të përdorur për qëllime të kësaj analize prapë se prapë analiza e regresit tregoi rezultate të parëndësishme për të shpjeguar variacionin e tatimit në të ardhura personale si % e PBB-së, nga normat tatimore të saj.

Nëse i referohemi vlerave të koeficienteve në tabelën 5.3, ekuacioni i modelit merr formën:

$$\text{Tap_Pbb} = 1.737143 - 0.114286 \text{ NPTAP}$$

Duke i'u referuar vlerave të koeficientëve, ekuacioni jonë tregon se një rritje prej 1 % në normen tatimore marginale të TAP-së do të ulë këtë kategori të ardhurash prej 0.11% në raport me PBB në.

Efektet e variablave fiskale dhe jofiskale në rritjen ekonomike

Efektet e variablave fiskale dhe jofiskale të llogaritura në raport me PBB-në janë bërë të njohura në analizën e tretë regressive të zhvilluar për këtë qëllim, ku variablat fiskale si: norma tatimore e TAK-së, norma tatimore e TAP-së, norma tatimore e TVSH-së, norma tatimore e të ardhurave doganore, të ardhurat tjera tatimore dhe jotatimore, shpenzimet kapitale, shpenzimet rrjedhëse dhe deficitit buxhetor paraqesin variablat fiskale në këtë analizë dhe janë variabla të pavarur ndërsa, investimet private, eksportet neto dhe rritja e forcës së punës paraqesin variablat jofiskale dhe të pavarura për këtë analizë. Ndërsa,

PBB-ja për frymë është variabli i varur në këtë analizë. Rezultatet e kësaj analize do të paraqiten në tabelën në vazhdim. Siç do të tregohet edhe në tabelë asnjëri nga variablat fiskale të paraqitura më lartë nuk ka treguar efekt në rritjen ekonomike ndërsa pas heqjes nga modeli të variablave të cilat kanë pasur kolinearitet të lartë mes vete që është një nga supozimet e analizës së regresionit që të mos ketë kolinearitet përfekt mes variablave shpjeguese analiza jonë është zhvilluar vetëm për variablat e mbetura si të rëndësishme.

Tabela 5.4: Analiza e III e OLS-së

Variabli i pavarur	Koeicientët	Statistika-t	P-value
Konstantja C	-26.47766	- 2.233791	0.0606
NPTAK	3.913396	2.578614	0.0365
TDOG_PBB	1.520711	2.260838	0.0583
SHPK_PBB	0.908880	2.586179	0.0361
R ²	0.583180	Durbin Watson (DW)	2.896462

Burimi: Llogaritjet e autorit

Pas përpunimit të të dhënave me anë të metodës OLS ekuacioni jonë i paraparë për paraqitjen e rezultateve të kësaj analize merr formën:

$$\text{PBB}_f = -26.5 + 3.91\text{NPTAK} + 1.52 \text{TGOG_PBB} + 0.91\text{SHPK_PBB}$$

Nisur nga vlera e koeficientit të përcaktueshmërisë në zhvillimin e kësaj analize tregohet se vlera R² (0.583180) tregon një vlerë të kënaqshme për rëndësinë e modelit që tregon se 58.32% e rritjes së PBB-së për frymë mund të shpjegohen nga variablat e përfshira në analizë. Poashtu shohim vlerë të ulët të p-value për variablat e mbetura në analizë do të thotë vlerë e rëndësishme e tyre në variablin e varur. Poashtu, testet e korrelacionit serial,

heteroskedasticitetit dhe shpërndarjes normale treguan vlera të rëndësishme të modelit për të shpjeguar variacionin e variablilit të varur nga ato të pavarura. Ndërsa, për të parë efektet e secilit variabël të pavarur në rritje do të tregohet në vazhdim.

Duke i'u referuar vlerave të koeficientëve dhe vlerës së p-value , ekuacioni jonë tregon se një rritje prej 1 % në normen tatimore të TAK-së do të rrisë PBB-në për frymë për 3.9%. Pastaj, shohim se një rritje prej 1 % në normen tatimore të të ardhurave doganore do të rrisë PBB-në për frymë për 1.5%. Ndërsa, një rritje prej 1 % në normen e shpenzimeve kapitale do të rrisë PBB-në për frymë për 0.9 %.

5.3. Analiza përshkruese e gjetjeve nga Pyetësi I

Me qëllim të ardhjes në ndihmë këtij studimi, pjesa në vazhdim paraqet të gjeturat kryesore të pyetësit, i zhvilluar me 776 biznese në Kosovë, qëllimi kryesor i të cilit është përcaktimi i nivelit të ekonomisë joformale dhe evazionit tatimor (të krijuar nga bizneset dhe personat e punsuar në to) si dhe shkaktarëve që i shtyen bizneset dhe personat për t'u bërë pjesë e këtyre dukurive. Të gjeturat kryesore që kanë rrjedhë nga ky pyetësorë do të paraqitën në vazhdim.

Seksioni I: Karakteristikat e personave të përfshirë në biznes dhe të vetë bizneseve

Nga, gjithsej 779 bizneset e përfshira në intervistë, 776 prej tyre i janë përgjigjur pozitivisht kërkesës për intervistim pra, vetëm tri biznese kanë refuzuar t'i përgjigjen intervistës. Ndërsa, personat e intervistuar dhe bizneset e tyre kishin karakteristikat e mëposhtme:

Pyetësi është zhvilluar dhe informatat janë marr kryesisht nga pronarët e bizneseve në 92.50 % të rasteve, nga menaxherët në 4.00 %, nga kontabilistët 2.40 % ndërsa, nga të punsuarit 1.10 % të rasteve. Synimi që intervistat të zhvillohen kryesisht me pronarët ose menaxherët në njerën anë ka qenë për shkak se ata e dinë më së miri gjendjen e biznesit,


ndërsa në anën tjetër, intervistimi i të punsuarve është i vështirë të arrihet, jo vetëm për shkak të angazhimit në punë por edhe për shkak se ata janë të kufizuar nga pundhënësit e tyre që të thojnë realitetin. Rezultatet që dalin nga hulumtimi në lidhje me vitet e angazhimit të këtyre personave në biznes tregohet se vetëm 0.90 % e bizneseve janë të përfshirë në aktivitet biznesi në më pak se një vit. 7% e bizneseve kanë një deri në pesë vite punë. Mbi 17 % e bizneseve kanë nga 5 deri në 10 vite punë. Ndërsa, shumica e bizneseve, përafërsisht 75 % e bizneseve kanë më shumë se 10 vite punë, që do të thotë se njohuritë dhe përvoja e tyre në lidhje me informalitetin dhe evazionin fiskal në drejtim të shmangies tatimore nuk mungon.

Sa i përket gjinisë së personave të përfshirë në hulumtim, gjegjësisht personave të përfshirë në aktivitet biznesi, të dhënat nga hulumtimi tregojnë se bizneset në Kosovë udhëhiqen në më shumë se 95 % të rasteve nga pronaret meshkuj dhe vetëm në më pak se 5% nga pronarët femra, pra, pjesmarrja e femrave në të bërit biznes është shumë e vogël në krahasim me meshkujt. Të dhënat në lidhje me shkallën e përgatitjes shkollore të personave të përfshirë në aktivitet biznesi në Kosovë, tregojnë se mbi 86 % e tyre janë në kategorinë e arsimimit të mesëm, mbi 12% e tyre kanë të përfunduar arsimin e lartë, ndërsa një kategori prej mbi 1% janë me përgatitje të lartë pasuniversitare. Ndërsa, të gjeturat në lidhje me moshën e personave të përfshirë në biznes në Kosovë, tregojnë si në vijim: Mosha nga 40-50 vjeq – përfaqëson rreth 68% e të intervistuarve; Mosha 30-40 vjeq është e angazhuar në biznes, me një pjesmarrje rreth 24%; Mosha 18- 30 vjeq është shumë pak e angazhuar në udhëheqje të biznesit, diku mbi 1% siç tregon opinioni i të intervistuarve, ndërsa, mbi 7 % e personave që janë të përfshirë në aktivitete biznesi i takojnë moshës mbi 50 vjeq.

Intervistat sipas regjioneve janë zhvilluar në regjionin e Prishtinës 43.4%, Prizren 13.2%, Pejë 14.5 %, Gjakovë 10.8%, Gjilan 9.5 % , Ferizaj 9.1%, dhe Mitrovicë 7.5.

Sa i përket aktivitetit kryesor ekonomik të bizneseve të përfshira në hulumtim rezultatet janë të paraqitura në grafikët në vijim.

Grafiku 5.1 Llojet e ndryshme të aktiviteteve të bizneseve, të përfshira në tregti me shumicë e pakicë, (në %)




Burimi: Autori

Rezultatet e mësipërme japin detaje mbi natyrën e veprimtarisë së bizneseve të përfshira në hulumtim, ku tregohet se pjesa më e madhe e bizneseve, 31% e tyre i takojnë veprimtarive shërbyese, përfshirë ato hoteliere, transportuese dhe profesionet e ndryshme, 30 % janë të angazhuara në tregti me pakicë, pastaj 16 % e bizneseve të angazhuara në tregti me shumicë e pakicë, të pasuara nga prodhimi dhe përpunimi që përfaqësonin 10 % të bizneseve pjesëmarrëse. Ndërsa, numri i bizneseve të përfshira në hulumtim nga sektori i ndërtimit është 6% të bizneseve, bujqësia 2% dhe së fundmi patundëshmëria më 0.5%.

Për të pasur një pasqyrë më të saktë rreth qëllimit të hulumtimit, që është përfshirja e bizneseve në evazion fiskal dhe ekonomi joformale, është bërë edhe klasifikimi më i detajuar i llojeve të aktiviteteve për disa veprimtari biznesi, siç do të tregohet poashtu në grafikun 5.6 (B). Siç tregojnë të dhënat në këtë grafik, tek personat apo subjektet e intervistuar që ushtrojnë veprimtari biznesi me shumicë e pakicë, dominojnë aktivitetet e tregtisë ushqimore, joushqimore dhe veshmbathjet me nga 29% pjesmarrje, të pasuara nga shitja e materjalit ndërtimor dhe shërbimet me ushqim e pije (Pastiqeritë dhe bukëpjekësit).

Grafiku 5.2 Bizneset e përfshira vetëm në tregti me pakicë dhe shërbime profesionale, në %




Burimi: Autori

Sa i përket llojeve të aktiviteteve që ushtrojnë bizneset e intervistuar të angazhuara në shitje vetëm me pakicë, tregohet se dominon veprimtaria e veshmbathjeve me 43 %, e pasuar nga shërbimet farmaceutike me 22 %, ushqimi dhe pijet me 18 %, mobileria 9% dhe libraritë me 8%. Ndërsa, llojet e aktiviteteve të bizneseve të angazhuara në shërbime profesionale që dominojnë këte fushë janë: Kujdesi shëndetësor, 24%; shërbimet e avokaturës dhe riparimi i automjeteve me nga 17%, të pasuara nga shërbimet e kontabilitetit dhe shërbimet kompjuterike me nga 13, përkatësisht 12%, ndërsa shërbimet tjera si autoshkolla me 5% pjesmarrje në këto aktivitete.

Seksioni II: Shkalla e informalitetit dhe Evazionit fiskal

Për të vënë në pahë shkallën e mundshme të informalitetit dhe shmangies tatimore nga të ardhurat e fuqisë punëtore, të intervistuarve u është kërkuar të përgjigjen në lidhje me atë se: Sa është numri i të punsuarve aktual në bizneset e intervistuar dhe sa prej tyre janë të lajmëruar për qëllime të pagesës së tatimit në paga dhe kontributeve pensionale?, dhe përgjigja që kanë dhënë tregon se nga 5920 persona sa është numri total i të punsuarve tek bizneset e përfshira në hulumtim, 1882 apo 31.8% prej tyre janë të punsuar joformal, do të thotë nuk janë të regjistruar tek autoritetet tatimore dhe nuk paguajnë tatim në paga dhe kontribute pensionale. Ndërsa, arsyea pse ndodh kjo siç tregon opinionin e të anketuarve është se: Në rastin kur i punsuari nuk është i lajmëruar, ajo ndodh me vullnetin e të punsuarve në 84 % të rasteve, me vullnetin e pundhënësve ndodh në 15% të rasteve, ndërsa 1% e të intervistuarve kanë refuzuar të përgjigjen për këtë dukuri. Mirëpo, se cila në të vërtetë është arsyea e mosdeklarimit apo nëndeklarimit të pagës së punsuarve, përgjigja e të intervistuarve, do të tregohet në grafikun në vijim:

Grafiku 5.3: Arsyet e mosdeklarimit dhe nëndeklarimit të pagës




Burimi: Autori

- Arsyeja më e madhe për mosdeklarim apo nëndeklarim të pagave është niveli i ulët i pagave në Kosovë, siç edhe paraqitet në grafikun më lartë 53.50% e të intervistuarve e thonë këtë.
- 30.5% e të intervistuarve arsye kanë dëshirën për të ardhura më të larta;
- 6.9 % e të intervistuarve kanë frikë se do të mbetën pa punë.
- 8.1 % e numrit total të intervistuarve nuk kanë besim tek qeveria.
- Ndërsa, 1 % e intervistuarve kanë refuzuar të përgjigjen.

Sa i përket asaj se: Cili është niveli i pagave mujore për të punsuarit në bizneset e intervistuar dhe për të kuptuar se sa deklarohen ato për qëllime të pagesës së tatimit në paga dhe kontributeve pensionale, nga të intervistuarit kemi marr të dhënat, rezultatet e të cilave do të paraqiten në grafikun në vazhdim:

Grafiku 5.4: Shkalla e evazionit fiskal dhe informalitetit të pagave në Kosovë



Burimi: Autori

Të dhënat e paraqitura në grafikun e mësipërm tregojnë se shkalla e evazionit në të ardhurat nga paga dhe shkalla e informalitetit të fuqisë punëtore në Kosovë është shumë e lartë:


- Numri i të punësuarve që marrin paga nga 200-250 € dhe që nuk deklarojnë fare për qëllime tatimore është 31.8% e numrit total të punsuarve në bizneset e intervistuar dhe që del të jetë se pagat e tyre janë më të ulëta se paga mesatare në Kosovë. Një kategori tjetër prej 18.6% e numrit total të punsuarve që marrin paga 200- 350 € i deklarojnë ato në shumë prej 170.00 € për qëllime të tatimit në paga dhe KP, pra paga e tyre deklarohet vetëm aq sa është kuota e pagës minimale në Kosovë.
- Kategoria e të punsuarve prej 19.6% e numrit total të punsuarve, të cilët marrin paga nga 250-350 € dhe një kategori tjetër prej 3.2 % e të punsuarve total që marrin paga 350-500 € i deklarojnë pagat e tyre 200.00 € për qëllime tatimore.
- Ndërsa, vetëm 26.80% e të punsuarve deklarojnë pagat e tyre në shumën e vërtetë, aq sa paguhen. Pjesa më e madhe e këtyre të punsuarve kanë paga prej 350-500 €.
- Pagë mbi 500 € kanë vetëm 0.97% e të punsuarve që kanë qenë objekt i hulumtimit.

Pra, nga të dhënat e lartshënuara rezulton se shkalla e evazionit tatimor në tatimin në paga është mjaftë e madhe, 31.8% del të jetë shkalla e mosdeklarimit të të punsuarve ndërsa, 41.4% është shkalla e shmangies së tatimit në paga dhe kontributeve pensionale.

Arsyet për neglizhencë të pagesës së kontributeve pensionale, siç shprehen të intervistuarit janë frika për keqpërdorim të tyre, 47% e të intervistuarve e kanë thënë këtë, 43% e të intervistuarve arsye kanë atë se paratë e kursimeve të tyre pensionale janë të investuara jashtë vendit dhe kanë frikë nga humbjet eventuale të tyre.

Për të bërë të ditur se në cilin grup të të ardhurave nga shitjet bruto klasifikohen bizneset e përfshira në hulumtim në 10 vitet e fundit, rezultatet e dala tregohen në grafikun në vazhdim:

Grafiku 5.5: Klasifikimi i bizneseve sipas grupit të të ardhurave vjetore (bruto)




Burimi: Autori

Pra, sipas opinionit të bizneseve, të ardhurat që ata realizojnë kategorizohen si në vijim:

- 57% e tyre kanë të ardhura 50 deri në 200 mijë € - do të thotë hynë në kategorinë e bizneseve të mesme;
- 16% e bizneseve kanë deklaruar të ardhura nga 200 deri në 500 mijë €;
- Në kategorinë e bizneseve të mëdha me të ardhura vjetore bruto mbi 500 mijë € janë deklaruar rreth 15% e bizneseve të intervistuar;
- Në kategorinë e bizneseve të vogla janë identifikuar 9.5% e bizneseve me qarkullim vjetor ng 5 – 50 mijë €.
- Ndërsa 0.5% e bizneseve kanë qarkullim vjetor tejet të ulët - deri në 5 mijë €.

Ndërsa për të kuptuar se: Sa % e të ardhurave i deklarojnë këto biznese për qëllime tatimore intervista ka nxjerrë rezultatet si në vazhdim:

Grafiku 5.6: Nr. i bizneseve, në raport me shumën e të ardhurave të deklaruarra prej tyre, në %




Burimi: Autori

Siç tregohet edhe në grafikun e mësipërm shuma e të ardhurave të deklaruarra nga bizneset në raport me të ardhurat reale të tyre, apo thënë me saktë shkalla e evazionit që shkaktohet nga numër i caktuar i bizneseve, të dhënat e deklaruarra nga vet bizneset tregojnë për një përfshirje të lartë të bizneseve në evazion tatimor. Shifrat e deklaruarra tregojnë se 0.5% e bizneseve deklarojnë vetëm 5% e të ardhurave të tyre reale, do të thotë kjo kategori e bizneseve fshehin 95% e të ardhurave të tyre për qëllime tatimore. Rreth 4% e bizneseve fshehin 90% e të ardhurave për qëllime tatimore. Rreth 10 % e bizneseve krijojnë shmangie prej 80% të të ardhurave të tyre. Përafërsisht 12% e të intervistuarve fsheh 75% nga të ardhurat. 13% e bizneseve fshehin 70% nga të ardhurat që realisht i realizojnë. 17% e bizneseve arrin të shmangë 60% të të ardhurave. Një pjesë tjetër prej rreth 4%, nëndeclarojnë 40% e të ardhurave të tyre për qëllime tatimore. 21% e bizneseve nuk kryejnë obligimet tatimore për pjesën prej 30% nga të ardhurat totale që realizojnë. Mbi 4% e bizneseve fshehin 20% nga të ardhurat që realizojnë. 6.7 % e bizneseve fshehin 10% e të ardhurave tatimore. Mbi 2% e bizneseve fshehin 5% e të ardhurave. Vetëm, përafërsisht

1% e bizneseve nuk përshihen në evazion tatimor, ata shprehen se deklarojnë 100 % e të ardhuarve të tyre. Ndërsa, 4.5% e të anketuarve nuk kanë dashur të përgjigjen për këtë dukuri. Mirëpo, përkundër shkallës së lartë të fshehjes së të ardhuarve të tyre për qëllime tatimore opinioni i të intervistuarve rreth informalitetit që shkaktojnë bizneset e paregjistruara fare për qëllime tatimore është se, numri i tyre është shumë i vogël siç shprehen 61 % e të intervistuarve. Një shifër tjetër prej 17 % mendojnë se fare nuk ka biznese të paregjistruara tek autoritetet tatimore. Një nga projektet më të mëdha në luftimin e informalitetit, të zhvilluar nga ATK që filloi së zbatuari në vitin 2010 e që vazhdon edhe sot e tutje është paisja e bizneseve me arka fiskale. Rezultatet e dala nga ky hulumtim tregojnë se 77.20% e bizneseve janë të paisura më arkë fiskale, 22.4% e bizneseve të përfshira në këtë hulumtim akoma nuk janë të paisura më arka fiskale. Opinioni i atyre që nuk janë paisur me arka fiskale, thotë se arsye kanë çmimin e lartë të paisjes (aparaturës) fiskale si dhe kontrollin teknik të saj i cili është i detyrueshëm të bëhet për çdo vit dhe poashtu është tepër i kushtueshëm. Këtë opinion e shprehin mbi 97% e bizneseve të cilët nuk janë paisur me arka fiskale edhe pse ky është një obligim ligjor. Ndërsa mbi 2% e të intervistuarve shprehen se nuk kanë obligim ligjor paisjen me arkë fiskale mëqenëse nuk janë të përfshirë në transaksione me kesh.

Një nga qështjet kryesore dhe që i shërben këtij hulumtimi është të dihen se cilat janë shkaqet që i shtyen bizneset në Kosovë për t'u përfshirë në ekonomi joformale dhe evazion fiskal mëqenëse, është e njohur se pjesmarrja e tyre në këto dukuri është shumë e lartë. Dhe, opinionet e tatimpaguesve sa i përket asaj se cilat janë arsyet apo çka ata marrin si shkas për t'u bërë pjesë e këtyre dukurive do të bëhen të njohura përmes rezultateve në vijim:

Grafiku 5.7 Shkaktarët e ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal në Kosovë



Burimi: Autori

Në grafikun 5.7 janë paraqitur opinionet e të intervistuarve sa i përket arsyeve që kanë, siç shprehen ata, apo shkaktarët që i shtyen ata për t'u përfshirë në ekonominë joformale të fuqisë puntore dhe evazion fiskal. Rezultatet që dalin nga këto opinione janë:

- Pengesa më e madhe për bizneset dhe që i shtyen ata drejtë ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal është korrupsioni i zyrtarëve publik, prej 776 të intervistuarve, 522 apo 68.3% prej tyre mendojnë se korrupsioni është shkaktar kryesor i informalitetit dhe evazionit fiskal. 86 të anketuar apo 11% e tyre shprehen se korrupsioni është disi pengesë do të thotë nuk e shohin korrupsionin si pengesë aq të madhe. 4 të anketuar apo 0.5 % e të anketuarve nuk e shohin korrupsionin fare si

pengesë. Ndërsa 21.1% e tyre kanë refuzuar të flasin për këtë fenomen, që tregon se edhe nga ana e bizneseve nuk ka gatishmëri për të luftuar këtë fenomen.

- Si shkaktar tjetër me ndikim të madh në informalitet dhe evazion fiskal renditet paqëndrueshmëria politike, prej 776 të anketuarve 483 apo shprehur në përqindje 62 % e të anketuarve vlersojnë se paqëndrueshmëria politike është pengesë shumë e madhe për ta. 248 të anketuar apo 32% të tjerë shprehen se paqëndrueshmëria politike është disi pengesë do të thotë nuk e shohin atë si pengesë aq të madhe. 14 të anketuar apo rreth 2 % e të anketuarve nuk e shohin paqëndrueshmërinë politike fare si pengesë. Ndërsa 31 të anketuar apo rreth 4% kanë refuzuar të flasin për këtë fenomen.
- Nga 776 të anketuar 292 apo shprehur në përqindje 37.6 % e të anketuarve vlersojnë se procedurat e komplikuar administrative janë pengesë shumë e madhe për ta. 443 të anketuar apo 57% të tjerë shprehen se procedurat e komplikuar janë disi pengesë, por nuk e shohin atë si pengesë shumë të madhe. 30 të anketuar apo 3.9 % e të anketuarve nuk i shohin këto procedura fare si pengesë. Ndërsa 11 të anketuar apo rreth 1.5 % kanë refuzuar të flasin për këtë fenomen.
- Nga 776 të anketuar, 286 apo shprehur në përqindje rreth 37 % e të anketuarve vlersojnë se ndryshimet e vazhdueshme në ligje dhe rregullore tatimore janë pengesa shumë të madha për ta. 354 të anketuar apo 45.5% të tjerë shprehen se kjo dukuri është disi pengesë do të thotë nuk e shohin atë si pengesë shumë të madhe. 124 të anketuar apo 16 % e të anketuarve nuk i shohin këto ndryshime fare si pengesë. Ndërsa, 12 të anketuar apo 1.5 % kanë refuzuar të flasin për këtë fenomen.

- Nga 776 të anketuarve 280 apo shprehur në përqindje 36 % e të anketuarve vlersojnë se barrierat e tregtisë janë pengesë shumë e madhe për ta. 475 të anketuar apo 61% të tjerë shprehen se ajo është disi pengesë do të thotë nuk e shohin atë si pengesë aq të madhe. 30 të anketuar apo rreth 4 % e të anketuarve nuk e shohin paqëndrueshmërinë politike fare si pengesë. Ndërsa 11 të anketuar apo mbi 1% kanë refuzuar të flasin për këtë pengesë.
- Nga 776 të anketuar 270 apo shprehur në përqindje rreth 35 % e të anketuarve vlersojnë se sistemi elektronik i komplikuar për deklarim të tatimeve është pengesë shumë e madhe për ta. 347 të anketuar apo rreth 45% të tjerë shprehen se ai është pengesë, por nuk e shohin atë si pengesë shumë të madhe. 148 të anketuar apo rreth 20 % e të anketuarve nuk e shohin sistemin elektronik të deklarimit fare si pengesë. Ndërsa 11 të anketuar apo mbi 1% kanë refuzuar të flasin për këtë pengesë.
- Nga 776 të anketuar 267 apo shprehur në përqindje 34 % e të anketuarve vlersojnë se mundësia e limituar për financim të biznesit është pengesë shumë e madhe për ta. 376 të anketuar apo rreth 48% të tjerë shprehen se kanë këtë pengesë, por nuk e shohin atë si arsye shumë të madhe. 119 të anketuar apo rreth 15 % e të anketuarve nuk e kanë fare problemin e financave. Ndërsa 14 të anketuar apo 3 % kanë refuzuar të flasin për këtë problematikë.
- Nga 776 të anketuar 184 apo shprehur në përqindje rreth 24 % e të anketuarve vlersojnë se ligjet e komplikuar tatimore janë pengesë shumë e madhe për ta. 561 të anketuar apo rreth 72 % të tjerë shprehen kanë këtë pengesë, por nuk e shohin atë si arsye shumë të madhe. 20 të anketuar apo rreth 2.5 % e të anketuarve nuk i


shohin ligjet e komplikuara fare si problem. Ndërsa 11 të anketuar apo 1.5 % kanë refuzuar të flasin për këtë problematikë.

- Nga 776 të anketuar 34 apo shprehur në përqindje rreth 4.5 % e të anketuarve vlersojnë se normat e larta të tatimeve janë pengesë shumë e madhe për ta. 247 të anketuar apo rreth 32% të tjerë shprehen se taksat e larta janë arsye, por nuk e shohin atë si pengesë shumë të madhe. 484 të anketuar apo 62 % e të anketuarve deklarojnë se taksat nuk janë fare të larta dhe nuk i shohin ato si arsye për të shmangur taksat. Ndërsa, 11 të anketuar apo rreth 1.5% kanë refuzuar të flasin për këtë arsye.

Seksioni 3: Perceptimi i ryshfetit dhe korrupsionit në ATK

Rezultatet që dalin nga ky seksion tregojnë për perceptimin që kanë tatimpaguesit rreth përfshirjes së zyrtarëve tatimor në ryshfet dhe korrupsion.

Grafiku 5.8. Reflektimi i Paknaqësisë së bizneseve nga puna e zyrtarëve tatimor




Burimi: Autori

Siç tregohet në grafikun 5.8, opinioni i tatimpaguesve është se paknaqësia më e madhe ndaj punës së zyrtarëve tatimor vjen nga fenomeni i korrupsionit, përderisa një pjesë e mirë e tyre shprehën se zyrtarët tatimor janë joefikas në punën e tyre. Sa i përket raportimit apo jo nga ana e bizneseve për rastet e kërkesave për ryshfet tek autoriteti përkatës, 93 % e të intervistuarve deklarojnë se nuk i paraqesin këto raste.

Ndërsa, sa i përket arsyeve se pse nuk raportohen kërkesat për ryshfet, përgjigjet e të intervistuarve janë si në vijim:

Grafiku 5.9 Arsytet e mosraportimit të ryshfetit nga ana e bizneseve



Burimi: Autori

Arsyet e mosraportimit të ryshfetit nga ana e bizneseve në Kosovë, siç deklarojnë të intervistuarit janë kryesisht: mosbesimi në funksionimin e ligjit, 43% e tyre mendojnë se është e kot për të raportuar. Një pjesë prej 38 % janë dakord me ryshfetin për shkak se përfitojnë nga dhënia e tij do të thotë se një numër i tillë i bizneseve janë të gatshëm për të dhënë ryshfet. Një kategori tjetër e bizneseve kanë frikë të raportojnë sepse mendojnë se do të ndëshkohen nga zyrtarët tjerë si shenjë hakmarrjeje. Ndërsa, një kategori prej 7% ryshfetin apo korrupsionin e shohin si praktikë të zakonshme.

Diskutime dhe Përmbledhje e rezultateve nga pyetsorët

Në këtë pjesë të këtij kapitulli do të diskutohen rezultatet më të rëndësishme të analizës përshkruese që dalin nga pyetësi të cilat hedhin dritë mbi situatën e evazionit fiskal dhe ekonomisë joformale në Kosovë dhe identifikojnë shkaktarët dhe pasojat e tyre. Në formë të përmbledhur rezultatet e kësaj analize do të diskutohen në vijim:

Mbi 92 % e të intervistuarve ishin pronarët e bizneseve; afër 75 % e bizneseve kishin me tepër se 10 vite afarizëm; mbi 95 % e bizneseve udhëheqen nga pronarët meshkuj; mbi 86 % e pronarëve të bizneseve janë me arsimim të mesëm; rreth 68 % e tyre kanë moshë prej 40- 50 vjeq. Nisur nga karakteristikat e mësipërme, mund të thuhet se shkalla e arsimimit të tatimpaguesve ka ndikimin më të madh në moralin e taksave sepse tatimpaguesit e arsimuar njohim me mirë ligjet e taksave, poashtu janë me të vetëdijshëm për përfitimet nga shërbimet që ofron shteti për qytetarët, poashtu kuptojnë me mirë edhe keqpërdorimet e mundshme të qeverisë dhe dinë të jenë me kritik për menyrën se si shteti përdorë të ardhurat nga taksat për këtë arsye arsimimi ndikon në nivelin e moralit tatimor.

Duke marr parasysh, karakteristikat e personave të përfshirë në biznes, për autoritetet fiskale mbetet sfida e madhe ushtrimi i kontrollit tatimor dhe mbledhje e tatimeve për faktin se siç treguan rezultatet nga ky pyetësor, mbi 41 % e bizneseve nëndeclarojnë (shmangin) tatimin në paga dhe kontributet pensionale për të punsuarit, ndërsa mbi 31 % e të punsuarve janë joformal, edhepese mbi 53 % e të intervistuarve deklarojn se arsyet për të mosdeklaruar apo nëndeklaruar tatimet në paga të të punsuarve janë pagat e ulëta, përderisa mbi 30 % arsye kanë përfitime më të larta nga pagat. Evazioni tatimor llogaritet të jetë i madh tek tatimi në të ardhura nga pagat, sepse individët që punojnë me pagë, të cilat janë të ulëta në Kosovë, një pjesë e tyre nuk deklarojnë fare, e një pjesë e nëndeclarojnë atë, në mënyrë që të mos

zvogëlojnë mirëqenjen e tyre edhe ashtu të ulët. Në pagesën e ulët të pagave dhe tatimit të llogaritur në to, mendoj se përpos nivelit të lartë të papunësisë ka ndikuar edhe vendimi i qeverisë duke caktuar pagën minimale vetëm 170.00 € për të punsuarit mbi moshën 35 vjeqe ndërsa, pagën minimale 130.00 € për të punsuarit nën moshën 35 vjeqe, kjo për shkak se pagat e nëpunësve civil janë relativisht të ulëta në Kosovë dhe këtë zbrazëti e kanë shfrytëzuar bizneset në Kosovë, ku një pjesë e madhe e tyre deklarojnë paga minimale për qëllime tatimore për të punsuarit e tyre edhe në ato raste kur ata paguajnë paga më të mëdha për të punsuarit e tyre, e një pjesë e madhe e tyre fare nuk deklarohet edhe përkundër vullnetit të atyre të punsuave të cilët janë të interesuar të paguajnë tatim në paga dhe kontribute pensionale për të ardhmën e tyre. Skema pensionale në Kosovë është e organizuar në atë mënyrë që llogaritë e pensioneve janë individuale, pra secili i punsuar kur të pensionohet merr shumën e pensionit të cilën e ka akumuluar (paguar) për vetvetën. Ndërsa, sa i përket evazionit apo shmangies tatimore që shkaktojnë bizneset nga të ardhurat e tyre, të dhënat e deklaruara nga vet bizneset tregojnë për një përfshirje të lartë të bizneseve në evazion tatimor. Shifrat tregojnë se: 0.5% e bizneseve deklarojnë vetëm 5% e të ardhurave të tyre reale për qëllime tatimore; Rreth 4% e bizneseve , shmangin 90% e të ardhurave të tyre për qëllime tatimore; Rreth 10 % e bizneseve krijojnë shmangie prej 80%; Përafërsisht 12% e të anketuarve shmangin 75% nga të ardhurat. 3% e bizneseve shmangin 70; 17% e bizneseve arrijnë të shmang 60% të të ardhurave; rreth 4% shmangin 40% e të ardhurave të tyre për qëllime tatimore; 21% e bizneseve nuk kryejnë obligimet tatimore për pjesën prej 30% nga të ardhurat totale që realizojnë. Mbi 4% e bizneseve, fshehin 20% nga të ardhurat që realizojnë. 6.7 % e bizneseve fshehin 10% e të ardhurave tatimore. Mbi 2% e bizneseve fshehin 5% e të ardhurave. Vetëm, përafërsisht 1% e bizneseve nuk përshihen në

evazion tatimor, ata shprehen se deklarojnë 100 % e të ardhuarve të tyre. Ndërsa 4.5% e të anketuarve nuk kanë dashur të përgjigjen për këtë dukuri. Rezultatet e mësipërme tregojnë për një shkallë të lartë të prezencës së evazioni fiskal në ekonominë e Kosovës, shmangia tatimore konsiderohet të jetë e lartë tek tatimi në të ardhura personale sepse individët apo tatimpaguesit si nëndeklarues me të mëdhenjë të tatimit llogaritën kontraktuesit, profesionistët si avokat, mjek, kontabilist, artitektët dhe tregtarët në dyqane tjera deklarojnë të ardhura joreale, shumë të ulëta në krahasim me natyrën e bizneseve të tyre.

Sikurse tregojnë edhe rezultatet nga pyetësi, numri i bizneseve të përfshira në ekonomi joformale është i vogël, këtë e vërtetojnë edhe të dhënat nga vizitat e inspektorëve në terren, por numri i tyre është i madh në shmangie (nëndeklarim të tatimeve). Fenomeni i përfshirjes në ekonomi joformale është prezent në masë të madhe tek fuqia puntore.

Nga rezultatet e pyetësorit del se shkaktarët kryesor që i shtyejnë bizneset për përfshirje në evazion fiskal dhe ekonomi joformale janë: korrupsioni i zyrtarëve qeveritar të cilin bizneset e rendisin si pengesën me të madhe. Poashtu, paqëndrueshmëria politike është pengesë e dytë më e madhe, pastaj pengesë e madhe janë procedurat e komplikuar administrative dhe ndryshimet e shpeshta në ligje tatimore, sistemi i komplikuar për deklarim të tatimeve është pengesë e madhe për një pjesë të tatimpaguesve (35%) dhe në fund rendisin normat e larta tatimore edhe pse vetëm rreth 28% e bizneseve e konsiderojnë këtë poashtu si pengesë të madhe.

Nisur nga të gjeturat e lartcekura dhe vet specifikat e sistemit tatimor të Kosovës në administrimin e tatimeve mund të konkludohet se: Reformat që kanë përfshirë rregulloret dhe ligjet tatimore ku ligjet tatimore e aplikuar në Kosovë janë të reja dhe shumica të kopjuara nga shtetet e ndryshme të botës dhe disa prej tyre ishin në disharmoni me kushtet

ekonomike të Kosovës, pasiqë sistemi i tanishëm tatimor është i ri i themeluar pas luftës së viteve 1998/1999 dhe i ndërtuar me ndihmën e ndërkombëtarëve, kështuqë për 15 vite jetë sa ka deri tani sistemi i Kosovës ligjet dhe udhëzimet tatimore kanë pësuar ndryshime të kohëpaskohëshme që ka shkaktuar veshtirësi të mëdha për tatimpaguesit pasiqë është dashur që kohë pas kohe të përballën me rregullore dhe procedura të reja për shlyerjen e detyrimit të tyre tatimor. Duhet cekur se ndryshimet e shpeshta të rregulloreve që tani janë përkthyer në ligje kanë gjetur në vështirësi edhe zyrtarët tatimor të cilët gjatë gjithë kohës është dashur të përballën me ndryshime të ligjeve dhe procedurave e në të njëjtën kohë edhe të jenë zbatues të tyre, që në disa raste ka mund të sjellë edhe paqartësi tek tatimpaguesit dhe njëkohësisht destimulim të tyre për pagesë taksash. Në dy vitet e fundit është zhvilluar sistemi elektronik ku tatimpaguesit obligohen të deklarojnë tatimet e tyre në mënyrë elektronike që mendoj se ka qenë një hap i ngutshëm i autoritetit tatimor pasiqë jo të gjithë tatimpaguesit janë të vetëdijshëm të kuptojnë se si funksionon një sistem i tillë kur merren parasysh kompleksiteti i sistemit dhe shkalla e ulët e arsimimit të një numri të konsiderueshëm të njerëzve të përfshirë në biznes. Numri i njerëzve të përfshirë në biznes në Kosovë është i madh edhe pse mundësitë e të bërit biznes janë të vogla dhe sfiduese pasiqë stimulimet e qeverisë janë shumë të kufizuara për të thënë nuk ekzistojnë fare (ato ekzistojnë vetëm në letër), mirëpo njerëzit në Kosovë hyjnë për të zhvilluar biznes në mungesë të një vendi të punës pasiqë shkalla e papunësisë llogaritet shumë e lartë rreth 40 %. Pra, vet mënyra e deklarimit të tatimeve në dy vitet e fundit do të jetë shkaktar i cili shtyen tatimpaguesit për evasion fiskal, ndikimi është i madh sidomos në deklarimin e tatimit në paga të të punsuarve i cili gjithashtu ka qenë i përfshirë në shmangje të tatimit dhe evasion fiskal për shkak të pagave të ulëta. Kështuqë, mënyra e deklarimit të tatimeve

sipas sistemit që aplikohet sjellë kosto për tatimpaguesit dhe i shtyen ata të shmangin taksat e që njehkohësisht shkakton kosto edhe për autoritetin tatimor i cili duhet të përqëndrohet në vëzhgim të veprimtarive të tatimpaguesve që shmangin tatimin ose nuk deklarojnë fare. Mëqenëse, pakënaqesia më e madhe e bizneseve është e lidhur me nivelin e lartë të korrupsionit, prapë se prapë mbi 90% e tyre nuk shprehen të gatshëm të raportojnë këtë dukuri me arsyetimin se është e kot të raportohet, siç thonë 54% e tyre. Ndërsa, 38 % deklarohen se janë dakord me këtë dukuri. Mosgatishmëria e tatimpaguesve për të mos raportuar korrupsionin dhe për t'u bërë edhe vet pjesë e tij është tregues që tregon mosbesueshmëri të qytetarëve tek mekanizmat e qeverisë përfshirë organet e sundimit të rendit dhe ligjit. Mos sundimi i ligjit nga ana e organeve të gjyqësisë dhe paqëndrueshmëria politike është shkaktari më i madh që stimulon si zyrtarët publik ashtu edhe qytetarët, të përfshihen në dukuri negative si korrupsioni, e me këtë duke i destimuluar tatimpaguesit që në mënyrë të vullnetshme të kryejn obligimet tatimore ndaj shtetit për të kontribuar në mirqënien ekonomike të tyre dhe shoqërisë.

5.4. Analizë krahasuese e gjetjeve të studimit me gjetjet e studimeve tjera

Shumica e studimeve empirike të shqyrtuara në këtë punim si studimet nga: Robert Barro & C.J., Redlick, (2011), Engen, E. & Skinner, (1996), Padovano, F. & Galli, E., (2001), tregojnë se shkurtimi i normave tatimore sidomos atyre marxhinale ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike. Përderisa, analiza jonë empirike tregoi të kundërtën pra, norma margjinale e TAP nuk tregoi fare ndikim në rritjen ekonomike të matur për frymë. Disa studime gjejnë se rritja e normave tatimore në punë dhe kapital ndikon negativisht në rritje Koester, R. & R. Kormendi, (1989)., Mendoza, Milesi – Ferretti Asea (1997), Leibfritz,

W., J. Thorton and A. Bibbe (1997). Përderisa të tjera rezultojnë me atë se ulja e normave tatimore tatimeve të TAK ndikojnë rritjen ekonomike Ferede & Dahlbu, (2012), Lee, Y., & Gordon, R., (2005), Ndërsa, rezultatet e studimit tonë tregojnë të kundërten pra, se një rritje prej një përqindë në normen tatimore të TAK-së do të rrisë PBB-në për frymë për 3.9%. Kurse, duke i'u referuar vlerave të koeficientëve, rezultatet e analizës sonë tregojnë se një rritje prej një përqindë në normën tatimore marxhinale të TAP-së do të ulë këtë kategori të ardhurash prej 0.11% në raport me PBB-në.

Kapitulli VI. Konkluzione dhe Rekomandime

6.1 Konkluzione

Duke marr si shtysë nivelin e ulët të mirëqënies ekonomike në vend dhe duke qenë e njohur se sistemi tatimor luan rol të rëndësishëm si stabilizues dhe instrument kyq i politikës fiskale është parë me rëndësi që në këtë punim të hulumtohet ndikimi i reformave në normat tatimore në kuadër të sistemit tatimor për të parë rolin e tyre në krijimin e të ardhurave dhe mirëqniën ekonomike. Nga analiza krahasuese e të dhënave u bë e qartë se sistemi tatimor i Kosovës ndryshon nga sistemet tatimore të vendeve të BE –se jo vetëm sa i përket strukturës tatimore por edhe aplikimit të normave tatimore. U pa qartë se në Kosovë, sistemi tatimor mbështetet me tepër tek taksat indirekte, ndërsa vendet e BE-së mbështeten tek taksat direkte. Gjithashtu, analiza e të dhënave tregoi se normat tatimore në Kosovë janë me të ulëtat në rajon dhe vendet e BE-së.

Ndryshimet politike ekonomike dhe sociale të pasluftës së vitit 1999 në Kosovë krijuan nevojën e krijimit të sistemit të ri tatimor. Sistemi tatimor fillimisht u bazua në rregullore të Misionit të Kombeve të Bashkuara të instaluar pas luftës në Kosovë të cilat gradualisht u shëndrruan në ligje të miratuara nga Kuvendi i Kosovës. Përgjatë këtyre viteve reformat tatimore preken vazhdimisht strukturën tatimore, llojet dhe shkallët e normave tatimore. Reformat e thella tatimore ndodhen në Dhjetor të vitit 2004 ku baza tatimore në Kosovë u vendos në tri lloje kryesore të tatimeve: Në tatimin në të ardhura personale dhe tatimin në të ardhura të korporatave si pjesë të tatimeve direkte si dhe tatimi në vlerën e shtuar si pjesë e të ardhurave indirekte. Në dhjetor të vitit 2008 reformat u përqendruan në reduktim të thellë të normave tatimore progressive të tatimit në të ardhura personale dhe në normat

proporcionale të tatimit në të ardhura të korporatave përderisa, norma e tatimit në vlerën e shtuar pati një ngritje të lehtë nga 15% në 16%. Norma më e lartë progresive e tatimit në të ardhura personale (TAP) u reduktua nga 20% në 10%, poashtu, norma proporcionale e tatimit në korporata (TAK) u reduktua nga 20 % në 10% . Një nga arsyet e reduktimit të normave tatimore sidomos zbatimit të sistemit tatimor proporcional me norma të ulëta të tatimit në korporata ishte me synimin për të tërhequr investimet e huaja e poashtu, edhe për të mbështetur edhe investitorët e brendshëm. Kjo në rastin e Kosovës mund të shpjegohet se, edhe përkundër normave tatimore të ulëta investimet jo që nuk janë rritur por, ato janë në rënje për shkak të ndikimit të dukurive negative dhe kushteve socio-ekonomike që janë prezente në shoqërinë kosovare si korrupsioni, paqëndrueshmëria politike, infrastruktura e pazhvilluar, mosfunksionaliteti i sistemit gjyqësor etj.

Nga rezultatet e studimit tregohet se reforma tatimore e vitit 2008 e cila kishte përfshirë reduktimin në shkallë prej 10% të normës tatimore të TAP dhe TAK tregohet të mos ketë efekt në gjenerimin e të ardhurave tatimore e cila u reflektua menjëherë në vitin 2009. Sa i përket hipotezës H1 të ngritur, se: Reduktimi i normave tatimore të tatimit në korporata, dhe të ardhura personale nuk ndikojnë në rritjen e performancës së këtyre të ardhurave në raport me PBB –në, analiza e regresionit vërtetoi hipotezen e ngritur për këtë qëllim sa i përket ndikimit të reduktimit të normës tatimore të TAK-së por, analiza regressive e ndikimit të reduktimit të normës tatimore të TAP-së, tregoi se rritja e normës marginale të TAP ndikon negativisht në performancën e këtyre të ardhurave në raport me PBB-në.

Meqenëse, në fokus të këtij studimi është edhe ndikimi i të ardhurave tatimore në rritjen ekonomike e (matur për frymë banori), analiza ekonometrike e zhvilluar për vërtetimin e H2 të ngritur për këtë qëllim. Duke i'u referuar vlerave të koeficientëve dhe vlerës së p-

value , ekuacioni jonë tregon se një rritje prej 1 % në normen tatimore të TAK-së do të rrisë PBB-në për frymë për 3.9 %. Pastaj, shohim se një rritje prej 1 % në normen tatimore e të ardhurave doganore do të rrisë PBB-në për frymë për 1.5 % ndërsa, një rritje prej 1 % në normen e shpenzimeve kapitale do të rrisë PBB-në për frymë për 0.9 %. Ndërsa, ndikimi i TAP dhe variablave tjerë fiskal dhe jofiskal të përfshirë në analizë nuk treguan ndikim në rritjen ekonomike. Rezultatet nga analizat regresive treguan për një lidhje të parëndësishme të variablave jofiskale si investimet private, eksportet neto, rritja e forcës së punës në rritjen ekonomike për frymë.

Në dy vitet e fundit ATK ka vendosur disa prioritete një ndër to është edhe trajtimi i mosdeklaruesve dhe nëndeklaruesve, mirëpo kjo nuk ka pasur aq sukses dhe as që do të këtë në mënyrën dhe kushtet se si trajtohen ato, kjo për shkak të angazhimit të inspektorëve në numër dhe lloje të mëdha të detyrave që si shkak i tyre inspektorët janë të orientuar me tepër të bëjnë numër të aktiviteteve, sesa të kenë rezultate të arritëshme në kryerjen e detyrave të tyre.

Duke parë një përformancë të ulët të të ardhurave tatimore dhe pa ndonjë ndikim në rritje të mirëqënies ekonomike me gjithë reduktimet e barrës tatimore për këtë qëllim analiza e këtij studimi u shtri në gjetjen e shkaktarëve të mundshëm për krijimin e kësaj situate. Për këtë arsye u zhvillua një pyetsor me bineset në Kosovë për të parë rolin e evazionit fiskal dhe ekonomisë joformale dhe shkaktarët që stimulojnë këto të fundit në të ardhurat tatimore.

Disa nga rezultatet më të rëndësishme që dolën nga ky pyetsor janë se: Mbi 41 % e bizneseve nëndeclarojnë (shmangin) tatimin në paga dhe kontributet pensionale për të punësuarit, ndërsa mbi 31 % e të punësuarve janë joformal. Mbi 53 % e tyre deklarojnë se

arsyet për të mosdeklaruar apo nëndeklaruar tatimet në paga të të punsuarve janë pagat e ulëta, përderisa mbi 30 % arsye kanë përfitimet më të larta nga pagat.

Sa i përket numrit të bizneseve që shkaktojnë shmangie tatimore, të dhënat e deklaruara nga vet bizneset tregojnë për një përfshirje të lartë të bizneseve në evazion tatimor. Shifrat tregojnë se: shkalla e e shmangies tatimore është rreth 52% e të ardhurave të bizneseve. Shmangia tatimore konsiderohet të jetë e lartë tek tatimi në të ardhura personale sidomos nga tatimpaguesit e përfshirë në veprimtari shërbyese si avokat, mjek, kontabilist, artitektët dhe tregtarët në dyqane tjera deklarojnë të ardhura shumë të ulëta në krahasim me natyrën e bizneseve të tyre. Nga rezultatet e pyetësorit del se shkaktarë kryesor që i shtyejn bizneset për përfshirje në evazion fiskal dhe ekonomi joformale janë: korrupsioni i zyrtarëve qeveritar, paqëndrueshmëria politike, procedurat e komplikuar administrative dhe ndryshimet e shpeshta në ligje tatimore, sistemi i komplikuar për deklarim të tatimeve dhe në fund rendisin normat e larta tatimore edhe pse vetëm rreth 28% e bizneseve e konsiderojnë këtë si pengesë për të deklaruar tatimet. Mëqenëse, pakënaqesia më e madhe e bizneseve është e lidhur me nivelin e lartë të korrupsionit, prapë se prapë 93% e tyre nuk shprehen të gatshëm të raportojnë këtë dukuri me arsyetimin se është e kot të raportohet, siç thonë 54% e tyre. Ndërsa, 38 % deklarohen se janë dakord me këtë dukuri, kurse 7% nga të intervistuarit thonë se kjo është një praktik e zakonshme.

Mosgatishmëria e një numri të madh i tatimpaguesve për të mos raportuar korrupsionin dhe për t'u bërë edhe vet pjesë e tij është një tregues që tregon mosbesueshmëri të qytetarëve tek mekanizmat e qeverisë përfshirë organet e sundimit të rendit dhe ligjit. Mossundimi i ligjit nga ana e organeve të rendit dhe gjyqësisë dhe paqëndrueshmëria politike është shkaktari më i madh që stimulon si zyrtarët publik ashtu edhe qytetarët, të përfshihen në

dukuri negative si korrupsioni, e me këtë duke i destimuluar tatimpaguesit që në mënyrë të vullnetshme të kryejn obligimet tatimore ndaj shtetit për të kontribuar në mirqënien ekonomike të tyre dhe të shoqërisë.

6.2 Rekomandime

Nisur nga të gjeturat e hulumtimit në lidhje me reformat e normave tatimore u konstatua se këto reforma tek tatimet direkte (tatimi në të ardhura personale dhe tatimi në korporata) kanë cënuar objektivin fiskal që bartin tatimet. Prandaj, rekomandohet:

- Një sistem tatimor proporcional me norma të ulëta tatimore të TAK por, jo në masën e tanishme sepse reduktimi i normave tatimore është i pranueshëm deri në masën ku të ardhurat e mbledhura për buxhetin bëjnë të mundur financimin e shpenzimeve publike.
- Rritja e normës tatimore tek tatimet direkte (TAK dhe TAP) se paku prej 5% është domosdoshmëri pasi që ritmet e rritjes ekonomike janë gjithnjë në rënje. Ndërsa,
- Rekomandohet aplikim i një sistemi proporcional tatimor edhe tek TAP për shkak të thjeshtësisë së tij çka e bën më tërheqës për t'u aplikuar nga tatimpaguesit si dhe për faktin se analiza jonë tregoi se aplikimi i sistemit aktual me norma progresive tatimore nuk ka efekt në rritjen e të ardhurave nga ky lloj tatimi sikurse nuk tregoi asnjë rëndësi edhe në rritjen ekonomike. Përkundrazi, analiza e regresionit e zhvilluar për këtë qëllim tregoi se me rritjen prej 1% në normen tatimore marginale të TAP do të ulë këtë kategori të ardhurash prej 0.11 % në raport me PBB-në.

- Një sistem tatimor proporcional me norma më të ulëta të TAK-se, se sa në vendet tjera në rajon e me gjerë është tërheqës për investorët por jo edhe vendimtar siç u pa në rastin e Kosovës për shkak të ndikimit edhe të faktorëve të tjerë.

Prandaj, për të nxitur një klimë të përshtashme si për tërheqje të investorëve, rritjen e performancës së të ardhurave tatimore si dhe luftimin e evazionit fiskal rekomandohet:

- Thjeshtim i procedurave administrative, zbatim i drejtë i ligjeve tatimore, reforma në miradministrim të administratës tatimore si stafë të trajnuar dhe profesional, rritje e numrit të inspektorëve tatimor, rritje e vizitave bizneseve në terren kur dihet mosgadishmëria e tyre për t'u përgjigjur vullnetarisht pagesës së taksave.
- Rekrutimi i të punësuarve të bazohet në meritokraci dhe të drejta të barabarta, rritje e pagave e të punësuarve sepse ato janë të ulëta dhe si pasojë konfliktet e interesit në mes detyrave publike dhe çështjeve private të të punësuarve ekzistojnë. Gjithashtu, vlerësimi i performancës së të punësuarve dhe avansimi në karrierë nuk është korrekt dhe kjo shkakton destimulim të të punësuarve në kryerjen e detyrave me sukses dhe në kohën e duhur.
- Trajtimi i tatimpaguesve të bëhet në mënyrë të barabartë sepse nuk është i tillë për faktin se pajtueshmëria për pagesë vullnetare është e vogël dhe kontrolli i gjithë atyre që shmangin taksat është i pamundur me kapacitetet aktuale të ATK-së e kjo, direkt shkakton pabarazi për trajtim të drejtë të tatimpaguesve, e kjo pabarazi është edhe më e madhe kur merren parasysh ndërhyrjet e politikës në ekonomi.
- Të ndërmerren politika fiskale favorizuese sidomos për bizneset e reja.
- Të veproj sundimi i ligjit si për zyrtarët tatimor ashtu edhe për bizneset që përfshihen në korrupsion dhe aktivitete tjera joligjore.

LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA

- Administrata Tatimore e Kosovës, 2011, “Strategjia e Përmbushjes 2012-2015, Shtator, 2011, Prishtinë, f. 8-12.
- Adebisi, J. F. & Gbegi, D.O. (2013). Effect of Tax Avoidance and Tax Evasion on Personal Income Tax Administration in Nigeria, *American Journal of Humanities and Social Sciences*, Vol. 1, No. 3, 2013, pp. 125.
- Agha, A. & Haughton, J. (1996). Designing VAT Systems: Some Efficiency Considerations, *Review of Economics and Statistics*, pp. 307.
- Agenor, P. R. & Neanidis, K. C. (2012). Optimal taxation and growth with public goods And costly enforcement, *The Journal of International Trade & Economic Development*, September 2012, pp.1, [http:// dx.doi.org/10.1080/09638199.2012.730055](http://dx.doi.org/10.1080/09638199.2012.730055).
- Alesina, a., & Ardagna, S., (2010), “Large changes in fiscal policy: taxes versus spending, in Tax Policy and the Economy”, Vol. 24, University of Chicago press, 2010.
- Allingham, M.G. and Sandmo, A. ,(1972), “ Income Tax Evasion: A Theoretical Analysis”, *Journal of Public Economics* 1 (1972) , North - Holland Publishing Company, pp. 323-338.
- Amegashie, J. A. (2009), “ *Self-Selection, Optimal Income Taxation, and Redistribution*”, *The Journal of Economic Education*, Vol. 40, No. 1, pp. 55-67. [http:// dx.doi.org/10.3200/JECE.40.1.055-067](http://dx.doi.org/10.3200/JECE.40.1.055-067).
- Arnold, J., Brys, B., Heady, Ch., Johansson, A., Schwellnus, C., & Vartia, L., (2011), “ Tax Policy for Economic Recovery and Growth”, *Economic Review*, Vol.121, pp. 59-80.
- Arturo, A., (2014), The Effect of Paroll Taxes on Employment and Wages under High Labour Informality, *IZA Journal of Labor & Development*, Vol. 3, No. 20, November 2014, pp.1-23.
- Atkinson, A. B. & Stiglitz, J. E. (1972), “ *The Structure of Indirect Taxation and Economic Efficiency*”. *Journal of Public Economics*, pp. 97-119.
- Atkinson, A.B., (1977), “ Optimal Taxation and the direct versus Indirecy Tax Contrversy”, *Can. J.Econ.* 590-592.
- Anciute, A., Kropiene, (2010), “ The Model of Tax Evasion, its Corrections and Coherence to the Practical Tax Administration”, *Ekonomika*, Vilnius University, Lithuania, 2010 Vol. 89, nr. 4, pp. 49-65.

- Barro, J.R., Sala-i-Martin, X., (2004), “Economic Growth”, Second Edition, The MIT Press Cambridge, Massachusetts, London, England.
- Barro, R., Redlick, C.J., (2011), “ Macroeconomic Effects of Government Purchases and Taxes”, *Quarterly Journal of Economics*, Vol. 126, Issue 1, pp. 51-102.
Online: ISSN 1531-4650; Print ISSN 0033-5533.
- Blanchard, O., & Perotti, R., (2002), “ An Empirical Characterization Of The Dynamic Effects Of Changes In Government Spending And Taxes on Output”, Vol.117, *The Quarterly Journal of Economics*, f.1329-1368.
- Blaug, M. (1962), “ Economic Theory in Retrospective ”, Vol. II, Illions: Richards D. Irwing, inc.
- Bundo, Sh. (2007), “*Financë*”, *Botim i III*, Tiranë, fq. 279-280.
- Cabelle, J. & Panades, J. (2000). Tax Evasion and Economic Growth, June 2000.
- Cabelle, J., Panades, J., (2007), “ Tax Rates, Tax Evasion, and Growth in a Multi- period Economy”, *Revista de Economia publica*, Vol. 183, No. 4, pp.68-77.
- Chernick, H., (1997), “ Tax progressivity and state economic performance, Vol. 11, *Economic Development Quarterly*, f.249-267.
- Croce, E. (2002) “ *Assessment of the Fiscal Balance* ”, in *Macroeconomic Management Programs and Policies*, IMF.
- Dalgaard, P., (2008), “*Nonlinear regression analysis*”, Department of Biostatistics University of Copenhagen .
- Dragomir, G., et al., (2011). Approaches of Taxation under the Current Circumstances between Desiderata and Results – I, *Acta Universitatis Danubius*, No. 1/2011
- Doyle, William, (2001), “ Old Regime France”, Oxford University Press, fq.7-41
- Eltis, Walter, (2000), “ The Classical Theory Of Economic Growth ”, Vol. II, Oxford: Palgrave
- Engen, E. & Skinner J. (1996), “ Taxation and Economic Growth”, *National Tax Journal*, Vol. 49, No. 4, December 1996, Tax Reforms in EU Member States 2014p. 617-642.
- European Commission (2010). Compliance Risk Management Guide for Tax Administrations,
http://ec.europa.eu/taxation_customs/common/publications/info_docs/Taxation/i.....

- European Commission, (2013), *Taxation Trends in the European Union*, pp. 21-38, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2013, pp. ISBN 978 - 92-79- 28852-4, ISSN 1831-8789, DOI: 10.2778/30605.
- European Commission, (2014), “ Tax Reforms in EU Member States 2014 “, Tax policy challenges for economic growth and fiscal sustainability, 6/2014, ISSN 0379-0991.
- Feld. P. L., Schmidt, J. P., Schneider, F., (2007), “ Tax Evasion, Black Activities and Deterrence in Germany: An Institutional And Empirical Perspective ”, Annual Congress International Institute of Public Finance, UK, pp. 2-23.
- Feldstein Martin, (2008), “Effects of Taxes on Economic Behavior”, NBER (13745).
- Ferede, E. and B. Dahlby (2012). “The impact of tax cuts on economic growth: evidence from Canadian provinces. ” National Tax Journal, September 2012, Vol. 65, Nr. 3, pp.563-594.
- Folster, S. & Henrekson, M., (2001), “ Growth effects of government expenditure and taxation in rich countries, Vol. 45, European Economic Review, f. 1501-1520.
- Ganghof, S. & Genschel, Ph. (2008), “ *Taxation and democracy in the EU* ”, Journal of European Public Policy, Vol. 15, No. 1, pp. 58-77.
<http://dx.doi.org/10.1080/13501760701702199>
- Gemmell, N.,Kneller, R & Sanz, I., (2011), “ The Timming and Persistence of Fiscal Policy Impacts on Growth: Evidence from OECD Countries, Economic Journal, Vol. 121, pp. 33-58.
- Gemmell, N., Kneller, R & Sanz, I., (2011),” The growth effect of corporate and personal tax rates in the OECD”, Working Paper No. 49, May 2011.
- Gërxxhani, K. (2004). Informal Sector in Developed and Less Developed Countrie: A Literature Survey, *Tibergen Institute and University of Amsterdam*, Vol. 120, Issue 3-4, September 2004, pp. 269-275.
- Ghatak, S. (2003). Introduction to development economics (2nd ed.). London: Routledge.
- International Monetary Fund, (2013), *Republic of Kosovo*: Staff Report for the Consultation, Paper IV, June 28 2013, pp.1-5.
- Gordon, R., Li, W., (2005), “ Tax Structures in Developing Countries: Many Puzzles and Possible Explanation”, UCSD and University of Virginia, March 2005, p. 4
<http://www.worldwide-tax.com/index.asp/parthree>
- Gujarati, D., (2004), “ Basic Econometrics “, Fourth Edition, The McGraw – Hill

- Companies, 2004, pp. 65-76.
- Gutman, P.M.,(1977), “ The Subterranean Economy ”, Financial Analysis Journal, Vol. 33, No.6, p.26.
- Holcombe, R., Lacombe, D., (2004), “ The effect of state income taxation on per capita income growth”, Vol. 32, Public Finance Review, f. 292-312.
- Holcombe, Randall (2006), “ Public Sector Economics: The Role of Government in the American Economy ”, New Jersey, Pearson.
- Hyman, David M., (1990), “ Public Finance: A Contemporary Application of Theory to Policy”, 3rd, Dryden Press: Chicago, IL.
- IRS, (2013), “ IRS pick list”, Retrived 21 January 2013.
- Instituti Riinvest, (2013). *Performanca, Barrierat dhe Besueshmëria e Bizneseve në Kosovë*, Published by Riinvest Institute, Pristina, Kosovo, pp.5-16.
www.riinvestinstitute.org/.../Numeratori_FINAL_PRI...
- Instituti Riinvest, (2013). *To pay or not to pay / A business perspective of informality in Kosovo*. Published by Riinvest Institute, Pristina, Kosovo, pp.9-10. ISBN 978-9951-430-43-2. www.riinvestinstitute.org
- IMF (2010), Macroeconomic effects of fiscal consolidation, in World Economic outlook: Recovery, Risk and Rebalancing, 2010.
- IMF (2012), “ Tax Policy Can Help Spur Economic Growth ”, Fiscal Policy & Economic Growth: IMF Survey online, November 19, 2012, pp.1-4.
- Koester, R. & R. Kormendi, 1989, Taxation aggregate activity and economic growth: Cross country evidence, *Journal of Monetary Economics*, 16, 141-163.
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli IX: Marrëdhëniet Ekonomike, Neni 119 & 120, f. 48.
- Kucera, D. & Roncolato, L., (2008), Informal employment: “Two contested policy issues”, Report: International Labour Organization
- Lanza, V. (2012), The Classical Approach to Capital Accumulation: Classical Theory of Economic Growth, Swedish University, essay from Umea Universitet / Nationaleconomy, October, 2012, pp. 51-52.
www.diva-portal.org/smash/record.jsf?pid=diva2:562865

Lee, Y., & Gordon, R., (2005), “Tax structure and economic growth ”, Journal of public Economics, Vol. 89. Issue 5-6, Pp. 1027-1043.

Leibfritz, W., J. Thornton and A. Bibbe (1997), “ Taxation and Economic Performance ”, OECD / GD (97)107.

Lehmann, H.& Muravyev, A. , (2012) “ Labour Market Institutions and informality in Transition and Latin American Countries”, November 2012, IZA DP No. 7035.

Legjislacioni Tatimor i Kosovës, Nentor, (2011), Prishtinë.

Levin, E. J. & Wright, R. E. (2004), Regional Taxation and Retailing: “ *The Economic Geography of the Internet* ”, The International Review of Retail, Distribution and Consumer Research, Vol. 18, No. 3, pp. 337-356.
<http://dx.doi.org/10.1080/09593960420001678390>

Ligji Për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 2004/48, Maj 2005, Prishtinë.

Ligji Për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr 03/L-071, Dhjetor, 2008, Prishtinë.

Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/L- 222, Korrik, 2010, Prishtinë.

Ligji Për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 04/L-223, Janar, 2014, Prishtinë.

Ligji Mbi Tatimin në Korporata nr. 03/L-113, Dhjetor, 2008, Prishtinë.

Ligji Mbi Tatimin në Korporata nr. 03/L-162, Dhjetor, 2009, Prishtinë.

Ligji Mbi Tatimin në Korporata nr. 04/ L-103, Qershor 2012, Prishtinë.

Ligji Mbi Tatimin në të ardhura Personale nr. 03/L- 115, Janar 2009, Prishtinë.

Ligji Mbi Tatimin në të Ardhura Përsone nr. 03/L-161, Dhjetor, 2009, Prishtinë.

Ligji Mbi Tatimin në të Ardhura Përsone nr. 04/L- 104, Qershor, 2012, Prishtinë.

Ligji Mbi Tatimin në Vlerën e Shtuar nr.03/L- 114, Dhjetor, 2008, Prishtinë.

Ligji Mbi Tatimin në Vlerën e Shtuar nr. 03/L- 146, Dhjetor, Dhjetor, 2009, Prishtinë.

Ligji Mbi Tatimin në Vlerën e Shtuar nr. 04/L-108, Qershor, 2012, Prishtinë.

Ligji Mbi Pensionet në Kosovë, nr. 03/L- 084, Dhjetor. 2008, Prishtinë.

Ligji Mbi Pensionet në Kosovë nr. 04/L-101, Maj 2012, Prishtinë.

Ligji Mbi Lojrat e Fatit nr. 04/L- 080, Prill, 2012, Prishtinë.

Mara, E. R. (2012). Fiscal Policy in the European Union - Present and Perspectives, *Acta Universitatis Danubius*, Vol. 8, No. 2/2012.

Mark Stabile, “ *The Role of benefit taxes in the health care sector*”, Centre for Economics and Public Affairs University of Toronto, pp. 6.

<http://www.law-lib.utoronto.ca/investing/reports/rp14.pdf.data> e aksesit:6/11/2013.

Meier, G. M. (2000). The old generation of development economists and the new. In G. M.

Meier & J. E. Stiglitz (Eds.), *Frontiers of development economics: The future in perspective* (pp.13–50). Washington, D.C.: World Bank/Oxford University Press.

Mertens, K. & Ravn, M., (2012), “The dynamic effects of personal and corporate income tax changes in the United States”, *American Economic Review*, 2012.

Mendoza, E.G, Milesi-Ferretti, G.M.,Asea P.,(1997), “ On the ineffectiveness of tax policy in altering long - run growth: Harberger’s superneutrality conjecture “, *Journal of Public Economics*, Vol. 6, pp. 99-126.

Mirrless, J.A. (1975),” *Optimal Commodity Taxation in a Two- Class economy*”, *Journal of public Economics*, pp. 27-33.

Mukherje, S., (2005), “ *Modern Economic Theory*” 4th Edition, New Delhi.

Mullen, J. & Williams, (1994), “ *Marginal tax rates and state economic growth*”, Vol. 24, *Regional Science and Urban Economics*, f.687-705.

Myles D. Gareth (2009), *Economic Growth and the Role of Taxation – Disaggregate Data Economics Departament Working Papers No. 715*, University of Exeter and Institute for Fiscal Studies, ECO/WKP(2009)56, JT03267990, fq: 5; 31-52.
www.oecd.org/eco/working_papers

Myles,D.G.,(2009), “ *Economic Growth and the role of Taxation –Theory*”, *Economics Departament Working Papers No.713*, OECD, Jul 2009, ECO/WKP(2009)54, pp. 5-16.

N. Gregory Mankiew, Matthew Weinzierl, Danny Yagan (2009), “ *Optimal Taxation in Theory and Practice*”, Harvard business school, Working Paper No. 09-140.

OECD: “*Menaxhimi i shpenzimeve publike*” / Një libër reference për vendet në tranzicion, Tiranë, (2004).

- OECD: “ Principles of Good Tax Administration ”, Centre for Tax Policy and Administration, September, 2001, pp. 3-8.
- Ogbonna, G.N. & Ebimobowei, A., (2012), *Impact of Tax Reforms and Economic Growth of Nigeria: A Time series Analysis*, Current Research Journal of Social Sciences; pp. 62-68.
- Orock, R. & Mbuagbo, O., (2012). Why government should not collect taxes: grand corruption in government and citizens, views on taxation in Cameroon, *Review of African Political Economy*, Vol.39, No. 133, September 2012, pp. 480-482.
- Padovano, F. & Galli, E., (2001), “ Tax Rates and Economic Growth in the OECD Countries (1950-1990), Vol. 39, Economic Inquiry, f.44-57.
- Pashev, K., (2006), “ *Presumptive Taxation: Lessons from Bulgaria* ”, Post-Communist Economics, Routledge, Taylor & Francis Group, Vol. 18, No. 4, December 2006, pp. 400-417. DOI: 10.1080/14631370601008456
- Peter Dalgaard (2008). *Nonlinear regression analysis*. Department of Biostatistics University of Copenhagen.
- Phillipe T., Hoffman and Kathryn Norberg, (1994), “ Fiscal Crises, Liberty and Representative Government 1450-1789”, p.300. Paper ISBN: 9780804741927.
- Pierre R. Agenor and Kyriakos C., Neanidis (2012), “ *Optimal taxation and growth with Public goods and costly enforcement* ”, The Journal of International Trade & Economic Development, University of Manchester, UK.
<http://dx.doi.org/10.1080/09638199.2012.730055>
- Ramsey, Frank (1927), “ A Contribution to the Theory of Taxation”, *Economic Journal* 37: 47-61. Doi: 10.2307/2222721.
- Reed, R., (2008), “ The Robust Relationship between Taxes and U.S. State Income Growth”, *National Tax Journal*, Vol.61, No.1, f.57-80.
- Rogers, T. E. Orock & Oben, T. Mbuagbo, “ *Why government should not collect taxes*”: Grand Corruption in Government and Citizens Views on Taxation in Cameroon’, *Review of African Political Economy*, pp.479-499.
<http://www.feedbooks.com>
- Romer, Ch., Romer, D., (2010), “ The macroeconomic effects of tax changes: Estimates based on a new measure of fiscal shocks “, *American Economic Review*, Vol. 100, pp. 763-801.

Rose, Ackerman, Susan, (1975), “ The Economics of Corruption “, Journal of Public Economics.

Rosen, H. (2003), “ *Financa Publike* “, albin, Tiranë, fq. 164-338.

Rregullorja e UNMIK - ut nr. 1999/16, “ Mbi Themelimin e Organit Qendror Fiskal dhe çështje tjera të lidhura me të ”, datë: 6 Nëntor 1999.

Rregullorja e UNMIK-ut, nr. 2000/5 Mbi Tatimin ne Hoteleri, Shkurt, 2000, Prishtinë.

Rregullorja e Unmikut, nr. 2001/11, Mbi Tatimin e Vlerës së Shtuar, Maj, 2000, Prishtinë.

Rregullorja e Unmikut, nr.2002/17, Mbi Tatimin e Vlerës së Shtuar, Gusht, 2002, Prishtinë.

Rregullorja e Unmikut, nr.2004/35, Mbi Tatimin e Vlerës së Shtuar, Gusht, 2004, Prishtinë.

Rregullorja e Unmikut nr. 2002/04, Mbi Tatimin mbajtur në burim, Shkurt, 2002, Prishtinë.

Rregullorja e Unmikut nr. 2003/03, Mbi Tatimin e mbajtur në burim, Janar 2003, Prishtinë.

Rregullorja e Unmikut nr. 2004/52, Mbi tatimin mbajtur në burim, Dhjetor, 2004, Prishtinë.

Rregullorja e Unmikut nr. 2002/03, Mbi Tatimin në Fitim, Shkurt, 2002, Prishtinë.

Rregullorja e Unmikut nr. 2004/51, Mbi Tatimin në Korporata, Dhjetor, 2004, Prishtinë.

Rregullorja e Unmikut nr. 2001/35, Mbi Pensionet në Kosovë, Dhjetor, 2001, Prishtinë.

Rregullorja e Unmikut nr 2005/20, Mbi Pensionet në Kosovë, Prill, 2005, Prishtinë.

Saez, Emmanuel(2001), “Using Elasticities to Derive Optimal Income Tax rates”, Reiew of Economic Studie, Vo. 68, pp. 105-229.
[doi:10.1111/1467-937x.00166](https://doi.org/10.1111/1467-937x.00166).

Schneider, F. (2008). Shadow Economies and Corruption all over the World: Empirical Results for 1999 to 2003, *International Journal of Social Economics*, Vol. 35, No. 9, September 2008, pp. 2-19.

Schneider, F., Buehn, A., Montenegro, C. E., (2010), Shadow Economies All over the World/Policy Research Working Paper 5356, *The Word Bank Development Research Group Poverty and Inequality Team & Europe and Central Asia Region Human Development Economics Unit*, July 2010, pp. 3-34.

- Schrage, Horst, (1984), Schattenwirtschaft Abgrenzung, Definition, Methoden der quantitativen Erfassung,. in Wolf Schäfer (ed), *Schattenökonomie. Theoretische Grundlagen und wirtschaftspolitische Konsequenzen* (Göttingen: Vandenhoeck und Ruprecht), pp. 11.37.
- Seren, M.J.F., Panades, J., (2013), Do Higher Tax Rates Encourage / Discourage Tax Compliance?, *Modern Economy*, December 2013, Vol. 4, pp. 809- 817.
- Sharlach, T., Silverman D., White D., (2002), “ Taxes in the Ancient Word”, *University of Pennsylvania, Almanac*, Vol. 48, No. 28, April 2002.
<http://www.upenn.edu/almanac/v48/n28/AncientTaxes.html>
- Skousen, Mark, (2006), “ The big Three in Economics ” M. e. Sharpe, Inc Available at: Umea University Library.
<http://site.ebrary.com/lib/UMEAUB/docDetail.action?docID=10178067>
- Simkovic, Michael, (2015), “ The Knowledge Tax”, *University of Chicago Law Review*, pp. 1981-2041, February 23, 2015.
- Slemrod, joel, (1990), “Optimal Taxation and Optimal Tax Systems”.
- Slemrod, J., Yitzhaki, Sh., (2000), “ Tax Aviodance, Evasion, and Administration ”, NBER Working paper No. 7473, Massachusetts Avenue, Cambridge, MA 02138.
<http://www.nber.org/papers/w7473>
- Smith, P., (1994), Assessing the Size of the Underground Economy: *The Canadian Statistical Perspectives*, *Canadian Economic Observer Catalogue* No. 11-010, pp.18.
- Smith, A. (1776), “*An Inquiry into the Nature and Causes of the Wealth of Nations*”, pp. 453-455.
- Solow, R. M., (1956), ” A contribution to the theory of economic growth”, *The Quarterly Journal of Economics*, 1956, vol. 70 (1), pp. 65.
- Stiglitz, J. E. (2010), “ Development - Oriented Tax Policy ”, in *Taxation in Developing Countries: Six Case Studies and Policy Implications*, Columbia University Press, July 2010, pp. 11-36.
- Taylor, Overton H., (1960), “ A history of Economic Thought: Social Ideas and Economic Theories from Quesnay to Keynes ”, International Student ed. Massachusetts: McGraw Hill, pp. 39-59
- Tax Administration of Kosovo, (2014). Report, July 2014, Prishtina, Kosovo.
<http://www.atk-ks.org>.

- Torgler, B. & Schaltegger, Ch. A. (2006), *Tax Morale and Fiscal Policy*.
<http://www.isn.ethz.ch/Digital-library/Articles/Detail/?ots591...Ing.../html>.
- Thomas, Jim, 1992, “ *Informal economic activity* ”, New York: Harvester / Weatsheaf
- UNDP. (2012). *Kosovo Human Development Report*, Prishtina, Kosovo, pp. 53.
- Wagner, Richard E. (1988), “ The Calculus of Consent a Wicksellian Retrospective”,
 Public Choice, Vol. 56, pp. 153-166.
- Wagner, Adolph (1890), “ Three Extracts on Public Finance ”, Extracts from
 Finanzwissenschaft, Part II, revised, edition, Leipzig 1890, pp.207-208, 299-305.
- World Bank, (2000), Entering the 21st century—World development report 1999/2000.
 New York: Oxford University Press.
- Word Bank, (2014), *Report: Doing Business 2014*.
- Yalama, O. G., Gumus, E. (2013), “ Determinants of tax Evasion Behavior: Emperical
 Evidence from Survey Data “, International Business and Management, Vol.6, No.2,
 2013, pp. 15-23. DOI: 10.3968/j.ibm.1923842820130602.1085

Burime parësore:

PYETSORI ; <http://www.instat.gov.al/>

SHTOJCA

Analiza ekonometrike dhe testet e saj

Testet e stacionaritetit të variablave të përfshira në analizë:

Augmented Dickey-Fuller Test Equation
